



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Bashkinë Bulqizë”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

mbi

(Auditimin Financiar)

BASHKIA BULQIZË

Tiranë, dhjetor 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda	2
	Shkurtime	3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i disa gjetjeve kryesore dhe rekomandimet	4-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
II.	HYRJA	8
1.	Objekti i auditimit	8
2.	Qëllimi i auditimit	8
3.	Identifikimi i çështjes	8
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
5.	Përgjegjësitë e audituesve.	9
6.	Kriteret e vlerësimit	9
7.	Standardet e auditimit	10
8.	Metodat e auditimit	10
9.	Dokumentimi i auditimit	11
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	11
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve tëauditimit	13
3	1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	13-21
4	1/6. Niveli i realizimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre	21-42
5	2. Vlerësimi i raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.	43-70
6	3. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.	70-72
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	73-85
V	NEKSET	86-117

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AKUM	Autoriteti Kombëtar Ujrave dhe Mbetjeve
AAM	Aktive Afatgjata Materiale.
AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
UMFE	Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonimë
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
OE	Operator Ekonomik
DTTV	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.1113/1 prot., datë 01.11.2021, nga data 01.11.2021 deri në datë 03.12.2021 në institucionin Bashkia Bulqizë u krye auditimi *oFinanciaro*. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020, ndërsa nuk u shtri mbi çështjet e veprimtarisë së institucionit, si menaxhimi financiar e kontrolli i brendshëm, prokurimet publike, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, por në planifikimin dhe zbatimin e treguesve të buxhetit, niveli i realizimit të të ardhurave dhe vlerësimi raportimit financiar me opinion për pasqyrat financiare. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës).

Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt akt konstatimet dhe akt verifikimet dhe pas kryerjes së takimit përmbyllës mes palëve nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga audituesit përkatës. Projektraporti është kthyer nga subjekti me shkresë nr.6260, datë 24.12.2021 e protokolluar në KLSH me nr.1113/4 prot datë 24.12.2021, ndërsa në ambientet e KLSH^{se} nuk u realizua takimi përmbyllës, sepse subjekti i audituar me kërkesën e tij për arsye objektive nuk do marr pjesë, ndërsa në përfundim i qëndron korrekt kundërshtimeve të dërguara lidhur me gjetjet e auditimit.

2. Përshkrim i disa gjetjeve më kryesore dhe rekomandimet.

Nr	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raporti përfundimta	Rëndësia	Rekomandimi
1	-Llog.(210) <i>oToka, troje, terreneo</i> ; llog.(211) <i>oPyje kullota plantacioneo</i> ; llog.(212) <i>“Ndërtime e Konstruksione”</i> ; llog.(213) <i>oRrugë, rrjete, vepra ujore</i> , në pasqyrat e pozicionit financiar viti 2020, nuk përfaqsojnë vlerën e saktë dhe reale të asetëve publike të njësisë vendore, sepse në të gjitha këto llogari asetet nuk janë pasqyruar dhe rregjistruar në ASHK. Për këto llogari bashkia nuk ka listë përfundimtare të asetit publik në formë regjistri të aktive me elementët e duhur përbërës, nuk ka hartuar plan për rregjistrimin e tyre në ASHK, veprime në mospërputje me ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 <i>oPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareo</i> , neni 15, pika (1;2) të UMF nr.30, datë 27.12.2011 <i>oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko</i> , Kap.(IV), pika (74;96) dhe UMF nr.8, datë 09.03.2018 <i>oPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeo</i> .	43-70	E lartë	-Titullari bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Urbanistikës, të marrin masa për sistemimin e saktësimin e asetit publik në llog.(210) <i>oToka, troje, terreneo</i> , llog.(211) <i>oPyje kullota plantacioneo</i> , llog.(212) <i>“Ndërtesa, konstruksione”</i> , llog.(213) <i>oRrugë, rrjete, vepra ujore</i> , duke kryer inventarizimin fizik të tyre e hartimin e regjistrit kontabël me të dhëna të nevojshme (vendodhja, sipërfaqe, etj). Në vijim të merren masa për regjistrimin e këtyre asetëve në ASHK e pasqyrimi në pasqyrat e pozicionit financiar të të gjitha asetëve që njësia vendore ka në administrim.
2	-Llog.(466) <i>oKreditorë për mjetet në ruajtjeo</i> (garanci punime në masë 5% e vlerës investimit), në pasqyrat financiare të vitit 2020 ka vlerën 35,510,372 lekë, ndërsa njësia vendore bashkia për 14 objekte të cilat i ka me listë analitike dhe ka marr në dorëzim punimet me vlerën 12,428,207 lekë, nërsa nuk ka bërë zhbllokim të garancisë, megjithëse është përbushur afati i garancisë së punimeve parashikuar në kontratën e lidhur midis palëve e evidentuar me analizë në (aneksi nr.13, pika 2/1), veprim në mospërputhje me	43-70	E lartë	-Titullari bashkisë nëpunës autorizues, Drejtori Financës nëpunës zbatues e Drejtori Urbanistikës të analizojnë e të saktësojnë përbërjen analitike të 14 objekteve në vlerën prej 12,428,207 lekë gjendje e ngurtësuar në thesar të cilat bashkia i ka marr në dorëzim duke përcaktuar mos likuidimin, emrin investimit dhe shoqërisë në referencë me kushtet e kontratës për detyrimet e

	UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 <i>“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”</i> , Kap.(III), pikat (30; 50).			përcaktuara në to dhe të bëhen krahasim nëse vlera e ngurtësuar rakordon me detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe të hartohet aktrakordim me degën e thesarit Bulqizë me të dhëna të detajuara për shoqër në investimet.
3	-Në datë 31.12.2020 Bashkia Bulqizë ka një vlerë të detyrime të prapambetura prej 28,307,781 lekë, e cila përbëhet nga: -Detyrime për investime në vlerë 27,815,530 lekë; -Detyrime vendime gjyqësore vlera 0 (zero) lekë; -Detyrime për shërbime në vlerën 492,251 lekë; Detyrimet e prapambetura të cilat janë krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, vlera e detyrimeve që i përket mos alokimit të plotë të fondeve për investime të përfunduara dhe në datë 31.12.2020 bashkia ka këtë gjendje të detyrimeve të prapambetura. Si rezultat i mos realizimit të të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore për të mbuluar shpenzimet deri në datën 31.12.2020, vlera e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Bulqizë është gjendje në shumën 28,307,781 lekë , veprim në mospërputhje me neni (50) <i>“Angazhimet buxhetore”</i> , neni (52) <i>“Kryerja e shpenzimeve”</i> , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 <i>“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”</i> i ndryshuar, neni (56), ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 <i>“Për financat e vetëqeverisjes vendore”</i> , pika (62) UMFE nr.2, datë 06.02.2012 <i>“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”</i> ; UMF nr.5, datë 27.12.2014 <i>“Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”</i> , UMF (plotësues) nr.2, datë 10.01.2018 <i>“Për buxhetin e vitit 2018”</i> , pikat (82-91) <i>“Detyrimet e prapambetura të njërive të vetëqeverisjes vendore”</i> , neni 70, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 <i>“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”</i> i ndryshuar.	13-21	E lartë	-Titullari bashkisë,Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave të analizojnë situatën e detyrimeve të prapambetura të pa likuiduara dhe të nxirrin përgjegjësitë për këtë situatë, dhe nëpërmjet rritjes së treguesve të arkëtimit të të ardhurave vendore të planifikuara. Të mos marrin angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të mos krijohen detyrime të reja në vijimësi. Për detyrimet e prapambetura të hartohet grafik për likuidimin e detyrimit, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen e Këshillit Bashkis material për gjendjen e faturave pa likuiduara me plan e grafik për likuidimin e tyre. Detyrimet financiare të konstatuara të papaguara ndaj palëve të treta të ulen nën nivelin prej 15% të shpenzimit vjetor.
4	-Bashkia Bulqizë ka lidhur kontrat për dhënien në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kulloor asete pronë e njësisë vendore me kontratë qira për ndërtim të HEC ^{ev} ku vlera e qirasë nuk është përlllogaritur e saktë, sipas raportit teknik për ndërtimin dhe vlerësimin e tarifës duke bërë që qiramarrësit të kryejnë pagesa më të ulët se vlera e duhur për 30,935,494 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore bashkia Bulqizë, veprim në mospërputhje e përcaktuar me tarifën nga lidhja (2), nenet (11;12), VKM nr.391, datë 02.06.2006 <i>“Për përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotave”</i> i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.	21-42	E lartë	-Titullari bashkisë Bulqizë, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën të marrin masa menjëhershme për të përlllogaritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysHEME për dhënë në përdorim sipërfaqe fondi pyjor/ kullosor me kontratë të lidhur për ndërtim HCE ^{ve} në teritori bashkisë Bulqizë, për të cilin ka rezultuar diferencë në vlerën 30,935,494 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Bulqizë.
5	-Bashkia Bulqizë nga sipërfaqja totale prej 10,278 ha e fondit pyjor/kullosor asete publik pronë e njësisë vendore, ka lidhur kontrat për dhënien në përdorim të sipërfaqes vetëm me 12 OE me kontratë qira për ushtrim aktiviteti tregtar në fushën minerare të pajisur me leje minerare nga (MEI) në teritori bashkisë Bulqizë, ku vlera e qirasë nuk është përlllogaritur e saktë, sipas raportit teknik për ndërtimin dhe vlerësimin e tarifës duke bërë që qiramarrësit të			-Titullari bashkisë, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit Pyjeve e Kullotave, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën të marrin masa menjëhershme për të verifikuar e saktësuar gjendje reale në terren me qëllim për të administruar të gjithë sipërfaqen fondi pyjor/kullosor

<p>kryejnë pagesa më të ulët se vlera e duhur për 40,716,251 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore bashkia Bulqizë, veprim në mospërputhje e pëcaktuar me tarifën nga lidhja (2), nenet (11;12), VKM nr.391, datë 02.06.2006 <i>“Për përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.</i></p>		<p>sipas të dhënave në regjistrin AKBN^{SE} me sipërfaqe totale prej 10,278ha në përdorim nga 123 OE dhe të lidhen kontrata qirje me të gjithë këta OE dhe jo vetëm me 12 OE, ndërsa të përlogaritet sa më i saktë niveli tarifës dysheme për dhënin në përdorim të sipërfaqe fondi pyjor/kullosor edhe për kontratat e lidhur për ushtrim aktiviteti tregtar në fushën minerare të pajisur me leje minerare nga (MEI) në teritori bashkisë Bulqizë, për të cilën ka rezultuar e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Bulqizë. në vlerën 40,716,251 lekë</p>
---	--	--

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Konkluzioni i përgjithshëm.

Ne kemi audituar veprimtarinë ekonomiko financiare në bashkia Bulqizë për periudhën raportuese ushtrimore nga data 01.01.2020 deri në datë 31.12.2020 përfshirë çështjet pasqyrat financiare dhe planifikimin e realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa nuk janë përfshirë çështjet e menaxhimit financiar dhe kontrollit; auditimi i brendshëm; procedurat e prokurimit publik; zbatimi rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, si dhe procedurat e lejeve të ndërtimit. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare dhe të ardhurat vendore, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në përfundim të procesit të auditimit të fushave të audituara për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, pas vlerësimit të dokumentacionit grupi ka arritur në konkluzionin se përsa i përket shllallës së zbatimit të standardeve mbi raportimin financiar nga subjekti Bashkia Bulqizë në përgjithësi jepet një pamje e drejtë e sinqertë e performancës financiare, si dhe lëvizjes së mjeteve monetare në përputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, duke përjashtuar disa anomali materiale jo të përhapura që janë bazë për dhënie të një opinioni të pamodifikuar me theksim të çështjeve mbi pasqyrat financiare dhe përputhshmërisë në veprimtarinë e subjekti Bashkia Bulqizë me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.

I-Opinion mbi pasqyrat financiare “i pamodifikuar me theksim të çështjeve”.

Grupi auditimit të KLSH^{SE} ka audituar pasqyrat financiare të njësisë publike Bashkia Bulqizë për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, të cilat përfshijnë vlerat e paraqitura në postet përbëhen nga Formati nr.1 *“Pasqyrat e pozicionit financiar (bilanci)*”, krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekset si; Formati nr.2 *“Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime*”, Formati nr.3 *“Pasqyra e flukseve monetare (cash flo)*”, Formati nr.4 *“Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto*”, Formati nr.5 *“Shënime shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare vjetore*”, Formati nr.6 *“Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit*”, Formati nr.(7/a) *“Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, Formati nr.(7/b) *“Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*”, Formati nr.8 *“Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave*”.

Në bazën për opinion (trajtuar më sipër), sipas mendimit tonë, si dhe mbështetur në standardet ISSAI 1705¹ dhe ISSAI 1200², pasqyrat financiare, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet e rregullat përkatëse të financave publike dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi *ōkonkluzione të përgjithshmeō*.

Baza për opinionin i pamodifikuar me theksim çështje:

Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAIⁿ 10 *ōDeklarata e Meksikësō* mbi pavarësinë e SAI^t, si dhe ISSAI 30 *ōKodi Etikō*, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendura në ISSAIⁿ 5000 *ōAuditimi i Institucioneve Ndërkombëtareō*.

-Udhëzues për SAIⁿ. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodi Etikës së KLSH^{së}. Gjithashtu besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Nga testimi llogarive konstatohet se, në dhënien e opinionit ne kemi marrë në konsideratë faktin se, disa llogari megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore raportuese viti 2020, ndërsa kërkohet të marren masa për të sistemuar vlerat e këtyre llogarive konkretisht; llog.(468); llog.(202); llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog.(213); llog.(214); llog.(215); llog.(231); llog.(466), të cilat nuk e pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë publike vendore Bashkia Bulqizë, duke bërë që në këto llogari në fund të vitit ushtrimor raportues të paraqitet vlera e saktë gjendje.

Theksimi i çështjeve:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit njësisia publike Bashkia Bulqizë, për sa i takon sistemimit të llogarive të më poshtme: llog.(468); llog.(202); llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog.(213); llog.(214); llog.(215); llog.(231); llog.(466), me vlerë përkatëse materialiteti e përlllogaritur prej 10,599 mijë lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Bulqizë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Bulqizë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Bulqizë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet, apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH^{së}:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme³, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomalitë materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve nga auditimi

³ ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomalitë materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.

me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH^{se}, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe funksionimin e KLSH^o, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1113/1 prot, datë 01.11.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.11.2021 deri në datë 03.12.2021, në institucionin Bashkia Bulqizë u krye auditimi financiar. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2020 deri në datën 31.12.2020.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. V.R, përgjegjës grupi.
2. A.Th, auditues.
3. A.T, auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

-Objekti i auditimit. Auditimi i kryer në Bashkinë Bulqizë është auditim financiar. Auditimi ka pasur si objekt pasqyrat financiare, treguesit e buxhetit dhe të ardhurat vendore. Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

-Marrja e garancive nëse procedurat e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit si dhe në mbledhjen e të ardhurave vendore.

-Qëllimi i auditimit. Për pasqyrat financiare të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

-Identifikimi i çështjes. Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

2.Vlerësimi i raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me

ekonomi, efektivitet dhe eficiency, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Nëpunësi autorizues z.LA me detyrë Kryetar i Bashkisë Bulqizë dhe Nëpunësi Zbatues z.RB me detyrë Drejtor i Financës janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Bulqizë.

Bazuar në pika (6) e nenit (34), të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”, neni (91), ÕNjësitë e vetëqeverisjes vendore, kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika (1.3) ÕTë drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

neni (65) “Administrata e njësisë administrative”, pika (1) “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Bulqizë, për problematikën e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e pasqyrave financiare dhe inventarizimin e pasurisë; mbajnë përgjegjësi në lidhje me mangësitë, në shkelle të dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në aktivitetin financiar. Problematikën dhe përgjegjësitë lidhur me to, të konstatuara gjatë procesit të auditimit, janë evidentuar në aktkonstatimet e mbajtura në Projektraport e Raporti përfundimtar i Auditimit.

-Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e audituesve të KLSH^{së} është që nëpërmjet auditimit të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare, si dhe çështjet që lidhen me të ardhurat dhe shpenzimet. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që ne ti përmbahemi kërkesave etike, profesionale, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse pasqyrat financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi vlerëson nivelin, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit. Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik:

-Parimin e integritetit.

-Parimin e pavarësisë.

-Parimin e objektivitetit.

-Parimin e shmangies së konfliktit të interesit.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare dhe buxhetit.

-Kriteret e vlerësimit. Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (*baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj, me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet*) dhe kryesisht: ligji nr.139/2015, datë 17.12.2017 *ËPër vetëqeverisjen vendore*; ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore*; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* dhe ligje e udhëzime vjetore të Ministrisë së Financave për buxhetin; ligji nr.147/2015 *ËPër buxhetin e vitit 2016*; ligji nr.130/2016, datë 17.12.2016 *ËPër buxhetin e shtetit të vitit 2017*; ligji nr.9228, datë 29.4.2004 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare* i shfuqizuar; ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*, ligji nr.9643, datë 20.11.2006 *ËPër prokurimin publik* i ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* i ndryshuar; UMF nr.8, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*, UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ËMenaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publik* i ndryshuar; etj. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të aparatit administrativ të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

-Standardet e auditimit. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të adituesve;

Kërkesat e Udhërrëfyesit IDI¹, INTOSAI *ËPër implementimi e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*, etj.

Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH^{së}, etj.

Gjatë zhvillimit të auditimit nga grupi u patën parasysh dhe u zbatuan:

-Qasjen e auditimit mbi bazë risku (rreziku), sipas së cilës të gjithë përpjekjet dhe burimet drejtohen në fushat dhe çështjet më të rëndësishme dhe ku vlerësimi i riskut është në nivelet më të larta;

-Përdorimin e gjykimit profesional duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, manualin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë.

Gjithëbulqizëhtu auditimi është kryer në zbatim të:

Ligjit organik i KLSH^{së} nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*;

Rregullores së Brendshme *ËMbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH^{së}*, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 85, datë 30.06.2015;

-Rregullores *ËMbi Procedurat e auditimit në KLSH^o*, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së}.

-Metodat e auditimit (Procedurat e auditimit). Përcaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke pasur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:

-Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1). Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5). Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, të cilat kanë qenë si vijon:

1.Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në

llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

2.Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*urdhër shpenzimeve*) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr.30, datë 27.12.2011 *Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*.

3.Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël e pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4.Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5.Konfirmim nga të tretët.

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (*Rakorduara*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6.Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna jashtë normalesë, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit (*aktkonstatimet, aktverifikimet dhe letrat e punës*) të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar e mbështetur konkluzionet e auditimit. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara u përgatit Projekt Raporti i Auditimit. Nga subjekti i audituar kanë ardhur kundërshti lidhur me çështjet e auditimit të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit

-Dokumentimi i auditimit. Është bërë mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, (ISSAI 1230) *ËDokumentimi Auditimit*. Nga grupi i auditimit është përgatitur dokumentacioni i duhur mbi bazën e të cilit mbështeten konkluzionet e auditimit. Për këtë janë përgatitur aktkonstatimi, projektraporti i auditimit dhe ky raport përfundimtar i auditimit. Puna e dokumentuar në këto dokumente është mbështetur mbi bazën e evidencave konkrete, të mara nga subjekti i audituar, të cilat kanë plotësuar tre cilësitë e duhura: kanë qenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme. Procedurat e ndjekura të auditimit janë përkrahur nga secili auditues në aktet e konstatimit, gjatë trajtimit të çështjes sipas ndarjes së detyrave, ku janë evidentuar edhe evidencat të cilave ju jemi referuar. Një pjesë e evidencave të cilat duhet të mbështesin konkluzionet kryesore të auditimit janë pjesë e dosjes së auditimit. Gjatë fazës së auditimit në terren grupi i auditimit ka dokumentuar në informacionet periodike gjetjet kryesore të auditimit. Për çështjet e kundërshtuara nga subjekti prej tij janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit.Me subjektin e audituar pranë zyrave të KLSH nuk u krye takimi ballafaques, pasi nga ana e subjektit u kërkua se për arsye objektive, nuk do marr pjesë në takimin ballafaques, ndërsa i qëndron observacioneve me shpjegimet që ka dërguar.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektiv, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqe Thesarit të Ministrisë së Financave



për realizimin e fondit publike e të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive. Bashkia Bulqizë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 *ËPër Vetëqeverisjen Vendore* dhe ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes Vendore*, Rregullore *ËOrganizimi e Funksionimi e Administratës* bashkia Bulqizë, etj, aktet ligjore/ nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Bashkisë Bulqizë.

Të dhëna të përgjithshme e pozicioni gjeografik: Bashkia Bulqizë bën pjesë në Qarkun Dibër.

-Zona Gjeografike: Bashkia Bulqizë shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe është pjesë e qarku Dibër. Qendra me e madhe e afërt urbane është qyteti i Bulqizës. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 678.51 km² me densitet prej 59.28 banorë/km² sipas Regjistrat Civil dhe 47.47 banorë/km² sipas Censurit 2011. Ajo kufizohet në veri me bashkinë Dibër, në perëndim me bashkinë Klos, jugperëndim me bashkinë Tiranë, në jug me bashkinë Librazhd. Në përbërje janë 8 Njësi Administrative, 1 qytet dhe 29 fshatra. Krahuina e Bulqizës pavarësisht ndryshimeve të vogla është një njësi etnografike me unitet etnokulturor. Relievi kodrinormalor përcakton si burime kryesore gjeneruese bujqësinë dhe blegtorinë, por pa harruar edhe industrinë e nxjerrjes së kromit dhe atë të pasurimit të mineralit të kromit, ku rajoni i Bulqizës është mjaft i njohur. Ndërkohë, një tjetër burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni konsiderohet edhe turizmi malor familjar si dhe ngritja e qendrave për grumbullimin e bimëve medicinale, me të cilat zona është mjaft e pasur. Bulqiza ka një ndryshim të qartë dhe të dallueshëm me krahuinat kufitare, ai identifikohet plotësisht nga traditat e zakonet, nga dialekti i tij karakteristik nga veshjet, këngët e vallet etj.

-Popullsia: Bashkia Bulqizë ka 40,223 banorë sipas Regjistrat të Gjendjes Civile, ndërsa sipas Censurit (2011) ka 31210 banorë, fëmijët ose grupmosha 0-14 vjeç përbëjnë 28.7% të popullsisë, popullsia e aftë për punë (*grupmosha 15-64 vjeç*) me 63.8%, ndërkohë të moshuarit 7.5%. Femrat përbëjnë 50.3% të popullsisë dhe 7.4% e familjeve drejtohen nga kryefamiljare femra. Sipas statistikave të dhëna krahasuar në vitet (2018-2019) numri i popullsisë në vitin 2020 ka ardhur në rritje me % shumë të vogël për shkak të lindjeve të pakta dhe emigracionit. Në periudhën (2001-2011) ka një shpopullim prej 14%, si rezultat i migrimit të brendshëm e të jashtëm. Bashkia Bulqizë përbëhet nga 8 Njësi Administrative që janë: (*NJA Bulqizë; Fushbulqizë; Shupenzë; Zerqan; Gjoricë; Ostren; Trebisht; Martanesh*). Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Bulqizës, qarku Dibër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj 1 qytet dhe 29 fshatra.

Sfidat me të cilat do të përballet pushteti vendor pas ndarjes së re;

-Profili i bashkisë. Vizioni; Bulqiza është në mirëqenie e prosperitet të vazhdueshëm e pastër e gjelbër e sigurt dhe mikpritëse për të gjithë. Një ndërthurje e vlerave historike dhe kulturore me resurset natyrore e turistike për një zhvillim të qendrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të udhëhequr nga komuniteti.

-Zhvillimi Ekonomik; Bashkia ka në funksionet e veta hartimin dhe zbatimin e programeve për zhvillimin ekonomik vendor. Megjithatë, zhvillimi vendor nuk është përgjegjësi e një aktori të vetëm, por kërkon një ndërveprim dhe partneritet të detyrueshëm midis aktorëve të ndryshëm në territor, duke përfshirë qeverisjen vendore, institucionet e dekoncentruara, komunitetin sipërmarrës dhe shoqërinë civile.

Ish NJQV^{te} nuk kanë përdorur strategji apo plane zhvillimi, si strategjia e turizmit për rajonin e Bulqizë, Strategjia e zhvillimit rajonal, Plani zhvillimit të ish/komunave, Plani zhvillimit të bashkisë Bulqizë, Plani i menaxhimit të mjedisit etj. Në asnjë nga ish NJQV^{te} pjesë përbërëse të bashkisë Bulqizë nuk ka patur agjenci të zhvillimit vendor, apo praktika të zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti siç janë grupet lokale të veprimit. Ekonomia në qytetin e Bulqizës dhe në Njësitë Administrative varet nga burimet nëntoksore si mineralet të kromit që gjenden në Bulqizë dhe Martanesh, për këto burime ka pasur edhe shoqëri të huaja që janë interesuar që të nxjerrin mineral nga zona e Bulqizës. Ekonomia e Bulqizë në përgjithësi

varet dhe nga kultivimi bimësisë ku në këtë zone kultivohet molla, misri, fasulja etj. Industria nuk është shumë e zhvilluar në krahinë.

-Zhvillimi i bujqesisë; Nga sipërfaqja e teritori të bashkisë gjithsej prej 67815 ha, toka bujqësore zë 12.3% të sipërfaqjes totale, nga sipërfaqja prej 8341 ha tokë bujqësore, vetëm 51.1% ka aktualisht aftësi vaditëse. Një pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore ka pësuar degradim nga mospërdorimi dhe erozioni. Toka bujqësore shfrytëzohet dhe ka prodhimtari të mirë në frutikulturë, vreshtari, bimë arash (misër, grurë), perime dhe foragjere. Toka më pjellore është lugina e Drinit të zi (fusha e Gjoricës) që rrethohet nga kodra të buta dhe të ulëta të cilat vazhdojnë deri në vijën kufitare me shtetin e Maqedonisë Veriut. Bashkia ka një shumëllojshmëri burimesh natyrore ndër të cilat mund të përmendim sipërfaqet e mëdha pyjore, florën dhe faunën e pasur, monumentet e shumta natyrore, cilësinë e ajrit, burimet minerare etj. Zona ka pasuri të shumta minerare në krom dhe nënproduktet e tij etj. Qyteti i Bulqizës është një nga vendburimet më të mëdha të kromit në vend.

-Blegtoria; Në rrethin e Bulqizës dhe bujqësia mundet të konsiderohet si degë e rëndësishme nga e cila mbulohen një pjesë e të ardhurave të popullsisë. Kjo lidhet edhe me të ardhurat që femeri dhe blektori sigurojnë nga mishi, frutat dhe perimet, ndërsa qumështi me nënproduktet e tij si baza kryesore e ushqimit në familje shumë më pak tregtohet. Në zonat më të larta dhe në terrene më të thyera ka përhapje dhe zhvillohen më me efektivitet mbarshtrimi i bagëtive të imëta, të cilat shfrytëzojnë kryesisht kullotat natyrore që janë të bollshme. Ata qëndrojnë në këto kullota si në periudhën e vjeshtës, pjesërisht dimrit, në pranverë dhe sidomos gjatë verës në kullotat e mrekullueshme të Martaneshit. Bashkia ka në administrim një sipërfaqe prej **43,125 ha**, nga të cilët 32,752ha pyje; 4,325ha kullota, 6,049ha sipërfaqe inproduktive (shkëmbore). Bashkia sipas ndarjes administrative klasifikohet 20.3% urbane dhe 79,7% rurale, ndërsa sipas rrjetit të qelizave në nivel njësie vendore klasifikohet 100% rurale.

-Turizmi; Turizmi është pothuajse inekzistent si aktivitet për shkak të mungesave të organizimit të zinxhirit të vlerës, infrastrukturës së keqe rrugore e turistike, mungesës së vizibilitetit dhe marketingut territorial. Ka probleme të rënda mjedisore për shkak të shfrytëzimit jo të qendrueshëm e të paplanifikuar të resurseve natyrore minerare, pyjore, ujore etj. Shpyllëzimi pa kriter është një problem i mprehtë që dëmton jo vetëm mjedisin, por edhe perspektivën afatgjatë të zhvillimit të bashkisë.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 1.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2019, 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

-Nënpika (1/1). Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2020;

-Nënpika (1/2). Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

-Nënpika (1/3). Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID¹⁹, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi;

-Nënpika (1/4). Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.);

-Nënpika (1/5). Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

-Nënpika (1.6) ÷Niveli realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor....ö.;

Titulligjetjes:	-Nga auditimi u konstatua se, ndërmjet planifikimit dhe zbatimit të planit të buxhetit të njësisë vendore bashkia Bulqizë ka diferenca në treguesit e buxhetit, përse i përket pjesës së shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat vendore, bazuar në ligjin organik të buxhetit shtetit.
------------------------	---

Situata:

Nën/pika (1/1). Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2020;

-Për periudhën raportuese viti 2020; Titullari Bashkisë Bulqizë ka miratuar hapat për përgatitjen e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm (PBA 2019-2021) dhe në vijim sipas miratimit të kalendarit është përcaktuar programi buxhetor afatmesëm për njësitë shpenzuese dhe raporti vlersimit i të ardhurave dhe shpenzimeve. Këshilli Bashkisë me vendim nr.48, datë 18.06.2018 ka miratuar tavanet e programeve buxhetore afatmesëm për periudhat (2019-2021). Programet Buxhetor Afatmesëm të institucionit, ndërsa strukturat buxhetore për këto periudha ushtrimore paraqiten në (22) programe buxhetore, në përputhje me kriteret e parashikuara nga ligji nr.9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollin* i ndryshuar; ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*; ligji nr.68/2017 *ËPër Financat Vetëqeverisjes Vendore*; ligji nr.9632, datë 30.10.2006 *ËPër sistemin e taksave vendore* i ndryshuar; UMFE nr.23, datë 22.11.2016 *ËPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*; UMFE nr.6/1 datë 28.02.2018 *ËPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021*; UMFE nr.6/3, datë 10.07.2018 *ËPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor* . Gjatë hartimit të PBA (2019-2021) janë përcaktuar *ËPërshkrimi çdo programi*; *ËPolitikat e programit*; *ËQëllimi Politikës programit*; *ËObjektivat e politikës së programit*. Programimi shpenzimeve për periudhën raportuese ushtrimore viti (2020) të detajuara sipas secilit program në vlerë dhe % të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:

në/000 lekë

Nr	Shpenzimet të detajuara sipas programeve	Viti 2020	
		Vlera	%
1	Programi 1 (01110)	199,537	23
2	Programi 2 (01170)	5,400	0.6
3	Programi 3 (03140)	3,650	0.4
4	Programi 4 (03280)	14,005	1.6
5	Programi 5 (03600)	3,100	0.3
6	Programi 6 (04240)	12,850	1.5
7	Programi 7 (04260)	7,777	0.9
8	Programi 8 (04520)	27,898	3.2
9	Programi 9 (04760)	6,500	0.7
10	Programi 10 (05100)	24,500	2.8
11	Programi 11 (05200)	6,000	0.7
12	Programi 12 (05320)	34,500	4.0
13	Programi 13 (05630)	2,400	0.28
14	Programi 14 (06140)	8,050	0.9
15	Programi 15 (06330)	40,000	4.6
16	Programi 16 (06440)	2,600	0.3
17	Programi 17 (08220)	10,900	1.2
18	Programi 18 (09230)	50,400	5.8
19	Programi 19 (10140)	186,800	21.8
20	Programi 20 (10661)	2,900	0.3
21	Programi 21 (09120)	61,257	7.1
22	Programi 22 (10430)	146,000	17
	TOTALI	857,024	

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

Ndarja e shpenzimeve sipas natyrës për periudhën raportuese ushtrimore viti (2020) në vlerë e % me të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:

në/000 lekë

Nr	Shpenzimet sipas ndarjes ekonomike	Viti 2020	
		Vlera	%
1	Paga dhe sig.shoqërore	252,916	22
2	Shpenzime operative	152,067	14
3	Investimet	145,227	13
4	Llog.(600) funk.deleguara	5,788	0.5
5	Llog.(601) funk.deleguara	958	0.08

6	Llog.(602) funk.deleguara	206	0.02
7	Llog.(604) funk.deleguara	11,260	1
8	Llog.(606)	344,663	31
9	Investime nga (FZHR)	4,643	0.4
10	Investime te tjera	197,830	18
	TOTALI	1,115,558	100

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

Treguesit dhe tendenca e të ardhurave të programuara me PBA (2019-2021) të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:

Nr	Të ardhurat	2020
1	Nga taksat dhe tarifat	33,471
2	Jo tatimore	55,598
3	Trashëguar nga viti mëparshëm	0
I	Totali	89,069
1	Transferta e pakushtëzuar	274,465
2	Transfertë specifike	116,521
3	Të tjera transferta Specifike, të kushtëzuara të trashguara	0
4	Transferta e zhvillimit të rajoneve	47,769
5	Trasferta të deleguar	329,200
II	Shuma e transfertave	767,955
III	Totali i burimeve të veta (I +II)	857,024

në/000 lekë

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Për vitin 2020; Treguesit e buxhetit vjetor janë të miratuar nga Këshilli Bashkisë me vendim nr.71, datë 24.12.2019 e konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Dibër me shkresë nr. 1878/1, datë 07.01.2020, ndërsa rishikimet e buxhetit gjatë periudhës raportuese viti 2020 janë miratuar me vendime respektive VKB nr.98, datë 30.03.2020; VKB nr.116, datë 15.06.2020 dhe VKB nr.137 datë 20.08.2020 e konfirmuar ligjshmëria nga Prefektit Qarkut Dibër me shkresa respektive nr.570/1, datë 02.04.2020; nr.932/1, datë 18.06.2020 dhe nr.1326/1, datë 28.08.2020. Burimet e financimit të buxhetit të bashkisë për periudhën raportuese viti 2020 të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:

Nr	Vendimi K.B		P ë r s h k r i m i	Të ardhura	Struktura shpenzimeve	Shpenzimet
	Nr	Datë				
	71	24.12.2019	Miratim buxheti	550,210	Miratim buxheti	550,210
	98	30.03.2020				
1	116	15.06.2020	Prog.të ardhura	87,528	Art.600 Paga	215,702
2	137	20.08.2020	Të ardhura te trasheguara	10,625	Art.601 Sig.shoqërore	37,214
3			Transferta e Pakushtëzuar	261,586	Art.602	147,257
4			Transferta e pakushtëzuar e	44,002	Art.230-231 Investime	145,227
5			Transferta specifike	123,703	1% I K.Qarkut	3,000
6			Transferta specifike e	22,766	Fondi	1,810

në/000 lekë

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

Gjithashtu në buxhet çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore në dy fazat e përgatitjes, ndërsa shpërndarja e fondeve sipas programeve të dhënat paraqiten sa më poshtë:

në/000 lekë

Planifikimi i të ardhurave viti 2020		Planifikimi i shpenzimeve viti 2020	
Burimi i të ardhurave	Vlera	Emërtimi i zërave	Vlera
Të ardhura të planifikuara vitin 2020+ te trashëguarat 2019	87,528	Paga gjithsej	215,702
	10,625		
	98,153		
Grant me natyrë të përgjithshme+ te trashëguarat 2019	261,586	Sigurime shoqërore	37,214
	44,002		
	305,588		
Grant për funksione të reja	123,703	Fond per ekzekutim vendime gjyqesore	7,000
	22,766	Shpenzime operative & Fonde Shpronësimi	124,792
	146,469	Fondi Rezerve + Kontigjence	1,810
		Fondi Emergjencave civile	10,463
		Fonde per familje ne nevoje	600
		Fond per Keshillin e Qarkut	3,000
		Kontribut per Shoqaten e Bashkive	402
		Investime	145,227
		Subvencione	4,000
Total grant + të ardhura	550,210	Totali i shpenzimeve	550,210

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Nënpika(1/2)-Çelja e fondeve buxhetore të vitit e ndryshime sipas akteve normative. Kontrolli realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

Kapitull; Artikull; Nën/artikull); është kryer në përputhje me disiplinën buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga pushteti qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara të përbashkëta, si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve. Gjatë periudhës së vitit ushtrimor si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksione të deleguara, grante qeveritare, ndihma ekonomike, shpërblime për lindje, etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, të cilat janë kryer e miratuar me vendime përkatëse nga KBashkisë Bulqizë.

Për gjatë periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, buxheti ka pasur rishikime të cilat janë miratuar nga Këshilli Bashkisë me vendimet nr.98, datë 30.03.2020; nr.116, datë 15.06.2020; nr.137, datë 20.08.2020 e konfirmuar ligjshmëria nga Prefektit Qarkut Dibër me shkresat respektive nr.570/1, datë 02.04.2020; nr.932/1, datë 18.06.2020 dhe nr.1326/1, datë 28.08.2020. Për çdo muaj Drejtoria e financës ka bërë rakordim me Degën e thesarit Bulqizë, si për shpenzimet e kryera ashtu dhe për të ardhurat e realizuara me aktrakordimet përkatëse, duke ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve si në total ashtu edhe për çdo artikull e nën/artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në këtë periudhë objekt i auditimit për çeljen e fondeve me degën e thesarit Bulqizë janë respektuar të gjitha procedurat ligjore, duke pasqyruar rregullisht e periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin raportues.

-Nënpika (1/3).Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor e pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak situatës COVID¹⁹, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi;

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimi e tyre në nivel Titull; Kapitull; Artikull; Nën/artikull u konstatua se, në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore të pasqyruara sa më poshtë:

Pasqyra e realizimit të treguesve të zërave të buxhetit për viti 2020 dhe në tërësi

Nr	EMERTIMI	Viti 2020		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2020	%
1	Llog.(600)-Paga	215,702	198,721	92%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Sh	37,214	32,760	88%
3	Llog.(602-609)Shpenz.opera	152,067	135,096	88.8%
4	Llog.(230-231) Investime	145,227	103,902	71.5%
5	Llog.(600) funk.deleguara	5,788	5,580	96.4%
6	Llog.(601) funk.deleguara	958	923	96.3%
7	Llog.(602) funk.deleguara	206	120	58.3%
8	Llog.(604) funk.deleguara	11,260	9,837	87.4%
9	Llog.(606) ndihmë e burasa pa	344,663	344,071	99.9%
10	Llog.(231) Investime FZHR	9,498	4,643	49%
11	Llog.(231) Investime te tjera (AKUM)	200,063	197,830	99%
	Totali	1,122,636	1,033,483	92%

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Për vitin 2020; shpenzimet buxhetore të planifikuara në vlerë 1,122,636 mijë lekë, janë realizuar në vlerë 1,033,483 mijë lekë në masën 92%, ndërsa të detajuar sipas artikujve është:

-pagat në masë 92%; kontribute për sigurimet në masën 88%; shpenzime operative në masën 88.8% dhe investimet në masën 71.5%.

Sipas burimeve të financimit paraqiten;

-Nga transferta e pakushtëzuar; treguesit e buxhetit janë të planifikuar në vlerën 305,588 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 269,632 mijë lekë, ose në masë 88% të dhënat si më poshtë:

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	136,305	126,594	93	9,711

2	601	23,788	21,228	89	2,560
3	602	64,469	63,062	98	1,407
4	604	11,510	10,395	90	1,115
5	606	0	0		0
6	231	69,516	48,353	70	21,163
	Totali	305,588	269,632	88	35,956

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Nga transferta specifike; treguesit e buxhetit janë të planifikuar në vlerën 146,469 mijë lekë, janë realizuar në vlerën 136,165 mijë lekë, ose në masën 93%, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	79,397	72,127	91	7,270
2	601	13,426	11,532	86	1,894
3	602	27,213	26,073	96	1,140
4	231	26,433	26,433	100	0
	Totali	146,469	136,165	93	10,304

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Nga të ardhurat e veta; treguesit e buxhetit janë të planifikuar në vlerën 98,153 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 64,682 mijë lekë, ose në masën 66%, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	0	0	0	0
2	601	0	0	0	0
3	602	45,575	32,566	71	13,009
4	604	3,300	3,000	91	300
5	606	0	0	0	0
6	231	49,278	29,116	59	20,162
	Totali	98,153	64,682	66	33,471

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Nga fondet e deleguara; treguesit e buxhetit janë të planifikuar në vlerën 572,426 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 563,004 mijë lekë, ose në masën 98%, me të dhënat si më poshtë:

000/lekë

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	5,788	5,580	96	208
2	601	958	923	96	35
3	602	206	120	58	86
4	604	11,260	9,837	87	1,423
5	606	344,663	344,071	99	592
6	(231) Nga AKUM (MIE)	200,053	197,830	99	2,223
7	(231) Nga fondet FZHR	9,498	4,643	49	4,8550
	Totali	572,426	563,004	99	9,422

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Nga fondet (AKUM); treguesit e buxhetit janë planifikuar në vitin 2020 në vlerë 200,053 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 197,830 mijë lekë, ose 99%.

-Nga fondet (FZHR); treguesit e buxhetit janë planifikuar në vitin 2020 në vlerë 9,498 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 4,643 mijë lekë, ose në masën 49%.

Për sa u evidentua dhe u pasqyrua më sipër konstatohet se; midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të treguesve të buxhetit rezultojnë diferenca për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore dhe përdorimi në shpenzime i tyre. Të ardhurat e veta të planifikuara, të realizuara dhe alokuara në buxhetet respektive kanë diferenca të dukshme, duke bërë që buxheti për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 të ketë mos realizime të paraqitura në pasqyrën sa më poshtë:

Të ardhurat e realizuara dhe të përdorura në buxhetet respektive.

Periudha	Programimi, realizimi të Ardhurave		Diferenca		Planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave në Buxhet 000/lekë		Diferenca	
	Plani	Fakti	Vlerë	%	Plani fillimit Buxhetit	Fakti në thesar sipas realizimit përfshirë të trashëguara.	Vlerë	%
Viti 2020	87,528	75,048	12,480	86%	98,153	64,682	33,471	66%

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Nga të dhënat e evidentuara në këtë tabelë konstatohet se; për periudhën ushtrimore raportuese viti 2020 të ardhurat nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore janë realizuar në vlerën 75,048 mijë lekë, nga 87,528 mijë lekë planifikuar, në 86% me diferencë vlerë 12,480 mijë lekë.

-Periudha viti 2020: Struktura organizative e Bashkisë Bulqizë është miratuar me vendim të Titullarit të bashkisë nr.117, datë 10.01.2020, bazuar në VKB nr.41, datë 24.10.2019 *“Për miratimin e pagave dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të administratës së Bashkisë Bulqizë, Ndërmarrjeve dhe Njesive Shpenzuese në varësi të bashkisë Bulqizë për viti 2020”*, ligjshmëria e së cilës është shprehur nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresë nr.1527/1, datë 31.10.2019. Struktura organike e miratuar për këtë periudhë përbëhet gjithsej 385punonjës, nga të cilët 246 punonjës të bashkisë, 118 punonjës funksione të deleguara dhe 21 punonjës sezonal. Për gjatë periudhës viti 2020 struktura ka pasur ndryshime me vendim të Titullarit të bashkisë nr.2891, datë 02.07.2020 bazuar në VKB nr.117, datë 15.06.2020 *“Për miratimin e pagave dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të administratës së Bashkisë Bulqizë, Ndërmarrje e Njesi Shpenzuese në varësi të Bashkisë Bulqizë për vitin 2020”*, ligjshmëria e së cilës shprehet Prefekti Qarkut Dibër me shkresë nr.933/1, datë 18.06.2020. Pas ndryshimeve struktura organizative e miratuar për këtë periudhë përbëhet gjithsej 392 punonjës, nga të cilët 255 punonjës të bashkisë, 118 punonjës funksion të deleguara dhe 19 punonjës sezonal.

Realizimi fondit të pagave, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si edhe e numrit të punonjësve në plan dhe fakt për periudhën objekt i auditimit paraqiten me të dhënat si më poshtë:

Periudha	Paga (600)		Sigurime (601)		Numri i punonjësve	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plani	Fakti
Viti 2020	215,702	198,721	37,214	32,760	392	365

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Konkluzion; U konstatua se

a-ndërmjet treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit ka diferencë për sa i përket pjesës së të ardhurave nga taksat e tarifave vendore dhe shpenzimit të tyre më konkretisht;

-për vitin 2020 programimi të ardhurat nga niveli i taksave e tarifave vendore të planifikuar për shpenzim janë gjithësej në vlerën **87,528 mijë lekë**, ndërsa shtesat nga të ardhura të trashëguara nga viti 2019 për gjatë vitit në buxhetin fillestar janë në vlerë **10,625 mijë lekë** në total vlera prej **98,153 mijë lekë**, ndërsa shpenzime sipas realizimit faktik janë kryer në vlerë **64,682 mijë lekë**, me diferencë e duke mos realizuar shpenzimet nga buxheti fillestar në vlerë **33,471 mijë lekë**, ose në masën 66%, veprim në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* të ndryshuar; ligjin nr.68-2017 *“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”*; ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* i ndryshuar; UMFE nr.10, datë 28.02.2017 *“Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm (2019-2021) dhe (2020-2022)”* dhe UMFE nr.10/1, datë 28.02.2017 *“Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”*, UMF nr.23, datë 22.11.2016, *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”* dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak Bulqizë.

b-realizimi treguesve të të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore në masën 76%, ndërkohë që për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, detyrimet e pa realizuara në të ardhurat vendore janë në vlerë 9,694,000 lekë, c’ka tregon se burimi i krijimit të të ardhurave, si dhe vlerësimi mbledhjes së tyre, veprim në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr.9632, datë 31.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar e audituar e trajtuar me nën/pika (2/3) programi auditimit.

-Nënpika(1/4).Vlerësimi risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve FZHR, Ministri tëlinjës etj.);

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Financës në Bashkia Bulqizë, si dhe mbi të dhënat e evidentuar në pasqyrat financiare (bilanci kontabël) konstatohet se; totali faturave të palikujduara në periudhën (2020) objekt i procesit të auditimit sipas zërave në; (shpenzime për investime, mallra e shërbime dhe vendime gjyqësore), në fund të

periudhës në datë 31.12.2020 gjendja paraqitet në **vlerën totale prej 28,307,781 lekë**. Në mënyrë analitike dhe më të hollësishme për secilën periudhë raportuese ushtrimore viti (2020) detyrimet e pa likuajuara pasqyrohen sipas (**anekset nr.1;2;3, pika 1/4**) bashkëlidhur.

Risqet buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara të investimeve për periudhën raportuese viti 2020 janë konstatuar për objektet;

a- “Rikonstruksioni shkollë mesme përgjithshme Bulqizë”, në vlerë 3,415,908 leke.

b- “Rruga pedonale e rikonstruksionimi godinave+Unaza e poshtme Qyteti vjetër, Bashkia Bulqize” në vlerë 1,439,309 lekë, të financuara nga FZHR.

c- “Ndertimi Ujesjellesit fshati Peladhi, Bashkia Bulqize” në vlerë 2,223,451 lekë financiar nga Ministria e Infstrukturë Energjisë (Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve).

Gjithashtu risqe të tjera kemi konstatuar dhe shpenzime për kolaudim punime në objektet;

a- “Punime shtese per rikonstruksioni shkolles 9/vjecare Gjorice” në vlerë 15,000 lekë.

b- “Rehabilitim kanalit vadites Kovashice-Shupenze” në vlerë 33,000 të financuara nga Bashkia.

Faturat e pa likuajuara gjendje në datë 31.12.2020.

Bazuar në aktrakordimin me degën e thesarit Bulqizë rezulton se, në mënyrë të përmbledhur detyrimet e prapambetura të pa likuajuara për bashkinë me shtesa e paksime gjendje në datën 31.12.2020 është vlera prej **28,307,781 lekë** në vijim:

në/000 lekë

Subjekti	Periudha raportuese Viti 2020				Fondet e trashëguara në 31.12.2020 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog. 520 në bilanc) me vlerën e tepricave në fund
	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2019	Shtesa/Pakësime te detyrimit gjatë vitit 2020	Shlyerje gjatë periudhës viti 2020	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2020		
Bashkia	36,241,328	38,600,448	26,615,667	28,307,781	71,244,770	42,936,989

Burimi: Drejtoria Financës dhe Tatimeve Bashkia Bulqizë

Nga të dhënat e pasqyruar në **aneksi nr.4, pika 1(4)** konstatohet se:

-Fondet e trashëguara për vitin raportues kanë vlerë më të madhe se detyrimet në fund të vitit 2020, gjë që tregon se po të përdreshin këto fonde brenda vitit buxhetor, nuk do të kishte detyrime të prapambetura. Në datë 31.12.2020 njësia publike bashkia Bulqizë ka pasur detyrim të pa likuajuar i prapambetur vlerën prej **28,307,781 lekë**, si dhe fonde të pa përdorura në vlerën **71,244,770 lekë**.

Në këto kushte njësia publike bashkia Bulqizë, megjithëse nuk ka angazhime buxhetore të pa mbuluara me fonde, përsëri për periudhë 2020 rezulton me detyrime pa likuajuar të prapambetura. Vlera e detyrimeve të palikuduara sipas natyrës së detyrimit paraqiten më poshtë;

në/000 lekë

Nr	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2020
1	Detyrim për investimet	27,815,530
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	0
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	492,251
Total		28,307,781

Burimi: Drejtoria Financës dhe Tatimeve Bashkia Bulqizë

Bashkia Bulqizë rezulton se, për periudhën raportuese ushtrimore 2020 nuk ka detyrime të prapambetur ndaj DRT Dibër në lidhje me kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

Vlera dhe përqindja e mbulimit të shpenzimeve totale me të ardhurat e veta të njësisë vendore për periudhën raportuese viti 2020

në/000 lekë

Emërtimi	Shpenzimet faktike viti 2020 (Pa Nd Ekonomike dhe PAK)				
	Vlera e shpenzimit vjetor	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike	Transferta e kushtëzuar	Të ardhurat e veta	% që zënë burimet e veta tek totali i
230- Projekte	6,558	6,558	0	0	0%
231-Investime	299,817	68,228	202,473	29,116	9.7%
600-Paga	204,301	198,721	5,580	0	0%
601-Sigurime shoqërore	33,683	32,760	923	0	0%
602-Shp.operative	117,821	85,135	120	32,566	27.6%
604;6096Transferta korente	23,232	10,395	9,837	3,000	12.9%
603- Subvencione	4,000	4,000	0	0	0%
Total	689,412	405,797	218,983	64,682	9.4%

Burimi: Drejtoria Financës dhe Tatimeve Bashkia Bulqizë

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Si rezultat i realizimit i treguesve të të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave në masë 76% dhe përdorimi i të ardhurave për shpenzime në masën 90%, rezulton se deri në datë 31.12.2020, vlera e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Bulqizë është gjendje në shumën **28,307,781 lekë**.

-Nënpika (1/5). Celja dhe ekzekutimi fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

-Nëpërmjet FZHR;Gjatë vitit 2020 treguesit e buxhetit të përfituara përmes alokimit nga FZHR, janë të planifikuar në vlerë 9,498 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerë 4,643 mijë lekë, ose në masën **49%**.

në 000/lekë

Nr	Emërtimi i objektit	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të objektit	Vlera e kontratës	Vlera e pa likuiduar e kontratës	Arsyeja e mos likuidimit
1	Rruga Pedonale e rikonstruksionimi i godinave +Unaza e poshtme qyteti i vjetër, Bulqize	nr.ska prot. datë 29.05.2015	15.02.2016	101,550,698	1,439,309	Fonde pa disponueshme në Thesar nga FZHR
2	Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të përgjithshme Bashkia Bulqizë	nr.ska prot. datë 22.08.2012	30.10.2013	27,559,518	3,415,908	Fonde pa disponueshme në Thesar nga FZHR
Totali				129,110,216	4,855,217	

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxheti Bashkia Bulqizë

Detyrimet e prapambetura nga mos alokimi i FZHR, gjendje deri në datë 31.12.2020 është vlera **4,855,217 lekë** e cila sipas informacionit të Drejtoris së Financës, ka ardhur si pasojë e mos alokimit të fondeve për 2(dy) objekte investimet të cilat kanë përfunduar, ku 1(një) objekt edhe është marr në dorëzim.

-Nëpërmjet AKUM;Gjatë vitit 2020 treguesit e buxhetit të përfituara përmes alokimit nga AKUM, janë të planifikuar në vlerë 200,053 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerë 197,830 mijë lekë, në masën **99%**.

në 000/lekë

Nr	Emërtimi i objektit	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të objektit	Vlera e kontratës	Vlera e pa likuiduar e kontratës	Arsyeja e mos likuidimit
1	Ndërtim i Ujesjellesit fshati Peladhi, Bashkia Bulqize	nr.ska prot. datë 16.10.2017	Ska përfunduar	26,400,179	2,223,451	Fonde pa disponueshme në Thesar nga AKUM
Totali				26,400,179	2,223,451	

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxheti Bashkia Bulqizë

Detyrimet e prapambetyra nga mos alokimi i plotë nga AKUM, gjendje deri në datë 31.12.2020 është vlera **2,223,451 lekë**, e cila sipas informacionit të Drejtoris së Financës ka ardhur si pasojë e mos alokimit të fondit për 1 (një) objekt investim i pa përfunduar.

Për veprime e mos veprime në lidhje me mangësitë e konstatuar në planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të trajtuara më hollësishtë ngarkohen me përgjegjësi;

-z.LA, me detyrë Kryetari i Bashkisë, në cilësinë Nëpunës Urdhërues.

-z.RB, me detyrë Drejtor Drejtorisë Financës, në cilësinë Nëpunës Zbatues.

-z.nj.MU me detyrë Specialiste e Financës për Buxhetin.

Kriteri: -neni (50) òAngazhimet buxhetoreò, neni (52) òKryerja e shpenzimeveò, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni (56), ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017“Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika (62) UMFE nr.2, datë 06.02.2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò; UMF nr.5, datë 27.12.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, UMF (plotësues) nr.2, datë 10.01.2018 òPër buxhetin e vitit 2018ò, pikat (82-91) òDetyrimet e prapambetura të Njërive të Vetëqeverisjes Vendoreò; neni 70, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.

Impakti: -Mos realizimi treguesit të të ardhurave e shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve paraqet rrisht për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore,

	pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit ushtrimor buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime në interes të komunitetit. Proceset gjyqësore dhe humbja e çështjes së tyre nga njësia vendore, krijojnë efekte negative në buxhet.
Shkaku:	-Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, si dhe mos zbatimi kritereve ligjore në procesin e largimeve nga puna të punonjësve, apo të likuidimeve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	-Titullari bashkisë Bulqizë për detyrimet e pa likuiduara të faturave gjendje progresive në datë 30.12.2020 me vlerë prej 28,307,781 lekë të analizojë situatën të ndërpresë krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe të nxjerr përgjegjësi e të marrë masa për të mos patur angazhime të reja buxhetore pa fonde në dispozicion për të cilën kërkohet që; a) Për daljen nga situata e vështirë financiare të përgatis plan dhe ta dërgoj për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Bashkisë brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Ky plani i miratuar ti dërgohet edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim që të japë rekomandime konkrete për rregullimin e situatës financiare, ndërsa njësia qeverisjes vendore Bashkia Bulqizë të mos marrë asnjë angazhim tjetër buxhetor pa pasur fonde në dispozicion. b) Për rastet e vendimeve gjyqësore megjithëse janë likuiduar me fonde të periudhës raportuese viti 2020, të analizojë situatën, të nxjerr arsye e përgjegjësi për humbjen e tyre dhe efektin negativ që kanë dhënë këto vendime në buxhetin e njësisë vendore. Sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet edhe rekursit. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit.

Bashkia Bulqizë me shkresë nr.6260, datë 24.12.2021 e protokolluar në KLSH me nr.1113/4, datë 24.12.2021, ka kthyer shkresën se është njohur me projektraportin e auditimit, ndërsa bashkëlidhur të cilit nga z.RB me detyrë Drejtor i Financës dhe znj.ShO me detyrë Specialiste e Financës me shkresë 6226, datë 22.12.2021 kanë dërguar shpjegime dhe komente për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit, në lidhje me vlerësimin e raportimit financiar mbi pasqyrat pozicionit financiare në periudhën raportuese viti 2020, ku janë shprehur me objeksione si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

-Në lidhje me sa është përshkruar në projektraport për vlerësimin e raportimit mbi pasqyrat financiare të periudhës objekt auditimi shpjegohet se; për të gjitha gjetjet e trajtuara dhe të rekomanduara në projektraportin e auditimit nga Drejtoria e Financës u marën të gjitha masat ku, për të gjitha gjetjet sipas përkatësisë në të gjitha llogaritë ekonomike u bë sistemimi i tyre me saktësim të vlerave përkatëse, ndërsa disa gjetje të tjerat do të sistemohen me përgatitjen e raportimit të pasqyrave të pozicionit financiare në periudhën raportuese pasardhëse viti 2021, për të cilat gjendja dhe vlerësimi për periudhën pasardhëse ato do të japin një pasqyrë të saktë për secilën llogari ekonomike.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

*-Me shpjegimet e bëra sqarojmë se, subjekti nuk ka asnjë pretendim apo kundërshtim, ndërsa evidenton se me masat që ka marr për gjatë kësaj periudhe edhe ka bërë sistemim për secilën gjetje, për të cilën ne audituesit shtetëror të KLSH^{se} me sa shpjegohet dhe argumentohet nga subjekti i audituar **jemi plotësisht dakort** sepse; nëpërmjet shpjegimeve ky subjekt e miraton për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit dhe në përfundim pavarësisht se gjetjet dhe rekomandimet e trajtuara rezultojnë sipas subjektit të sistemuara, ato do trajtohen përsëri në Raportin përfundimtar të auditimit të pasqyruara me rekomandimet përkatëse.*

(1/6)-Anomalitë e konstatuara në programimin dhe realizimin e të ardhurave vendore nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore në njësinë publike vendore Bashkia Bulqizë.

Titulligjetjes:	-Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në procesin e programimit, krijimit dhe realizimit të të ardhurave vendore bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe përdorimi i tyre për periudhën raportuese ushtrimore viti (2020).
------------------------	---

Situata:

-Nënpika (1.6/1)-Niveli realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Për auditimin e nivelit të realizimit të të ardhurave e mënyra e përdorimit të tyre dhe vlerësimin e mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore, borxhi tatimor, për periudhën raportuese viti 2020 u mor në shqyrtim dokumentacioni i administruar në Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore sa më poshtë:

1-Regjistrat dhe Evidencat e realizimit të të ardhurave të administruara në Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën ushtrimore raportuese viti 2020.

2-Vendimi Këshillit Bashkisë nr.49, datë 06.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore (paketa fiskale) vit 2020” e konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Dibër me shkresë nr.1767/1, datë 13.12.2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

1-Niveli realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre.

Në Bashkinë Bulqizë për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 përllogaritja dhe realizimi të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore është kryer nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave e cila përbëhet nga 7(shtatë) punonjës e organizuar 1(një) Drejtor dhe 6 (gjashtë) specialistë, ku për të gjithë periudhën viti 2020, në strukturën e miratuar nga Titullari Bashkisë me vendim nr.117, datë 10.01.2020 ka qenë vakant 1 (një) Inspektor i terrenit për taksa e tarifa vendore, në NJA Krastë. Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendoreë* i ndryshuar; ligjit nr 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendoreë* i ndryshuar; ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëë* i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendoreë*; ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhuratë* i ndryshuar me ligjin nr.9483, datë 16.02.2006.i ndryshuar me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006; ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 *“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëë* i ndryshuar; ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisëë*; ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeë* i ndryshuar; ligjit nr.107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territoritë*; ligjit nr.10465, datë 29.09.2011 *“Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisëë*; ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 *“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreë* i ndryshuar; ligjit. nr.9385, datë 04.05.2005 *“Për pyjet dhe shërbimin pyjorë*; ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 *“Për fondin pyjor e kullësorë* i ndryshuar; ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 *“Për kundravajtjet administrativeë*; ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendoreë* i ndryshuar me ligjin nr.9561, datë 12.06.2006 e ligjin nr.9797, datë 23.07.2007; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinë*, nga Këshilli Bashkisë me vendim nr.49, datë 06.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore (paketa fiskale 2020)” e konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Dibër me shkresë nr.1767/1, datë 13.12.2019 është miratuar paketa fiskale për periudhën raportuese viti 2020 me ndryshime përkatëse.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore të miratuara me paketën fiskale për periudhën viti 2020 e detajuar me analizë të hollësishme për secilin nivel të tarifës e taksës të dhënat pasqyrohen në (*Aneksi nr.15, pika 1/6*) bashkëlidhur; Referuar mbi të dhënat e pasqyruara në tabelë, në lidhje me programuar dhe realizimin e treguesve të të ardhurave të miratuara me vendim nga KB nëpërmjet paketës fiskale, të rakorduar edhe me degën e thesarit Bulqizë për periudhën raportuese viti 2020 të ardhurat vendore rezultuan

sa më poshtë;

në 000/lekë

Nr	Lloji taksës dhe Tarifës	Periudha 2020		
		Plan	Fakt	%
I	TE ARDHURA TAKSAT VENDORE	24,813	22,388	90
III	TE ARDHURA NGA TARIFAT	83,862	60,049	73
IV	TË ARDHURA NGA GJOBAT	700	292	42

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria Financës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, të ardhurat vendore nga zbatimi i nivelit taksave, tarifave dhe gjobat në total nga vlera prej 109,375 mijë lekë e programuar është realizuar vlera prej 82,729 mijë lekë, ose në masën **76%** me mosrealizim vlera **26,646 mijë lekë**. Nga analiza e mosrealizimit të nivelit të taksave e tarifave të programuara konstatohet se, për disa nivele të taksave e tarifave në krahasim me planin ka mosrealizim të theksuar, ndërsa në disa nivele të taksave e tarifave vendore, megjithëse nuk janë të programuara e miratuara në paketën fiskale është pasqyruar realizimi tyre evidentuar në (**Aneksi nr.16, pika 1/6**), bashkëlidhur;

A-Mosrealizim i të ardhurave nga niveli i taksave rezultuan këta tregues:

1-Nga tatimi thjeshtuar mbi fitimin e B. Vogël janë realizuar në masë 78%

2-Nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, janë realizuar në masë 39% në të cilën përfshihen;

a-Taksa e pasurisë mbi ndërtesën me 38%

b-Taksa mbi tokën bujqësore me 16%

c-Taksa mbi truallin me 83%

3-Nga taksa e Fjetjes në hotel, megjithëse është e programuar realizimi është në masën 0%.

4- Nga taksa mbi kalimin e pronësisë, janë realizuar në masë 77%.

5- Nga taksa për licencë trageti naftë bruto e nënprodukte të saj, megjithëse është e programuar realizimi është në masën 0%.

6- Nga taksa për zënie hapsir publike, megjithëse është e programuar realizimi është në masë 0%.

7-Taksa vendore mbi te ardhurat e krijuara nga dhuratat, megjithëse kjo taksë nuk është e miratuar në paketën fiskale, rezulton e programuar në shumën 100 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 721 mijë lekë.

8-Taksa e rentes minerare, megjithëse kjo taksë nuk është e miratuar në paketën fiskale, rezulton e programuar në shumën 18,640 mijë lekë dhe e realizuar në vlerën 13,202 mijë lekë, masën 71%

9-Taksa mbi te ardhurat personale, megjithëse kjo taksë nuk është e miratuar dhe programuar në paketën fiskale, ndërsa është e realizuar në vlerë 6,156 mijë lekë.

B-Të ardhurat nga niveli i Tarifave rezultuan me mosrealizim sa më poshtë:

1-Nga tarifa drejtorisë planifikim territori, investim e kontroll projekt programuar por realizuar me 0%.

2-Nga tarifa e shërbimit veterinar janë realizuar në masë 19%.

3-Nga Tarifa në sektori pyjeve dhe kullotave janë realizuar në masë 34%.

4- Nga tarifa për qendrën e kulturës e programuar por realizuar me 0.

5-Nga tarifa shërbim e strukturave të MNZ dhe shpëtimi, e tj e programuar por realizuar me 0%.

6-Nga tarifa për ujë e pijshëm e programuar por realizuar me 0%.

7-Nga tarifa për zënie hapësirë publike e programuar por realizuar me 0%.

8-Nga tarifa të tjera administrative është realizuar me nivelin 42%.

9-Nga tarifa shërbime që kryen policia e MNZ e shpëtimi e programuar por realizuar me 0%.

C-Të ardhura nga gjobat e programimin është realizuar me nivelin 42%

Në këto kushte shkaqet dhe arsyet në mos realizimit të të ardhurave vendore nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave e gjykojmë se ndikim mundet të ketë;

a-mos planifikimi i drejtë dhe mos përcaktimi i saktë i burimit të krijimit të të ardhurave.

b-planifikim i pa argumentuar, duke marrë bazë veçanërisht toka bujqësore të pa regjistruar në kadastrë.

c-largimi banorëve e mos përdorimi tokës bujqësore, mungesa e vullnetit për të paguar detyrimet nga kryefamiljarët si dhe mos identifikimi totalit të familjeve nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore.

d-planifikimi pa argumentuar duke marrë për bazë familjet sipas gjendjes civile e jo familjet rezidente.

-Mos programimi në paketat fiskale periudha viti 2020, për sa i përket tarifës për dhënie të licencës për tregtim naftë e nënprodukteve të saj, ndonëse është detyrim për njësitë e

vetëqeverisjes vendore të parashikuar nga VKM nr.170, datë 25.04.2002 *ËPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre* i ndryshuar, VKM nr.970, datë 02.12.2015 *ËPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë* i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017, Kap.(II);Kap.(III), pika (4), (autorizim për karburantet).

Nga procesi auditimit mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore u konstatua se, në territorin e bashkisë Bulqizë për vitin 2020 e ushtrojnë veprimtarin ekonomike në aktivitet objekti *ËBiznesi vogël dhe Biznesi i madhës* më poshtë;

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në datën 31.12.2019	Regjistrime të reja	Mbyllur aktivitetin	Gjendja në datë 31.12.2020
1	Biznesi Vogël (PF)	2020	474	13	13	474
2	Biznesi Madh (Shpk)	2020	143	6	0	149
Totali			617	19	13	623

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria Financës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për këtë periudhë raportuese ushtrimore në këtë bashki, kanë ushtuar aktivitet gjithsej 623 subjekte, nga të cilët me status *ËBiznesi i vogël* gjithsej janë 474 subjekte ku regjistrime të reja janë 13 subjekte dhe kanë ndërprerë aktivitetin 13 subjekte, ndërsa me status *ËBiznesi madh* gjithsej janë 149 subjekte, ku regjistrime të reja dhe ndërprerje e aktivitetit nuk rezultojnë.

2-Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Nga procesi i auditimit mbi në të dhënat e administruara nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për Bashkinë Bulqizë rezulton se, vlera e debitorëve që rezultojnë nga biznesi i vogël i madh dhe për familjarë në mënyrë progresive dhe të kontabliuara si detyrim gjendje në datën 31.12.2020, në të cilën përfshihet niveli taksave e tarifave vendore edhe tarifa e gjelbërimit, ndriçimit, pastrimit, etj si dhe penalitete të përllogaritura për mos pagimin në afat të detyrimeve, ku në mënyrë analitike gjendje pasqyrohet sa më poshtë;

Nr	Detyrimet e debitorëve nga taksat dhe tarifaf	Për periudhën raportuese viti 2020				
		31.12.2019	Pakësime	Shtesa	(Kamatë)	31.12.2020
1	Nga Bisnesi vogël	19,265,424	1,217,918	3,692,066	189,157	21,739,572
2	Nga Bisnesi i madh	1,349,280	612,000	373,194	19,120	1,110,474
3	Nga Subjekte Kromi	39,256,321	2,448,000	8,542,570	437,665	45,350,891
4	Nga Entet Shtetërore	783,950	0	258,656	0	1,042,606
Totali		60,634,314	4,277,918	12,866,486	(645,942)	69,243,543

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria Financës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë vlerën e detyrimit debitor me shtesa e pakësimi, detyrime të cilat i përkasin subjekteve të biznesit dhe entet shtetërorë pasqyrohet sa më poshtë;

-Gjendja e borxhit në datën 31.12.2020 me progresiv pasqyrohet me vlerë 69,243,543 lekë, nga e cila pakësim vlera 4,277,918 lekë dhe shtesë vlera 12,866,486 lekë (përfshirë kamatat) nga subjekte biznesi vogël i madh, kromit dhe ente shtetërorë, në të cilat Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka bërë aplikim për nivelin e taksës për tokën bujqësore e taksat tarifaf familjare.

Në vlerën e përgjithshme të detyrimeve debitorë për sa i përket mos pagesës së nivelit për taksat dhe tarifaf vendore e evidentuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave e kontabiliteti me pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën raportuese ushtrimore gjendje në datë 31.12.2020 konstatohet një rritje e detyrimeve të pa likuiduara, ndërsa detyrimet e subjekteve ekonomike në mënyrë progresive gjendja deri në datën 31.12.2020 për bashkinë Bulqizë paraqiten në (***Aneksi nr.17, pika 1/6***), bashlëlidhur;

Detyrimet debitorë të subjekteve ekonomik nga mos likuidimi i nivelit të taksave dhe tarifave vendore të evidentuara në *aneksi përkatës* për periudhën viti 2020, gjendje sipas pasqyrohen sa më poshtë;

-gjendje në datën 31.12.2019 është shumë 60,654,975 lekë;

-gjendje e krijuar shtesë për gjatë periudhës vitit 2020 është shuma 12,866,486 lekë;

-gjendje detyrime progresive në datën 31.12.2020 është shuma 69,243,543 lekë.

Nga procesi auditimit rezulton se, detyrimet e subjekteve familjar nga mos pagesa e nivelit të taksës së tokës, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, truallit, etj, në mënyrë progresive si në bashki ashtu në Njësi Administrative gjendja me analizë deri datë 31.12.2020 paraqiten (***Aneksi nr.18,***

pika 1/6), bashkëlidhur;

DTTV nuk ka bërë kontabilizimin e vlerave të taksa e tarifa për subjektet familjare të cilat janë debitorë në të gjitha Njësitë Administrative, përjashtuar NJA Bulqizë, ndërsa detyrimet debitorë nga mos pagesa e nivelit për taksën e tokës bujqësore e analizuar sipas numrit të familjeve në secilën Njësi Administrative gjendje në datë 31.12.2020 në mënyrë progresive paraqiten me (**Aneksi nr.19, pika 1/6**) bashkëlidhur raportit;

Nga procesi auditimit në lidhje me arkëtimin e detyrimeve rezultoi se, DTTV nuk ka evidentim e administrim në lidhje me nivelin e taksës së tokës bujqësore, ndërsa detyrimet që rrjedhin nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore gjendja në datën 31.12.2020 rezulton shuma **12,866,486 lekë** e cila u përket vetëm subjekteve privat u konstatua se, DTTV në bashkia Bulqizë nuk ka ndërmarrë veprime të nevojshme ligjore të analizuar më poshtë:

a-Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore nuk ka kërkuar në Këshillin e Bashkisë për miratimin me vendim të ndërhyrjes me forcë nga Policia e Bashkiake, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve që rezultojnë debitorë ndaj bashkisë, të parashikuara nga neni (5), germa (ç), nën/pika (iii), të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar.

b-Për detyrimet debitorë të periudhës raportuese viti 2020, mbas 117 urdhër bllokimeve në llogarinë bankare, nuk ka kërkuar vendosjen e masës së detyrimit tatimor, ashtu si parashikohet nga neni (91) i ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* me ndryshime, pika (1), ku citohet se: “..... nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij, si dhe pika (2).

c-Nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, nuk janë marr masa e sigurimit të detyrimit debitor i pa paguar, sipas rastit për barrë siguroese dhe/ose barrë hipotekare për të gjitha subjektet.

d-Nga Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, si parashikon neni (93), të ligjit nr. 9920 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* pika (1), ku citohet se: *“Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.”*

e-Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në rastet kur bizneset private dhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, kërkohet të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 me ndryshime, neni (181) *“Mospagimi taksave e tatimeve”*.

f-Nga Drejtoria Taksave e Tarifave Vendore, në zbatim të UMF (*plotësuese*) nr.2, datë 19.01.2018 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”*, pika (76), sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset edhe në median lokale (të *Bashkisë*) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

2.Baza ligjore.

-Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”* me ndryshime.

-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* me ndryshime.

-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”* me ndryshime.

-Ligji nr.10926, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar.

-UKM nr.13, datë 26.04.2018 *“Për zbatimin e VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin kritereve, të procedurës dhe mënyrës dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në përlllogaritjen nivelit të taksave e tarifave, arkëtimin e detyrimeve dhe të vlerës debitorë të pa likuiduar për nivelin e taksave e tarifave vendore, bazuar në kriteret e

<p>përcaktuara në paketat fiskale trajtuar më hollësishtë ngarkohen me përgjegjësi; 1-RH me detyrë Drejtor i Taksave e Tarifa Vendore e në vazhdim. 2-BH me detyrë, Inspektor regjistrimit dhe vlerësimit të subjekteve. 3-EBme detyrë, Inspektore regjistrimit e vlerësimit të subjekteve. 4-FP me detyrë, Inspektor i Terrenit për taksa e tarifa vendore. 5-OLme detyrë, Inspektor i Terrenit për taksa e tarifa vendore. 6-EH me detyrë, Inspektor Terren për taksa e tarifa, deri 10.03.2020</p>	
Kriteri:	-Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 <i>“Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendoreë i ndryshuar; neni (70); neni (91) të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëë i ndryshuar; nenet (4); (26); (32); (34) të ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendoreë indryshuar; Ligji nr.10926, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollinë i ndryshuar; UMFE nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019ë; UKM nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin kriterëve, të procedurës dhe mënyrës dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.</i>
Impakti:	Krijimit të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe përdorimi i tyre.
Shkaku:	Mos zbatimi procedurave ligjore e nënligjore në përlllogaritjen dhe arkëtimin e vlerës debitorë për nivelin e taksave e tarifave vendore, bazuar në kriteret e përcaktuara në paketat fiskale të miratuara me VKB Bulqizë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	-Titullari i Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara debitorë shtesë për vitin 2020, nga mos pagesë e nivelit të taksave e tarifave vendore të parashikuara në paketa fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi, si dhe subjekte familjar me vlerë prej 12,866,486 lekë dhe mos programim, mos përlllogaritje dhe mos realizim i detyrimeve të lindura nga niveli për taksën e tokës, apo debitor të tjerë ndaj njësisë publike vendore Bashkia Bulqizë.
Titulli i gjetjes:	-Mangësitë e konstatuara në vlerësimin e realizimin e niveli të tarifës nga subjektet që zhvillojnë aktivitet tregtimin e naftës bruto, nënproduktet e saj, lëndë djegëse dhe gaz i lëngshëm për konsumatorët fundorë dhe përlllogaritja e pagesës së detyrimit, në përputhje me dispozitat ligjore.
Situata:	
<p><u>-Nënpika (1.6/2)-Të ardhurat e pa përlllogaritura nga zbatimi nivelit të tarifave vendore për subjektet që zhvillojnë aktivitet tregtimin në stacione të naftës bruto, nënproduktet e saj, lëndë djegëse dhe gaz i lëngshëm për konsumatorët fundorë në territorin e Bashkisë Bulqizë.</u></p> <p>Për auditimin e planifikimit dhe realizimit të burimit e krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, për periudhën ushtrimore raportuese viti 2020 u mor në shqyrtim dokumentacioni i administruar në Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Financës sa më poshtë:</p> <p>1-Dokumentet e evidencat e administruara në dosjen fizike të operatorëve ekonomik që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë në territorin e Bashkisë Bulqizë, për tarifën e lëshimit (autorizime/licencë) për periudhën raportuese viti (2020).</p> <p>2-Regjistri realizimit të të ardhurave nga “Tarifa për dhënien e licencës për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj” në periudhën raportuese viti (2020).</p> <p>3-VKB nr.49, datë 06.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore (paketa fiskale) vit 2020” konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Dibër me shkresë nr.1767/1, datë 13.12.2019.</p> <p><u>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:</u></p> <p>Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion u konstatua se; në territorin e bashkisë Bulqizë e ushtrojnë aktivitet tregtim me pakicë në pikë fundore të karburantit dhe gazit të lëngshëm gjithsej 12 OE, nga të cilët 11 OE për tregti karburanti, ndërsa 1 OE për tregti gaz i lëngshëm, ndërsa KB Bulqizë në paketën fiskale për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020,</p>	

Kap.(I) *ōTaksat vendore* pika(9) *ōTaksa për licencë tregti naftë bruto dhe nën produkteve të saj* me argumenti se; (*Bashkia Bulqizë jep licence për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Bulqizë sipas VKM nr.970 date 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017”). Megjithëse Këshilli Bashkisë ka miratuar nivelin e taksës, ndërsa Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk ka parashikuar të ardhura nga kjo taksë, si dhe nuk ka paraqitur asnjë tregues për zbatimin e nivelit të saj, ndonëse në territorin e Bashkisë përfshirë Nj A (*Bulqizë; Shupenz; Gjoric: Fushë-ullqiz; Zerqan; Ostrei: Trebisht; Martanesh*) kryejnë aktivitetet në pikë fundorë tregtim për naftë bruto, nënprodukte, lëndë djegëse dhe gaz i lëngshëm të cilët duhet pajisen me (*licencë/autorizim*), apo rinovim pas përfundimit të afatit 5 vite kalendarik të vlefshmërisë autorizimit të bazë me nivel të taksës 1.000.000 lekë për karburant, naftë bruto, lëndë djegëse dhe 100.000 lekë për njësi të shitjes gazit lëngshëm.*

Për periudhën raportuese viti 2020 në territorin e Bashkisë subjektet që ushtrojnë aktivitetet tregtim pakicë në pikë fundore karburant dhe gaz i lëngshëm të cilët duhet të pajisen me (*licencë/autorizimi*), apo rinovim, pasqyrohen në (***Aneksi nr.20, pika 1/6***) bashlëlidhur;

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë, si edhe ato në dokumentacionin e administruar në dosjen fizike të secilit operator ekonomik rezulton se, në territorin e bashkisë Bulqizë ushtrojnë aktivitetet tregtim me pakicë në pikë fundore karburanti dhe gazi lëngshëm gjithësej 18 OE, nga të cilët 15 OE për tregti karburanti, ndërsa 3 OE për tregti gaz i lëngshëm. Megjithëse KB ka miratuar nivelin e kësaj takse, ndërsa Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka programuar të ardhura për asojë edhe nuk janë realizuar të ardhura, ndërsa nga evidenca e financës e rakorduar me dëgën e thesarit pasqyrohen të ardhura të arkëtuara në vlerën **1,400,000 lekë**, ndërkohë që detyrimi i pa arkëtuar për tu pajisur me (*licencë/autorizim*) është në vlerën **prej 12,900,000 lekë** me afat për 5 vite kalendarik, nga e cila niveli i taksës për paisjen me (*licencë/autorizime*) për tregëtim karburanti është vlera **12,600,000 lekë**, për tregëtim gaz i lëngshëm vlera **300,000 lekë**.

Në këto kushte në përfundim arrihet në konkluzioni se;

Në periudhën raportuese viti 2020 për aktivitetin tregëtim në pikë fundore në stacion karburanti dhe gazi lëngshëm, pas përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit bazë me afat 5 vite kalendarik, nga DTTV duhet të pajiste me rinovim (*licencë/autorizim*) me nivel taksës shuma 1,000,000 lekë për karburant dhe 100,000 lekë për gaz i lëngshëm, ndërsa për secilin operator ekonomik me analizë të hollësishme detyrimet të ardhura të munguara pasqyrohen më poshtë;

a-Për aktivitetin tregëtim në pikë fundore në stacion karburanti;

1-Për OE *ōRO*shpk afati i autorizimt bazë i përfundon në datë 11.05.2020 i pajisur me autorizim të rinovuar në datë 19.11.2020, (4 muaj më von) me afat 5 vite kalendarike, i cili rezulton selikujduar vlerën 100,000 lekë, ndërsa detyrimi duhet të jetë me vlerën 1,000,000 lekë/vit, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 900,000 lekë e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.**

2-Për OE *ōTD*shpk afati i autorizimt bazë përfundon në datë 21.10.2020, i pajisur me autorizim të rinovuar në datën 24.06.2021, (8 muaj më von) me afat 5 vite kalendarike, i cili rezulton se ka likujduar vlerën 200,000 lekë, ndërsa detyrimi duhet të jetë me vlerën 1.000,000 lekë, për pasojë detyrimi shtesë i pa likujduar është për **shumën 800,000 lekë e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.**

3-Për OE *ōMö*shpk afati i autorizimt bazë përfundon në datë 21.05.2020, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është i pajisur me autorizim të rinovuar me afat 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej **1.000,000 lekë, për pasojë detyrimi shtesë i pa likujduar është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.**

4-Për OE *ōXh*shpk afati i autorizimt bazë përfundon në datë 31.01.2020, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është i pajisur me autorizim të rinovuar me afat 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej **1.000,000 lekë, për**

pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

5-Për OE òTOëshpk në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizimt bazë, ndërkohë që ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 14.04.2008, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është i pajisur me autorizim bazë, apo të rinovuar me afat 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej **1.000,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

6-Për OE òDëshpk në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizimt bazë, ndërsa është pajisur me autorizim të rinovuar në datën 03.02.2021, afati 5 vite kalendarike, ndërkohë që ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 17.06.2013, për të cilën nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej **1.000,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **humën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

7-Për OE òXhOëshpk në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizimt bazë, ndërsa është pajisur me rinovim në datën 03.11.2021 afat 5 vite kalendarike, ndërkohë që ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 22.02.2013, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej **1.000,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

8-Për OE òTëshpk në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizimt bazë, ndërkohë ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 18.10.2011, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është i pajisur me autorizim bazë, apo me autirizim të rinovuar afati 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej **1.000,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

9-Për OE òMMëshpk në dosjen fizike e administruar në DTTV nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizimt bazë, ndërkohë që ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 23.06.2009, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është pajisur me autorizim bazë, apo me autorizim të rinovuar afati 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën **1.000,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

10-Për OE òIOëshpk autorizimi bazë është lëshuar në datë 21.09.2017, me afat të pajisies me rinovim të autorizimit në datën 20.09.2022, periudhë e cila është jashtë objektit të auditimit pra periudhës së vitit 2020 afati 5 vite kalendarike, ndërsa rezulton se, për këtë periudhë ka likujduar vlera e detyrimit për periudha paraardhëse shumë prej **600,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 400,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

11-Për OE òSëshpk autorizimi bazë është lëshuar në datë 09.06.2021 me afat të pajisies me rinovim të autorizimit në datën 08.06.2026, megjithëse periudha është jashtë objektit të auditimit, pra periudhës së vitit 2020 afat 5 vite kalendarike, ndërkohë ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 08.06.2020, ndërsa për këtë periudhë nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën **1.000,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

12-Për OE òJëshpk autorizimi bazë është lëshuar në datë 26.05.2013, me afat të pajisies me autorizim të rinovim në datë 25.05.2018, megjithëse periudha është jashtë objektit të auditimit pra periudhës së vitit 2020 afati 5 vite kalendarike, ndërsa rezulton se, për këtë periudhë ky OE nuk ka likujduar vlera e detyrimit prej **1.000,000 lekë**, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

13-Për OE òKëshpk në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizim bazë, ndërkohë që ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 12.03.2010, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është i pajisur me autorizim bazë, apo me autorizim të rinovuar me

afat 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej 1.000,000 lekë, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

14-Për OE òVòshpk në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizim bazë, ndërkohë që ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 30.03.2016, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është i pajisur me autorizim bazë, apo me autorizim të rinovuar me afat 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej 1.000,000 lekë, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 1,000,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

15-Për OE òDKòshpk në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizim bazë, ndërkohë që ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 13.04.2016 me palikimin status **ò pezulluar**, ndërsa deri në datën e akt konstatimit rezulton se, nuk është i pajisur me autorizim bazë, apo me autorizim të rinovuar me afat 5 vite kalendarike, nuk ka likujduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej 1.000,000 lekë, për pasojë për deri sa të verifikohet stautsi i tij deri në mbyllje aktiviteti nuk i përlllogaritimi detyrim shtesë.

b-Për aktivitetin tregëtim në pikë fundore në stacion gaz i lëngshëm:

1-Për OE òVKòshpk për aktivitet tregëtim pikë fundore gaz i lëngshëm, në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizim bazë, megjithëse ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 18.01.2011, ndërsa deri në datën e akt konstatimit nuk është pajisur me rinovim me afat 5 vite kalendarike, për të cilën nuk ka likuiduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej 100,000 lekë, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 100,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

2-Për OE òDòshpk për aktivitet tregëtim pikë fundore gaz i lëngshëm, në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizim bazë, megjithëse ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 17.06.2013, ndërsa është pajisur me autorizim të rinovuar në datën 03.02.2021 me afat 5 vite kalendarike, megjithëse periudha është jashtë objektit të auditimit pra periudhës së vitit 2020, nuk rezulton se ka likuiduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën 100,000 lekë, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumen 100,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e paprogramuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

3-Për OE òSòshpk për aktivitet tregëtim pikë fundore gaz i lëngshëm, në dosje nuk evidentohet të jetë i pajisur me autorizim bazë, megjithëse ky OE rezulton i regjistruar në QKB me aktivitet që nga data 01.02.2010, ndërsa deri në datën e akt konstatimit nuk është pajisur me rinovim me afat 5 vite kalendarike, për të cilën nuk ka likuiduar detyrimin i cili duhet të jetë me vlerën prej 100,000 lekë, për pasojë detyrimi shtesë është për **shumën 100,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkia Bulqizë.

Në përfundim të ardhurat e munguara për buxhetin e Bashkia Bulqizë, si pasojë e mos programimit të nivelit të taksës për paisje me (licencë/autorizime) të tregëtimit në pikë fundore të karburantit dhe gazit të lëngshëm për tu arkëtuar është vlera **prej 12,900,000 lekë**, si pasojë e mos administrimit të dokumentimit bazë, të mos pagesës së nivelit të tarifës përkatëse pas rinovimit të autorizimit, megjithëse është përfshirë në paket fiskale, veprime në mospërputhje me kriteret e përcaktuara nga neni (35), i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar; VKM nr. 970, datë 02.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017, Kap.(II); Kap.(III), pika 4, citohet se:

II. Procedura për dhënien e autorizimeve

Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.

III. Pagesat

Dhënia e lejeve të tregëtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues. Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:

1- për lejet e tregëtimit të llojit "A " 500.000 lekë

2- për lejet e tregëtimit të llojit "B" 200.000 lekë

3- për lejet e tregëtimit të llojit "C" 200.000 lekë

4- për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazit të lëngshëm, vajrash lubrifikante të stacioneve të mbushjes së bombolave të **gazit të lëngshëm 100.000 lekë**.
5- për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse 50.000 lekë.
Tarifat për përsëritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave të mësipërme.

-Kap (II), pika (1), germa (b) e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017, ku citohet se:*

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

1.Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajrave lubrifikante dhe të njëjstëve të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe të njëjstëve të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Paguesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajrave lubrifikante është 5.000.000 (pesë milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 2.000.000 (dy milionë) lekë për Bashkitë e tjera.

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, date 19.04.2017.

"9. Paguesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3.000.000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **1.000.000 (një milion) lekë për Bashkitë e tjera.**"

10.Paguesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1.000.000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200.000 (dyqind mijë) lekë për Bashkitë e tjera.

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, date 19.04.2017.

"10.Paguesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500.000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **100.000 (njëqind mijë) lekë për Bashkitë e tjera.**"

15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit, apo të tregimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

-VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kap.(II), pika 1; germa *“*öbë dhe pika 15.

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë..

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

Për të dokumentuar procedurat për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, ku;

Pika 1.Dhënia e licencave për stacione shitje fundore për tregtim me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet e vajrave lubrifikante dhe njësi të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë bëhet nga:

-Organet e qeverisjes vendore sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njëjstëve të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera. Dosja duhet të përmbajë;

- a) Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrimit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës bruto;
- c) Certifikatën e përdorimit të objektit, të lëshuar nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit;
- ç) Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës;
- dh) Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin;
- e) Autorizimin hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës;
- ë) Regjistrimin e markës tregtare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave;
- f) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve vendore;
- g) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, përfshirë sigurimet shoqërore.

Pika3. Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore. Personi juridik, që kërkon të pajiset me këtë licencë, duhet të paraqesë, në njësitë e qeverisjes vendore, dokumentet e përcaktuara në shkronjat òaö;öcö;öçö;ödhö, pika 2, të këtij Kreu, si dhe certifikatën e kalibrimit të enëve dhe të aparateve të shitjes, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit.

Pika4. Organet që kanë përgjegjësi për dhënien e licencave, sipas këtij kreu, ushtrojnë kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e personit juridik kërkues.

Nga auditimi i dokumentacioni që është administruar në dosjen fizike të secilit operator ekonomik u konstatu se, Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore për 11 OE që tregëtojnë në pikë fundore karburant dhe 1 OE që tregëton në pikë fundore gaz të lëngshëm, nuk ka të administruar e dokumentuar autorizimin bazë dhe afatin e rinovimit të autorizimit, nuk ka të evidentuar saktësisht vlerën e arkëtuar në momentin e paisjes me autorizimin bazë, apo rinovimin në periudhën objekt auditimit, çka ka sjellë të ardhura të munguara të pa programuara në buxhetin e bashkisë Bulqizë të analizuara hollësisht më sipër.

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore për mos administrimin, dokumentimin, apo rinovimin e autorizimit për njësi të shitjes së karburantit, lëndës djegëse dhe bombola të gazit të lëngshëm për përdorim nga konsumatorët fundorë me afat rinovim për 5 vite trajtuar hollësisht ngarkohen me përgjegjësi:

1-RHme detyrë, Drejtor i Taksave e Tarifa Vendore e në vazhdim.

2-BH me detyrë, Inspektor i regjistrimit e vlerësimit të subjekteve.

3-EB me detyrë, Inspektore regjistrimit e vlerësimit të subjekteve.

4-FP me detyrë, Inspektor i Terrenit për taksa e tarifa vendore.

5-OL me detyrë, Inspektor i Terrenit për taksa e tarifa vendore.

6-EH me detyrë, Inspektor Terreni për taksa e tarifa deri 10.03.2020.

Kriteri:	-neni 35, i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 <i>“Për Sistemin e Taksave Vendoreë i ndryshuar; Kap.(II); Kap.(III), pika 4: Kap (II), pika (1), germa (b); pika (15) e VKM nr. 970, datë 02.12.2015 <i>“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 <i>“Për ndryshimin e VKM nr.970, datë 2.12.2015 <i>“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto e nën produkteve të sajë.</i></i></i></i>
Impakti:	-Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit si pasojë e mos administrimit të dokumentimitit bazë, apo të mos pagesës së nivelit të tarifës përkatëse pas rinovimit të autorizimit e përfshirë në paketat fiskale.
Shkaku:	-Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkia Bulqizë, për të pajisur me (<i>licencë/autorizim</i>) me afat 5 (pesë) vite kalendarik për operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitet tregtim karburanti për përdorim nga konsumatorët fundorë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	-Titullari i Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën, të marrin masa të menjëhershme për të pajisur, apo rinovuar me (<i>licencë/autorizim</i>) me afat 5 (pesë) vite kalendarik, operatorët ekonomik të cilët

	<p>ushetrojnë aktivitete për qëllime biznesi me veprimtari tregtim në stacione karburanti e gaz i lëngshëm për përdorim nga konsumatorët fundorë në territori bashkisë Bulqizë, ndërkohë që këta OE nuk janë të pajisur me (licencë/autorizim), ndërsa nga mos administrimi i autorizimit bazë, apo rinovimit të autorizimit të parashikuar në paketën fiskale viti 2020, ka sjellë mos pagesë të nivelit të tarifës përkatëse, për pasojë shuma e përlllogaritur prej 12,900,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë.</p>
--	--

Nga z.E B me shkresë nr.s'ka, datë 13.12.2021 e protokolluar në KLSH me nr.1113/3, datë 15.12.2021, janë dërguar shpjegime në lidhje me përgjegjësinë me detyrë në cilësinë Inspektor i terrenit për taksa e tarifa vendore për periudhën (nga data 20.02 deri datë 19.05.2020), i evidentuar në aktkonstatimin nr.4, datë 03.12.2021, ku është shprehur si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:-Në lidhje për sa jam ngarkuar me përgjegjësi për periudhën e caktuar në aktkonstatim z.E shpjegon se;

-me bashkinë Bulqizë kam qenë në konflikt gjyqësor dhe pas vendimit të gjykatës i cili ka marr formën të prerë për rikthim në vendin e punës në pozicionin e mëparshëm “Njësia e integritit Europian”, ndërsa bashkia nuk zbatoi vendimin e gjykatës, ndërsa më emëroi në pozicionin “Inspektor terreni për taksa e tarifa vendore” detyrë të cilën nuk e pranova dhe nuk u paraqita në punë, duke e konsideruar emërim të pa ligjshëm, për pasojë edhe nuk mund të mbaj përgjegjësi për sa jam trajtuar me përgjegjës në aktkonstatim, për të cilën ju kërkoj heqjen e emrit tim nga përgjegjësia.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa është pasqyruar në shpjegimet e dërguara nga z.EB në lidhje me përgjegjësin e tij në cilësinë Inspektor Terreni për Taksa e Tarifa Vendore sqarojmë se; z.EB u evidentua si përgjegjës sepse emëri i tij sipas strukturës organigamë e vendosur në dispozicion nga Sektori i burimeve njerëzore me emërim pikërisht në pozicionin “Inspektor Terreni për Taksa e Tarifa Vendore”, ndërsa është ngarkuar edhe me përgjegjësi për sa shpjegohet dhe argumentohet, ne audituesit shtetëror të KLSH^{së} **jemi plotësisht dakort** sepse; nëpërmjet subjektit saktësohet mos prezenca në punë, si dhe mos përfshirja në listëpagesat e periudhave që pretendohet për detyrën funksionale e saktësuar edhe nga zyra e financës, në përfundim shpjegimi merret në konsideratë, ndërsa emri i tij nuk do të evidentohet si përgjegjës për mangësitë në realizimin e të ardhurave dhe nuk do të pasqyrohet edhe në Raportin përfundimtar të auditimit.i

Titulli gjetjes:	-Mangësitë në vlerësimin e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore, nga subjektet me seli jashtë territorit të bashkisë (NIPT sekondar), të cilët kanë kryer punë publike nga shpallja fitues në procedura prokurimi në AK bashkia Bulqizë.
-------------------------	--

Situata:

-Nënpika (1.6/3)-Të ardhurat e pa llogaritura nga zbatimi nivelit të tarifave vendore për subjektet edhe me seli jashtë territorit të bashkisë Bulqizë (NIPT Sekondar) të cilat kanë kryer punime publike si pasojë e shpalljes fitues në procedurat e prokurimit të realizuara nga AK Bashkia Bulqizë.

Për auditimin e planifikimit, realizimi të ardhurave bazuar në kuadri rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, periudha ushtrimore raportuese viti 2020 u mor në shqyrtim dokumentacioni i administruar në Drejtoria e Financës, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore dhe Njësia e Prokurimit sa më poshtë:

1-Paketa fiskale “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Bulqizë për periudha raportuese viti 2020”, në të cilën KB ka miratuar tarifatat për (pastrim, gjelbërim e ndriçim), sa më poshtë;

-Pika 1-“Tarifa e pastrimit (subjekte ndërtimi)“Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi.”, niveli tarifës është me 100,000 lekë/vit;

-Pika 2-“Tarifa ndriçimit” (bizneset)“biznesi madh, NjA Bulqizë”, niveli tarifës është me 3,000 lekë/vit;

-Pika 3-“Tarifa e gjelbërimit” (bizneset)“Biznesi madh, NjA Bulqizë”, niveli tarifës është me 3,000 lekë/vit;

2-Rregjistri realizimit të procedurave të prokurimit me objekt; (punë publike) për periudhën raportuese viti 2020.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

Nga auditimi mbi dokumentacionin e administruar në regjistrin e realizimit të prokurimit publik dhe në kontratat e lidhura për punë publike në periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, përlllogaritjet e tarifave sipas afatit të përfundimit të punimit për subjektet që kanë krye në

territorin e Bashkisë Bulqizë punë publike me veprimtari në vendndodhjen e objektit të kontratës (NIPT sekondar) me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit në periudhën raportuese ushtrimore viti 2020) sipas paketave fiskale pasqyrohen në (***Aneksi nr.21, pika 1/6***) bashkëlidhur;

Nga analiza e të dhënave në tabelë rezulton se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në bashkinë Bulqizë, nuk ka përllogaritur e aplikuar nivelin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për 7 (shtatë) operatorë ekonomik që kanë kryer punë publike në territorin e bashkisë e njësitë administrative në vartësi, të cilët me bashkinë Bulqizë kanë lidhur 12 kontrata për punë publike, ndërsa përpara fillimit të punimeve këta OE nuk kanë aplikuar në QKB për të hapur në vendin e ushtrimit të veprimtarisë (sipas vendndodhjes së objektit të kontratës) vend i ndryshëm nga selia e OE, për pasoj këta OE nuk janë ngarkuar me detyrime për nivelin e tarifave të pastrimit, gjelbërimit e ndriçimit për veprimtarinë në vendndodhjen e objektit të kontratës, të miratuara me paketën fiskale. Përllogaritja e detyrimeve për nivelin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit e ndriçimit në periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 sipas aftatit të kontratës së punë publike të evidnetuara (NIPT sekondar) detyrimet paraqiten në (***Aneksi nr.22, pika 1/6***), bashkëlidhur; Ndërsa në mënyrë të përmbledhur dhe sipas operatorëve ekonomik të cilat kanë lidhur kontrata për punë publike detyrimet e pa përllogaritura për nivelin e secilës tarifë gjendja pasqyrohet sa më poshtë;

Nr	Operatorët Ekonomik	NIPTI	Periudhat	Nr kontratave	Totali për pagesë
1	oSöshpk	J77304706L	2020	2 kontrata	106,000
2	oAF Göshpk	L32005501M	2020	2 kontrata	159,000
3	oEöshpk	J96829419D	2020	3 kontrata	265,000
4	oAKöshpk	K06626411C	2020	2 kontrata	106,000
5	oEAöshpk	K66613407H	2020	1 kontratë	106,000
7	Ci	J67902718S	2020	2 kontrata	212,000
					945,000

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga tabela e mësipërme .

Nga të analiza e të dhënave të pasqyruara në tabelën e mësipërme rezulton se, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, niveli i pa përllogaritur për aplikimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit e ndriçimit të miratuara me paketën fiskale të pa ngarkuara si detyrime për operatorët ekonomik është **vlera 945,000 lekë e konsideruar e ardhur e munguar e pa programuar për Buxhetin e Bashkisë Bulqizë**. Veprime në mospërputhje me neni 43 pika (1/1), të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 *oPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *oPër sistemin e taksave vendore* i ndryshuar, Kreu (VII), neni 35 *oTaksat vendore dhe administrimi tyre*; neni 43 *oPërditësimi i thë dhënave të regjistrimit*, pika (1) ku citohet se; *oTatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në QKR, siç përcaktohet në ligjin nr.9723, datë 03.05.2007“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pika (3), gërma (d) (Vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia)*; të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *oPër procedurat tatimore Republikën e Shqipërisë* i ndryshur pika (1/1), ku citohet; *oNë përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia”; UMF nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 43/1/dhe VKB Bulqizë nr.49, datë 06.12.2019 *oPër miratimi paketës fiskale viti 2020* pikat 6;7;10, citohet se;*

Për periudhat raportuese viti 2020:

-Pika 6. Tarifa e Pastrimit dhe Largimi i Mbeturinave

-Nënpika 15 “Firmat e ndërtimit” me tarifë 100,000 lekë në vit.

-Pika 7-Tarifa e Gjelbërimit;

-Nënpika 15 “Firmat e ndërtimit dhe sha” me tarifë 3,000 lekë në vit;

-Pika 10-Tarifa e Ndriçimit;

-Nënpika 1 “Firmat e ndërtimit e karburantet” me tarifë 3,000 lekë në vit

Për veprimet e mos veprimet e analizuar më sipër në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore për arkëtimin e vlerës e pa programuar në nivelin e

<p>taksave dhe tarifave vendore, bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit public dhe procedurave tatimore të trajtuara hollësisht ngarkohen me përgjegjësi:</p> <p>1-RH me detyrë, Drejtor i Taksave e Tarifa Vendore e në vazhdim. 2-BH me detyrë, Inspektor i regjistrimit e vlerësimit të subjekteve., 3-EB me detyrë, Inspektore regjistrimit e vlerësimit të subjekteve. 4-FP me detyrë, Inspektor i Terrenit për taksa e tarifa vendore. 5-OL me detyrë, Inspektor i Terrenit për taksa e tarifa vendore. 6-EH me detyrë, Inspektor Terreni për taksa e tarifa, deri 10.03.2020</p>	
Kriteri:	-Kreu (VII), neni 35; pika (1/1), neni 43, të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 <i>“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”</i> i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 <i>“Për sistemin e taksave vendore”</i> i ndryshuar; UMF nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar dhe <i>Vendimi Këshillit Bashkisë nr.49, datë 06.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore (paketa fiskale) vit 2020”</i> .
Impakti:	-Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit si pasojë e mos administrimit të dokumentimit bazë, apo të mos pagesës së nivelit të tarifës përkatëse pas rinovimit të autorizimit e përfshirë në paketat fiskale.
Shkaku:	-Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga Sektori Taksave e Tarifave Vendore në Bashkia Bulqizë, për të përpllogaritur këtë nivel tarife për operatorët ekonomik me seli jashtë teritorit të bashkisë Bulqizë, por ushtrojnë aktivitet dhe kanë lidhur kontrata pune nga nga fondet publike të alokuara për investime në bashkinë Bulqizë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	-Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjehershme për të përlllogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi e mos zbatimi i nivelit për tarifën vendore nga 7 OE me seli brenda, apo jashtë teritorit të bashkisë Bulqizë, të cilët ushtrojnë aktivitet për kontrata të lidhura në punë publike nga fondet për investime, për pasojë shuma 945,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë.
Titulli gjetjes:	-Mangësitë e konstatuara në vlerësimin, përlllogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore nga subjektet që zhvillojnë aktivitet tregëtar në fushën e nxjerrjes së mineralit, si dhe mos përlllogaritje e pagesës së detyrimit.
Situata	
<p><u>Nënpika (1.6/5)-Të ardhurat e krijuara nga shfrytëzimi lejeve minerare të miratuara në AKBN me status “aktiv” në territorin e bashkisë Bulqizë.</u></p> <p>-Për auditimin e realizimit e nivelit të të ardhurave, mënyra e përdorimit të tyre dhe vlerësimi mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore, borxhi tatimor për periudhën raportuese viti 2020 u mor në shqyrtim dokumentacioni i administruar në Drejtorinë e Financës, Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtorinë e Monitorimit të Pyje e Kullota sa më poshtë;</p> <p>1-Regjistri lejeve minerare i publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për OE me (status aktiv) deri në 31.12.2020 të pajisur me leje minerare nga Ministria e Energjetikës, Industrisë me aktivitet tregëtar në fushën minerare në territorin e Bashkisë Bulqizë.</p> <p>2-Dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, në dosjet e kontratave të qirasë të lidhura nga bashkia Bulqizë me subjekte juridike private për përdorimin për shfrytëzim të sipërfaqeve nga fondi pyjor/kullosor e dhënë me qira e asetit publik në pronësi të bashkisë.</p> <p>3-Raporti teknik i vlerësimit si pjesë integrale i administruar në dosjen e kontratës, në lidhje me vlerën e përlllogaritur të vlerës qirasë detyrim vjetor për arkëtim nga operatori ekonomik.</p> <p>4-Regjistri i realizimit të të ardhurave i rakorduar me degën e thesarit nga arkëtimi i vlerës vjetore të qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të bashkisë në periudhën raportuese viti 2020.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:</i></p>	

Bazuar mbi të dhënat që evidentohen në regjistrin e lejeve minerare i publikuar në faqen zyrtare të AKBN^{së} për të gjitha OE me status **ōaktivō** gjendje deri në 31.12.2020 të cilët kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare të pajisur me leje minerare dhe kanë marr në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullor në territorin e bashkisë Bulqizë të pasqyruara në (**Aneksi nr.23, pika 1/6**) bashkëlidhur raportit.

Nga të dhënat e pasqyruara në regjistrin e AKBN^{së}, në lidhje me OE që kryejnë aktivitet tregëtar në fushën minerare në territorin e bashkisë Bulqizë, nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Financës u kërkua vendosja në dispozicion e të gjithë dokumentacionit që është i administruar në dosjet përkatëse për secilin OE me informacion për veprimet e kryer nga këto drejtori për të saktësuar;

-në se këta OE e kryejnë aktivitet minerar në territorin Bashkia Bulqizë;

-në se janë plotësuar me dosje përkatëse për çdo OE’

-në se janë analizuar të dhënat e lejes së publikuar nga AKBN

-në se është saktësuar sipërfaqja e evidentuar në leje;

-në se është bërë verifikimi në terren për sipërfaqenë përdorim nga fondi pyjor/kullor;

-në se gjatë kësaj periudhe kryejnë aktivitet tregtar status “aktiv” sipas lejes minerare;

-në se janë lidhur kontrata qiraje çdo OE për sipërfaqe në përdorim në “**Ha**” dhe vlerë;

-në se janë evidentuar investime të kryera nga vet OE në territor;

Nga auditimi mbi të gjithë dokumentacionin e sipërcituar i vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, si përgjegjëse për mbikëqyrjen, realizimin ndjekjen dhe lidhjen e kontratave të qirasë operatorët ekonomik subjekte privat u konstatua se, në territorin e bashkisë Bulqizë e kryejnë aktivitetin tregtar në fushën minerare dhe kanë marr në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullor gjithsej 128 OE me sipërfaqe në përdorim për **S=108.51 Km²** e konvertuar në sipërfaqe prej **S=10851 Ha**.

Bazuar mbi dokumentacionin e administruar në secilën dosje fizike, si dhe mbi të dhënat e pasqyruara në regjistrin e lejeve minerare të evidentuara në aneksin përkatës konstatohet se, në regjistrin e lejeve minerare evidentohet edhe 5 operator ekonomik subjekte private të cilët janë të pajisur me leje minerare, ndërsa nuk kanë në përdorim për shfrytëzim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullor, sepse në leje pasqyrohet me 0 (Zero), për pasoj nga këta OE nuk mund të kërkohet arkëtim i nivelit të tarifës për përdorim të fondit pyjor/kullor, pasi aktivitetin e ushtrojnë në **ōgaleri nëntokësorë** me të dhënat sa më poshtë;

Nr	Nr. Leje	Date	Emri i subjektit	Nipt	Bashkia	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	S=km2	S=ha
1	677	nk	AM&Ch	L52228034M	Zona "D"	Krom			0
2	677	nk	AI	J86906408N	ZONA I	Krom			0
3	1069	28.08.2007	B shpk	K72031005J	Bulqizë	VërvjaTëmovë	Krom		0
4	1214/2		KIF	L26718401H	Bulqizë	Gal. 42, zonaD			0
5	1483	nk	AM sh.p.k	K86806401B	Bulqizë	gal.43 Bulqize			0
								0	0

Shënim; Të dhënat e disponuar nga të leja minerare, si edhe kontratat e lidhura

Në këto kushte rezulton se, tashmë në territorin e bashkisë Bulqizë janë **123 OE (128-5)** të cilët kanë në përdorim sipërfaqen nga fondi pyjor/kullor me qira në total prej **10,851Ha**, ndërsa bashkia Bulqizë nga 123 OE të cilët evidentohen se kanë në përdorim për shfrytëzim sipërfaqen konstatohet se, ka lidhur kontrata qiraje vetëm me 12 OE me të dhëna të paraqitur në (**Aneksi nr.24, pika 1/6**) bashkëlidhur; Nga të dhënat e pasqyruara në këtë aneks përkatës rezulton se, bashkia Bulqizë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullor administron dhe dokumenton vetëm për 12 kontrata të lidhura bashkëlidhur së cilës është raporti teknik i vlerësimit pjesë integrale e kontratës me përllogaritjen e vlerës së qirasë për sipërfaqen e kontraktuar prej **573 ha**. Vlera e detyrimit të arkëtuar për nivelin e tarifës së qirasë për periudhën raportuese 2020 në **lekë/ha/vit** me hollësi për secilën kontratë të lidhur dhe nivel tarife pasqyrohen në (**Aneksi nr.25, pika 1/6**) bashkëlidhur;

Nga të dhënat e pasqyruara në këtë aneks përkatës për periudhën deri në datë 30.12.2020 bashkia Bulqizë nga 12 kontrata të lidhura për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullor ka realizuar të ardhura në vlerën **187,729 lekë**, ndërkohë referuar në përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas raportit teknik të vlerësimit dhe përllogaritjes së nivelit të tarifës për lekë/ha/vit e parashikuar me VKM nr.391, datë 21.06.2006 **ōPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve**

dhe kullotaveö i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 òPër ndryshimin e VKM nr.391, datë 21.06.2006ò rezulton se; bashkia Bulqizë me OE të cilët kanë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor ka lidhur vetëm 12 kontrata qiraje për sipërfaqen **40.975 Ha**, ndërkohë në regjistrin e lejeve minerare të miratuara, sipërfaqja nga fondi pyjor/kullosor në përdorim nga këta 12 OE është për **543.22 Ha**, për pasojë sipërfaqja **502.245 Ha** është diferencë sipërfaqe e pa kontraktuar.

Në këto kushte përlllogaritja e vlerës së nivelit të tarifës së qirasë mbi sipërfaqen në kontratë, njëkohësisht edhe detyrim në paketa fiskale viti 2020 konkretisht; (Kap.II òTARIFAT VENDOREö; Pika 8 òTarifa në sektori pyjeve e kullotaveö; germa -eö òdhënie me qira të fondit pyjor e kullosor...ö, me nivel të tarifës e miratuar nga KB me argumentin se; ò...si në vendimi këshillit të ministrave nr.1064 dt 22.12.2010 “Struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë”), rezulton diferencë e pa arkëtuar në vlerën **prej 40,716,251 lekë**, konsiderohet e ardhur e munguara e pa programuar për buxheti bashkisë Bulqizë.(40903980-187,729).

Në përfundim konstatohet se, përveç 12 OE që kanë lidhur kontrata qiraje, në territorin e bashkisë Bulqizë e kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare dhe kanë në përdorim sipërfaqe nga fond pyjor/kullosor edhe 111 OE, të cilët rezulton se, nuk kanë lidhur kontrata qiraje, pasqyruar në (Aneksi nr.26, pika 1/6) bashkëlidhur;

Nga të dhënat e pasqyruara në këtë aneks përkatës rezulton se, për periudhën deri në datë 30.12.2020 për sipërfaqen **10,278 Ha** (si diferencë ndërmjet sipërfaqes totale dhe sipërfaqes së kontraktuar10851ha-573ha,) në përdorim të 111 OE, bashkia Bulqizë nuk ka të administruar asnjë dokument në lidhje me këta OE, nuk ka lidhur kontrata qiraje megjithëse kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare me sipërfaqen në përdorim, për pasojë edhe nuk ka realizuar të ardhura vendore të programuara në paketën fiskale viti 2020; Në këto kushte **shuma prej 801,684,000 lekë** konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë (10,278ha x78,000 lekë/ha/vit), si pasojë e mos administrimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor dhe mos lidhjes kontrata qiraje me nivelin e tarifës minimale.

Në përfundim arrihet në konkluzionin se;

a-Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, nuk ka të administruar për të gjitha subjektet private të pajisur me leje minerare nga AKBN dhe QKL me status “aktiv” deri në datë 31.12.2020 në territorin e bashkisë Bulqizë të cilët kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare dhe kanë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor, aset publik në pronësi të bashkisë.

b-Bashkia Bulqizë nuk ka përpiluar raporte studimi tekniko-ekonomik për të dokumentuar çdo ndryshim që mund të ketë pësuar sipërfaqja e fondit pyjor/kullosor apo in produktiv, aset në pronësi publike e marrë në përdorim me qira nga subjektet sipas lejeve minerare.

c-Në territorin e bashkisë Bulqizë kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare me status “aktiv” të pajisur me leje minerare nga AKBN, miratuar nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (MEI) gjithsej 128OE, ndërsa bashkia ka lidhur vetëm 12 kontrata për dhënie me qira në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor.

d-Këto 12 kontrata qiraje të lidhura për dhënie në përdorim të asetit publike pronë e bashkisë, janë të administruara nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, ndërsa nuk janë të administruara nga (Sektori Juridik) i miratuar me strukturë organizative bashkia Bulqizë e miratuar nga Titullari i bashkisë me vendim nr.119, datë 13.01.2020 “Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin, detyrat dhe kompetencat lidhur me veprimtarin e administratës së bashkisë dhe institucionet në vartësi”, me neni (59) “Sektori Juridik”, neni (60) “Përgjegjësi i sektorit juridik (Detyrat)”, pika (13) ku citohet se; “Harton kontratat sipas klasifikimit të tyre në bazë të procedurës, duke mbrojtur në çdo kohë interesat e institucionit që përfaqëson” dhe neni (61) “Juristi në sektorin juridik”, germa (f) “Juristi i sektorit juridik, verifikon besueshmërinë ligjore të aktmarrëveshjeve, të bashkëpunimit ku bashkia është palë”

Në kontratat e lidhura model òtipö me të gjithë OE rezulton se, neni (4) òVlera e qerasë vjetoreö është parashikuar dhe përlllogaritur si vlerë në referim VKM nr.391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotaveö i ndryshuar me VKM nr.1064, datë

22.12.2010 òPër ndryshimin e VKM nr.391, datë 21.06.2006ò dhe VKB nr.49, datë 06.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore (paketa fiskale 2020)” konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Dibër nr.1767/1, datë 13.12.2019.

Në kushtet kur niveli i tarifës për përdorim fondi pyjor/kullosor i miratuar me VKB nr.49, datë 06.12.2019 ka parashikuar si referim ligjor tarifën me VKM nr.391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotaveò, pika (2), lidhja (2/6) òPër nxjerrje prodhim dhe depozitim materialesh inerte direkt nga sipërfaqjaò, ndërsa në fakt rezulton se, tarifa nuk është përllogaritur në këtë referim ligjor, pra mos përllogaritja dhe mos realizimit të të ardhurave nga dhënia në përdorim me qira e sipërfaqes fond pyjor/kullosor në territori bashkisë Bulqizë, është mospërputhje me pika (2); lidhja nr.(2), pika (9/4) të VKM nr.391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektori pyjeve dhe kullotaveò, citohet se;

Pika 2: Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që bashkëlidhet këtij vendimi e është pjesë përbërëse e tij.”

LIDHJA nr.2: “Tarifat dysheme për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika (6): Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)

Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lek/ha/vit.**

1 vit, 2-5 vjet, 6-10 vjet.

1 Inproduktive 540 000/495 000/440 000

Pika (9): Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektiv të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe.

Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lek/ha/vit.**

1-5vjet 6-10 vjet

1 Pyll trungishte 120 000 / 96 000

2 Pyll cungishte 96 000 / 78 000

3 Pyll shkurre 96 000 / 78 000

4 Kullota 96 000 / **78 000**

Bashkia Bulqizë duhet të marr masa të menjëhershme për të evidentuar sipërfaqen në përdorim të OE dhe të kërkojë lidhjen e menjëhershme të kontratave të qirasë me të gjithë operatorët ekonomik të cilët kryejnë aktivitetet minerar në territorin e bashkisë me të cilët deri në datën e akt konstatimit, nuk kanë lidhur kontrata qiraje me pasojë mos realizim i të ardhurave vendore.

Konkluzion: Si pasojë e mos lidhjes së kontratave, apo edhe kur është lidhur kontrata e qirasë me OE që ushtrojnë aktivitetet tregtar për qëllime biznesi të pajisur me leje minerare e miratuar, të cilët shfrytëzojnë sipërfaqen nga fondi pyjor/kullosor në total prej **10278 ha**, si dhe me nivelin më të ulët të tarifës sipas kohëzgjatjes së kontratës në **lekë/ha/vit** periudha (6-10 vjet) me nivel minimal për 78,000 lekë/ha/vit **për gjithë sipërfaqen në përdorim në vlerën totale prej 801,684,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Bulqizë.**(10,278ha x 78,000 lek/ha/vit – 0 lekë vlerë e arkëtuar).

Nr	Përshkrimi	Nr OE	Sipërfaqja	Niveli tarifës	Vlera të ardhura të munguara	Të ardhura të realizuara	Diferenca të ardhura të munguara
1	Sipas regjisrit të AKBN	128	10,851	78,000	846,378,000	0	846,378,000
2	Të kontraktuara	11	573	78,000	40,903,980	187,729	40,716,251
3	Aktivitet në galeri	5	0	0	0	0	0
4	Të pa kontraktuara	111	10,278	78,000	801,684,000	0	801,684,000
	Totali për sipërfaqen						842,400,251

Për veprimet e mos veprimet e konstatuara për mangësi në mos lidhje kontratë qiraje me të gjithë operatorët ekonomik të cilë kanë në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor të trajtuara më hollësishtë ngarkohen me përgjegjësi;

1-RD, me detyrë, drejtor Drejtori e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave

2-AM, punonjës administrimit, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

<p>3-BCi, punonjës administrimi, qeverisjes, mbrojtjes fondi pyjor/kullos.</p> <p>4-AH, punonjës administrimi, qeverisje, mbrojtjes fondi pyjor/kullos.</p> <p>5-RS, punonjës administrimi, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos.</p> <p>6-AM, punonjës administrimit, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos.</p> <p>7-BI, punonjës administrimi, qeverisjes, mbrojtjes fondi pyjor/kullos.</p> <p>8-BB, punonjës administrimit, qeverisje, mbrojtje fondi pyjor/kullos.</p> <p>9-RD, punonjës administrimit, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos</p>	
Kriteri:	-pika (2); lidhja nr.2, pika (6/1); pika (9/4), të VKM nr.391, datë 21.06.2006 <i>öPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave</i> i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 <i>öPër disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektori pyjeve dhe kullotave</i> .
Impakti:	Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor .
Shkaku:	Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në Bashkia Bulqizë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<p>a) Titullari Bashkisë Bulqizë, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar likuidimin nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve të pajisur me leje minerare brenda territorit të bashkisë Bulqizë, për detyrimin e qirasë në kontratat e lidhura për sipërfaqen në përdorim nga fondi pyjor/kullosor prej 573 ha me pasojë të ardhura të munguar të pa programuara për buxhetin e bashkisë Bulqizë në vlerën 40,716,251 lekë. (40903980-187,729).</p> <p>b) Njëkohësisht Titullari Bashkisë Bulqizë, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të verifikuar në terren dhe për të administruar të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor e cila sipas të dhënave në regjistrin e AKBN^{së} është në përdorim nga 123 OE sipërfaqja totale prej 10,278ha si dhe mos lidhja e kontratave të qirasë për këtë sipërfaqe në përdorim për aktivitetet tregtar në fushën minerare, me pasojë të ardhura të munguar të pa programuara për buxhetin e bashkisë Bulqizë në vlerën 801,684,000 lekë. (10851ha -573ha).</p>

Bashkia Bulqizë me shkresë nr.6260, datë 24.12.2021 e protokolluar në KLSH me nr.1113/4, datë 24.12.2021, ka kthyer shkresën se është njohur me projektraportin e auditimit, ndërsa bashkëlidhur të cilit nga z.RD me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Pyjeve e Kullotave me shkresë nr.6222, datë 22.12.2021 ka dërguar shpjegime e komente për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit, në lidhje me vlerësimin e realizimin e nivelit të tarifës për kontratat e qerasë nga dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor me operatorët ekonomik të paisur me leje minerare në teritorine bashkisë Bulqizë për periudhën raportuese viti 2020, ku është shprehur me objeksione si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me sa është përshkruar në projektraport në lidhje me vlerësimin e realizimin e nivelit të tarifës për kontratat e qerasë nga dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor të periudhës objekt auditimi nga subjekti shpjegohet se;

-Drejtorisë së Monitorimit të Pyjeve e Kullotave pasi titullari bashkisë të nxjerr urdhrin me grup pune menjëherë ne do të bëjmë verifikimin dhe saktësimin e sipërfaqes, pasi ka shumë subjekte që në regjistrin e AKBN, sepse ka shumë subjekte që kanë sipërfaqe të konsiderueshme ndonëse përdorin shumë pak. Duke qënë se kjo nuk është realizuar asnjëherë nga 30 vjetë duhet kohe e gjatë nga numri i madh i subjekteve si dhe nga terreni malor apo nga mos gadishmëria e operatorëve ekonomik për të paraqitur dokumentacionin e tyre në kohë.

-Për sa i përket kontratave të lidhurave operatorët ekonomik për lejet minerare të cilat nuk ndiqen nga sektori juridik, unë pas emërimit si drejtor ato kështu i kam gjetur, të cilat me urdher të titullari do të veprojmë menjëherë, ndërsa për sa i përket mosrealizimit të të ardhurave vendore nga dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor mund të them se brenda 3/mujorit të parë të vitit 2022 do të realizohen të gjitha detyrimet e kontraktuara.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

-Me shpjegimet e bëra sqarojmë se, subjekti nuk ka asnjë pretendim apo kundërshtim për sa është

trajtuar, ndërsa evidenton faktin se “....kjo situatë ka një periudhë të gjatë që është në këtë situatë, njëkohësisht edhe masat që do të merren për tu realizuar duan një kohë po të gjatë , sepse pasi u emërua drejtor kështu e kam gjetur, apo brenda 3/mujorit të para të 2022 do të bëhet e mundur realizimi i të ardhurave....”, për sa shpjegohet dhe argumentohet nga subjekti i audituar ne audituesit shtetëror të KLSH^{se} **jemi plotësisht dakort** sepse; nëpërmjet shpjegimeve dhe jo kundërshtimeve, subjekti në radhë të parë miraton plotësisht për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit, njëkohësisht shpjegimet janë justifikime të pa argumentuara ligjërish, për pasojë në përfundim të gjitha gjetjet dhe rekomandimet do trajtohen përsëri në Raportin përfundimtar të auditimit të pasqyruara me rekomandime përkatëse.

Titulli gjetjes:	-Mangësitë në vlerësimin e mbledhjes së të ardhurave vendore, në përputhje me dispozitat ligjore nga dhënien në përdorim e asetit publik në pronësi të Bashkisë Bulqizë me kontratë qiraje nga fondi pyjor/kullosor ndërtimin të HEC ^{ve} në teritorin e bashkisë.
-------------------------	---

Situata:

-Nënpika (1.6/4)-Të ardhurat e krijuara nëpërmjet dhënies në përdorim nga fondi pyjor/kullosor, apo inproduktive me kontratë qiraje për ndërtim të HEC^{ve} asete në pronësi të Bashkisë Bulqizë.

-Për vlerësimin e nivelit të realizimit të të ardhurave dhe përdorimit të tyre në përputhje me dispozitat ligjore e borxhit tatimor nga dhënia në përdorim e sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor, aset publik në pronësi të bashkisë Bulqizë me kontratë qiraje të lidhura me operatorët ekonomik për ndërtim të HEC^{ve} në teritorin e Bashkisë Bulqizë u mor në shqyrtim dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Monitorimit Pyjeve e Kullotave, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Financës sa më poshtë:

1-Kontratat e qirasë të lidhura nga bashkia Bulqizë me operatorët ekonomik subjekte juridik privat për ndërtim të Hec^v në teritorin e bashkisë Bulqizë.

2-Regjistri realizimit të të ardhurave të realizuara nga niveli tarifës për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, nga kontratat e qirasë të lidhura me operatorët ekonomik.

3-Rakordimet me dega thesarit Bulqizë për të ardhurat e realizuara nga bashkia në periudhën raportuese ushtrimore viti (2020).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

Për periudhën raportuese ushtrimore deri në datën 31.12.2020, nga bashkia Bulqizë janërealizuar të ardhura nga dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor, aset publik në pronësi të bashkisë, nëpërmjet kontratave të qirasë të lidhura me operatorët ekonomik subjekte juridik privat për ndërtim HEC^{ve}. Kontratat janë administruar nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, ndërsa realizimi i të ardhurave nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ku niveli i të ardhurave me vlerën e qirasë është përcaktuar qartësisht në raportin teknik të vlerësimit si pjesë integrale dhe përbërëse e kontratës me arkëtim të detyrimit e cili duhet të bëhet për cdo vit kalendarik me hollësi për secilën kontratë evidentohen në (**Aneksi nr.27, pika 1/6**), bashkëlidhur;

Nga procesi auditimit mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion në lidhje me procedurën e realizimit të ta ardhurave nga zbatimi i nivelit të tarifave në kontratat e lidhura mbi të dhënave të analizuar në aneksin përkatës u konstatua se; bashkia Bulqizë nga dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor në pronësi të bashkisë e sipërfaqes totale prej 52.257ha, ka lidhur gjithësej 12 kontrata qiraje me operatorë ekonomik për ndërtim të HEC^{ve}, ku referuar në kushtet e kontratave dhe në vlerëmn e qirasë e përcaktuar në raportin teknik të vlerësimit pjesë përbërëse integrale e kontratës, bashkia Bulqizë për cdo vit kalendarik nga data e lidhjes së kontratës deri në datën 31.12.2020 duhej të kishte realizuar të ardhura gjithësej në vlerën prej **48,318,416 lekë**.

Ndërsa nga auditimi mbi treguesit e realizimit të të ardhurave të administruara nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave e Drejtoria e Financës të rakorduara me degën e thesarit Bulqizë rezulton se, deri në datë31.12.2020 bashkia ka realizuar të ardhura nëpërmjet arkëtimit nga operatorët ekonomik kontraktues gjithësej vlera prej 17,954,083 lekë në masë 37%, ose mosrealizim vlera prej **30,935,494 lekë**.

Nga analiza e treguesve të secilës kontratë rezulton se, nga 12 kontrata të lidhura, kanë realizuar në masën 100% të vlerës së qirësë vetëm 5 kontrata, ndërsa 7 kontrata janë me mosrealizim të theksuar, ku me realizim 100% janë kontratë këto kontrata;

<p>a-Kontrat nr.4681,datë 06.12.2017 OE“KO”shpk vlerë 2,178,980 lekë, b-Kontrat nr.650, datë 10.02.2017 OE“KE”shpk vlerë 1,271,980 lekë, c-Kontrat nr.4033, datë 30.09.2016 OE“GE”shpk vlerë 3,298,750 lekë, d-Kontrat nr.824, datë 20.03.2018 me OE “D”shpk vlerë 6,997,050 lekë, e-Kontrat nr.303,datë 31.01.2018OE“KE&Sh”shpk vlerë 1,729,140 lekë, Në këto kushte si pasojë e mos arkëtimit të plotë nga operatorët ekonomik të detyrimit për cdo vit kalendarit të nivelit të tarifës së qirasë për secilën kontratë për periudhën deri në datën 31.12.2020 rezulton diferencë e pa arkëtuar shuma prej 30,935,494 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë, si pasojë e mos përllogaritjes, mosaplikimit të saktë dhe mos arkëtimit të nivelit të tarifës e parashikuar në raportin teknik të vlerësimit si pjesë integrale dhe përbërëse e kontratës. Në përfundim Bashkia Bulqizë të marrë të gjitha masat (<i>administrative dhe gjyqësore</i>) me qëllim arkëtimin e plotë të detyrimit të pa likujduar (<i>debitor</i>) në mos përputhje me nivelin e tarifave e përcaktuara nga lidhja (2), neni (11;12), VKM nr.391, datë 02.06.2006 <i>“Për përcaktimin e tarifës në sektorin e pyjeve dhe kullotave”</i> i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010, si edhe në kushtet e kontratave të lidhura ndërmjet palëve. Për veprimet e mos veprimet e konstatuara në këtë kontratë, në lidhje me mangësinë në përllogaritjen e nivelit të tarifës për dhënie me qira të sipërfaqes nga fondit pyjor/kullosor, e trajtuar më hollësisht ngarkohen me përgjegjësi; 1-LA me detyrë, Kryetar i Bashkisë. 2-RH me detyrë, Drejtor i Taksave e Tarifa Vendore. 3-RD me detyrë, Drejtor Drejtoria Monitorimit të Pyjeve e Kullotave</p>	
Kriteri:	-VKM nr. 391, datë 21.06.2006 <i>“Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”</i> i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 <i>“Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006”</i> <i>“Për përcaktimin e tarifave në sektori e pyjeve dhe kullotave”</i> , pika (2), lidhja (2), nenet (11;12).
Impakti:	Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor.
Shkaku:	-Mos respektimi kuadrit ligjorë nga Sektori Taksave e Tarifave Vendore në lidhje me mos aplikimin e saktë të nivelit të tarifës dysheme në dhënie në përdorim me kontratë qiraje të asetit nga fondi pyjor/kullosor pronë publike për ushtrimin e veprimtarive ndërtim HEC në teritorin e Bashkisë Bulqizë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	-Titullari Bashkisë Bulqizë, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysheme për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor me kontratë të lidhur për ndërtimin e HCE ^{ve} në teritorin e bashkisë Bulqizë, për të cilin ka rezultuar diferencë në vlerësim për vlerën 30,935,494 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë.
Titulli gjetjes:	-Mangësit e konstatuara në vlerësimin, përllogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore, për mospagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (<i>paleje</i>) të kryera nga subjektet ekonomike e familjare në teritorin e bashkisë Bulqizë.
Situata;	<u>Nënpika (1.6/6)-Të ardhurat e pallogaritura nga mospagesa e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime informale (pa leje) të kryera nga subjekte ekonomik e familjare në teritori bashkisë Bulqizë.</u> -Për auditimin e planifikimit dhe të realizimit në burimet e krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe përdorimi tyre. <i>Niveli realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor</i> , për periudhën ushtrimore raportuese objekt auditimi viti (2020), për këtë qëllim është marrë në shqyrtim dokumentacioni administruar nga Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Financës e Buxhetit dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për sa më poshtë:

1-Regjistri i realizimit të të ardhurave nga pagesa e “Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për ndërtimet informale (pa leje) të kryera në territorin e bashkisë Bulqizë”, në periudhat raportuese (2018; 2019; 2020).

2-Paketa fiskale viti 2020 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Bulqizë për vitin 2020” në të cilën KB ka miratuar; Kap.(I) Taksat Vendore; pika 4-“**Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

Nga procesi i auditimit mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si edhe nga Drejtoria e Financës rezultoi se, për periudhën raportuese viti 2020 në territorin e bashkisë Bulqizë janë kryer ndërtime pa leje (in formale) të legalizuara nga Drejtoria ALUIZN^{it}, ndërsa nuk kanë kryer likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë duke rezultuar subjekte debitorë të evidentuara me të dhënat më hollësishtë me (**Aneksi nr.28, pika nr.1/6**), bashkëlidhur;

Nga të dhënat e evidentuara në aneksin përkatës për periudhën raportuese viti 2020 rezultoi se, në territorin e bashkisë kanë kryer ndërtime pa leje (in formale) të legalizuara nga Drejtoria ALUIZN^{it} gjithsej 35 subjekte familjar, nga të cilët 14 subjekte familjar nuk kanë kryer likuidimin e detyrimit për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 302,654 lekë, ndërsa 21 subjekte familjar e kanë kryer likuidimin e detyrimit për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 928,682 lekë, ndërkohë që ndërmjet bashkisë Bulqizë dhe Drejtorisë ALUIZN^{it} ka bashkëpunim me shkresa për listat e subjekteve qytetarë të cilët kanë përfunduar procesin e legalizimit dhe të pajisur me leje legalizimi. Në këto kushte vlera prej **302,654 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa kontabilizuar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë**, veprim në mospërputhje me nenin 23 të ligji nr.9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” i ndryshuar me ligjin nr.9786, datë 19.07.2007; ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008; ligjin nr.10099, datë 19.3.2009; ligjin nr.10169, datë 22.10.2009; ligjin nr.10219, datë 04.02.2010; ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013; ligjin nr.50/2014 dhe ligjin nr.62/2015; Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 02.02.2009; me pika 2, neni 27, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar; ligji nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore*” i ndryshuar; ligji nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe VKM nr.860, datë 10.12.2014 *“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje e vlerave të zbatueshme për legalizim*” i ndryshuar.

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në lidhje me mos arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale, të trajtuara me analizë të hollësish ngarkohen me përgjegjësi:

1-EIS me detyrë Drejtor i Planifikimit e Zhvillimit të Territorit.

2-RHme detyrë Drejtor i Taksave e Tarifa Vendore.

3-BH me detyrë, Inspektor regjistrimit e vlerësimit të subjekteve.

4-EB me detyrë, Inspektore e regjistrimit e vlerësimit të subjekteve.

5-FP me detyrë, Inspektor Terreni për taksa e tarifa.

6-OL me detyrë, Inspektor Terreni taksa e tarifa.

7-EH me detyrë, Inspektor Terreni taksa e tarifa, deri 10.03.2020.

Kriteri:	-me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 <i>“Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore</i> ” me ndryshime; ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 <i>“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë</i> ” me ndryshime; pika 2, neni 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 <i>“Për Sistemin e Taksave Vendore</i> ” i ndryshuar; neni 23, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 <i>“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje</i> ” i ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007; ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008; vendimi Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 02.02.2009; ligjin nr.10099, datë 19.3.2009; ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009; ligjin nr.10219, datë 04.02.2010; ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013; ligjin nr.50/2014; ligjin nr.62/2015; e VKM nr. 860, datë 10.12.2014 <i>“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje e vlerave të zbatueshme për legalizim</i> ” i ndryshuar.
Impakti:	-Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit, si pasojë e mospagesës së nivelit të

	taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (<i>pa leje</i>) të kryera nga subjektet ekonomike dhe familjare në teritorin e bashkisë Bulqizë.
Shkaku:	-Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore në Bashkia Bulqizë, për të përpllogaritur dhe mos kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (<i>pa leje</i>) të kryera nga subjekte ekonomike e familjare në teritorin e bashkisë Bulqizë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	-Titullari Bashkisë Bulqizë, Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Taksave e Tarifa Vendore, të analizojë situatën dhe të marrin masa të menjehershme për të analizuar dhe kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (<i>pa leje</i>) të kryera nga subjekte ekonomik dhe subjekte familjare në territori bashkisë Bulqizë e parashikuar në paketa fiskale me pasojë shuma prej 302,654 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti Bashkisë Bulqizë.

Bashkia Bulqizë me shkresë nr.6260, datë 24.12.2021 e protokolluar në KLSH me nr.1113/4, datë 24.12.2021, ka kthyer shkresën se është njohur me projektraportin e auditimit, ndërsa bashkëlidhur të cilit nga z.RHme detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave e Tarifave, z.BH me detyrë Inspektor regjistrimit e vlerësimit të subjekteve, znj.EB me detyrë Inspektore e regjistrimit e vlerësimit të subjekteve dhe z.FP me detyrë Inspektor Terreni për taksa e tarifa, të cilët me shkresë nr.6226/1, datë 22.12.2021 kanë dërguar shpjegime e komente për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit, ndërsa në cilësinë e provës shkresore justifikuese janë bashkëlidhur edhe 2 kopje autorizime bazë për (licensë/autorizim) të lëshuar nga ish/Komuna Shupenzë; një faturë arkëtimi nga operatori "C" shpk për taksën e pastrim, gjelbërim, ndricim, si edhe një evidencë aktrakordim me dega e thesarit Bulqizë për të ardhurat deri në datë 31.08.2020 kjo e pa nënshkruar dhe vulosur, në lidhje me programimin, vlerësimin dhe realizimin e nivelit të tarifave e tarifave vendore të bashkisë Bulqizë të pasqyruara e miratuara me paketën fiskale periudha raportuese viti 2020, ku janë shprehur me objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me sa është përshkruar në projektraport në lidhje programimin, vlerësimin dhe realizimin e nivelit të tarifave e tarifave vendore të periudhës objekt auditimi nga subjekti shpjegohet se;

-në lidhje me borxhin tatimor, megjithë punën e bërë me masa shtërnguese për gjendjen e debitorëve të viteve të kaluara e mendojmë se për gjatë vitit pasardhës 2022 do të merren masa të menjëheshme.

-në lidhje me paisjen me (licensë/autorizim) për tregtim në pika findore në stacione karburanti do të merren masa të menjëheshme për tu paisur, apo rinovuar të gjithë operatorët me dokumentacionin e nevojshëm 5 vjecar për gjatë vitit 2022.

-në lidhje me përlllogaritjen e nivelit të tarifës për nipet sekondar, ne si drejtori nuk kemi dijeni, nga sektori juridiki cili ka lidhur kontrata, ndërsa vetëm një operator ekonomik ka aplikuar në QKB.

-në lidhje me subjektet që kanë HECe ne kemi ndjekur kontratat, për ata që kanë përfunduar ndërtimin, ndërsa për ato që rezultojnë debitor ne si drejtori nuk kemi kontrata. Gjithësesi për gjatë viti 2022 në bashkëpunim me drejtorinë e pyjeve dhe kullotave dhe sektorin juridik do të marrim masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës së munguar.

-në lidhje me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë gjatë kësaj periudhe kemi marr disa masa për arkëtim dhe deri tani u arkëtuan nga 5 subjekte shuma prej 64,773 lekë

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

*-Me shpjegimet e bëra sqarojmë se, subjekti nuk ka asnjë pretendim apo kundërshtim për sa është trajtuar, ndërsa evidenton faktin se; "...për gjatë periudhës në vazhdim të vitit 2022 do të merren të gjitha masat për tu bërë e mundur realizimi i të ardhurave vendore nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave të trajtuara në projektraport....", për të cilën me sa shpjegohet dhe argumentohet nga subjekti i audituar ne audituesit shtetëror të KLSH^{se} **jemi plotësisht dakort** sepse; nëpërmjet shpjegimeve dhe jo kundërshtimeve, të mbështëtura edhe me prova shkresore subjekti në radhë të parë miraton plotësishtë për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit, njëkohësishtë shpjegimet janë justifikime të pa argumentuara ligjërishtë, për pasojë në përfundim të gjitha gjetjet dhe rekomandimet do trajtohen përsëri në Raportin përfundimtar të auditimit të pasqyruara me rekomandime përkatëse.*

Pika 2.Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimi MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

-Nënpika (2.1). Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

-Nënpika (2.2).Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;

-Nënpika (2.3). Opinioni mbi pasqyrat financiare;

Titulli i Gjetjes:	-Mangësitë dhe pasaktësitë në plotësinë e saktësinë në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike për vlerësimin e raportimit financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi
---------------------------	---

Situata:

-Nënpika (2.1)-Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

-Në procesin e auditimit për vlerësimin e raportimin financiar në periudha ushtrimore raportuese viti 2020 u mor në shqyrtim dokumentacioni më poshtë:

1-Pasqyrat Financiare periudhës ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2020).

2-Ditarët e kontabilitetit për periudhës raportuese ushtrimore viti (2020).

3-Aktrakordime debitorë ndërmjet financës dhe Taksave e tarifave vendore.

4-Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore viti (2020).

5-Dokumentet e bankës e arkë për periudhën raportuese ushtrimore viti (2020).

6-Aktrakordimet e kryera me degën e thesarit Bulqizë për periudhën viti (2020).

7-Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën viti (2020).

8-Pyetsorët me përgjigje për pasqyrat financiare, periudha raportuese (2020)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Në procesin e auditimit mbi plotësinë e saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura për gjatë periudhës raportuese ushtrimore (01.01.2020 deri 31.12.2020) u konstatua se: Njësia publike bashkia Bulqizë me shkresë nr.864 prot, datë 22.02.2021 ka depozituar pasqyrat e pozicionit financiar (Formati nr.1) në degën së Thesarit Bulqizë e konfirmuar me nr.46 prot, datë 20.02.2021, duke respektuar afatin ligjor i përcaktuar deri në datë 31 mars të vitit pasardhës, në përputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshmeö*, pika (118), ku citohet se;

Pika 118. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit.

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2020 janë plotësuar me formatet dhe anekset në përbërje të tyre konkretisht sa më poshtë vijon:

-Formati 1-Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);

-Formati2-Pasqyra e performancës financiare, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;

-Formati 3-Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow), sipas metodës direkte;

-Formati 4-Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;

-Formati 5-Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;

-Formati 6-Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;

-Formati7-Pasqyrat anekse statistikore, Gjendja e ndryshimet e aktiveve afatgjata, nga të cilat;

-Formati 7/a-Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me kosto historike.

-Formati 7/b-Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlera neto.

-Formati8-Pasqyra anekse statistikore e numrit të punonjësve e fondi i pagave.

Për njësinë publike Bashkia Bulqizë, gjendja e llogarive të evidentuara në pasqyra financiare (*bilanci*) në fund të periudhës raportuese ushtrimore gjendje në datën 31.12.2020 (*Formati nr.1*) sipas pozicionit financiar paraqiten me të dhënat në (***Aneksi nr.5, pika 2/I***), bashkëlidhur Nga procesi i auditimit mbi referencat e gjendjes së llogarive në aktiv dhe në pasiv, verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pozicionit financiar dhe saktësinë e besueshmërinë e tyre, me analizë të hollësishme për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 gjendja për secilën llogari paraqiten si në vijim;

A.Aktivet.

I.Rubrika, aktivet afat shkurtra.

1.Nën/rubrika, “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”;

-Gjendja Llog.(520) “Disponibilitete në thesar” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 104,977,141 lekë dhe në datë 31.12.2020 në vlerën 106,755,142 lekë me diferencë shtesë vlera 1,778,001 lekë e cila përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm grande të pa përdurura nga shkrirja e ish/Nd. Shërbimit Publik, llogari e cila rakordon me aktrakordimin e datës 13.01.2021 i mbajtur me Degën e Thesarit Bulqizë për fonde në fund periudhës ushtrimore të pasqyruara më poshtë:

<i>Llogaria</i>	<i>Vlera</i>	<i>31.12.2019</i>	<i>31.12.2020</i>
Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”	=	104,977,141	106,755,142
Diferenca me shtesë ka ardhur si rezultat ng;	1,778,001	=	=
Grande dhe të ardhura të pa përdorura llog.(419) (duhet)	1,778,001	=	=

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare.

2.Nën/rubrika “Inventarit qarkullues”;

-Gjendja Llog.(31) “Materiale” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 5,372,348 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 me vlerë 11,614,210 lekë me diferencë më tepër shuma prej 6,241,862 lekë e cila përfaqëson shtesë nga blerjet e realizuara për gjatë vitit 2020 e barabart me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen e inventarëve fizik dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material nga përgjegjësi sektorit dhe drejtori financës.

-Gjendja Llog.(32) “Inventar i imët” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 23,626,507 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerën 24,628,289 lekë me diferencë më tepër shuma prej 1,001,782 lekë e cila përfaqëson shtesë nga blerjet e realizuara për gjatë vitit 2020 e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen e inventarëve fizik dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin e përgjegjësin material, nga përgjegjësi sektorit dhe drejtori financës.

-Gjendja Llog.(35) “Mallra” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore raportuese paraqitet me vlerë 0 (Zero) për gjatë gjithë aktivitetit të Bashkisë Bulqizë.

3.Nën/rubrika, ÷Llogari të arkëtueshme;

-Gjendja Llog.(423;429) “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore raportuese paraqitet më datën 31.12.2019 në vlerë 0 (Zero) e pa ndryshuar në datë 31.12.2020 e paraqitur me vlerë 0 (Zero) për gjatë gjithë aktivitetit të Bashkisë Bulqizë.

-Gjendja Llog.(468) “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore raportuese më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerën 114,421,966 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerën 122,745,108 lekë me diferencë më tepër detyrime debitorë ndaj bashkisë në shumën prej 8,323,142 lekë e cila përfaqëson detyrimet shtesë të pa likuiduar nga subjektet ekonomik dhe familjare për mos pagesë të nivelit të taksave e tarifa vendore deri në datën 31.12.2020, etj. Detyrimet debitorë ndaj Bashkisë Bulqizë gjendje në datën 31.12.2020 në mënyrë analitike, sipas periudhës dhe dinamikës së krijimit paraqiten sa më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Periudha Krijimit</i>	<i>Gjendja 31.12.2019</i>	<i>Shtesa në vitin 2020</i>	<i>Paksime në vitin 2020</i>	<i>Gjendja në 31.12.2020</i>
1	Debitorë nga KLSH	2012-2020	44,827,598	0	515,036	44,312,562
2	Debitorë nga APP (masa administrative)	2018-2020	2,450,000	0	0	2,450,000
3	Debitorë nga kopshte e çerdhe (taksa e tarifa)	2015-2020	277,036	99,121	32,827	343,330
4	Debitor nga Ente shtetërore (taksa e tarifa)	2017-2020	783,950	258,656	0	1,042,606

5	Debitorë subjekte të kromit 31.12.2020	2015 2020	39,256,321	8,542,569	2,440,100	45,358,790
6	Debitorë subjekte të bizneseve 31.12.2020	2015 2020	19,265,424	4,065,263	488,540	22,842,147
7	Debitorë të ndryshme (ish komuna) 31.12.2020	2015 2020	6,858,606	0	1,165,964	5,692,642
8	Debitorë për taksa tarifa (Kompani AMC)	2011-2020	703,031	0	0	703,031
	Totali		114,421,966	12,965,609	4,642,467	122,745,108

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare.

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën më sipër konstatohet se, gjendja e llog.(468) *Debitorë të ndryshëm* më hollësisht, analitike dhe numër persona përbëhet sa më poshtë;

Nr	Përshkrimi detyrimit të krijuar	Detyrimet debitore	
		në vlerë	në numër persona
1	Nga rekomandimet e KLSH në auditimet e realizuara e përbërë;	44,312,562	608 subjekte
2	Nga penalitete të vendosur nga APP për prokurimet publike	2,450,000	24 subjekte
3	Debitorë nga kopshte e çerdhe (taksa e tarifa)	343,330	504 subjekte
4	Debitor nga Ente shtetore (taksa e tarifa)	1,042,606	14 subjekte
5	Debitorë subjekte të kromit (taksa e tarifa)	45,358,790	203 subjekte
6	Debitorë subjekte të bizneseve (taksa e tarifa)	22,842,147	1,502 subjekte
7	Debitorë të ndryshme (ish komuna)	5,692,642	535 subjekte
8	Debitorë për taksa tarifa (Kompani AMC)	703,031	1 subjekt
	Totali i detyrimeve debitore në datë 31.12.2020	122,745,108	3,391 subjekte
	Nga Drejtoria e taksave e tarifave vendore (evidence e raportuar)	12.866.486	337 persona

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Drejtoria e Finacës dhe Pasqyrat financiare.

Vlera e detyrimeve debitore gjendje në datë 31.12.2020 e raportuar në pasqyrat e pozicionit financiar, ku me vlerë më të madhe janë subjektet e kromit, rekomandimet e KLSH dhe subjektet e biznesit debitorë të krijuar nga mos pagesa e nivelit të taksave e tarifave vendore si më poshtë;

-Debitorë subjekte të kromit (taksa e tarifa) është vlera	45,358,790 lekë
-Debitorë rekomanduar nga KLSH është vlera	44,312,562 lekë.
-Debitorë subjekte të biznesit është vlera	22,842,147 lekë.
-Debitorë ente shtetore për (ish komunat) është vlera	5,692,642 lekë.
-Debitor penalitete të vendosur nga APP është vlera	2,450,000 lekë.
-Debitorë ente shtetore për taksa e tarifave është vlera	1,042,606 lekë.
-Debitorë për taksa tarifa (Kompani AMC) është vlera	703,031 lekë.
-Debitorë nga kopshte e çerdhe (taksa e tarifa) është vlera	343,330 lekë.
Totali detyrimeve debitore	122,745,108 lekë

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

a) bazuar mbi të dhëna e gjendjes debitorë që Drejtoria e Taksa e Tarifa ka raportuar me evidencë për vitin 2020, se shtesa debitore është me vlerë 12,866,486 lekë, ndërsa gjendja debitore e raportuar në pasqyrat financiare (bilanci) shtesa është me vlerën 8,323,142 lekë, pra ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat e pozicionit financiar dhe gjendjes debitorë e pasqyruar me evidencë nga drejtoria e taksave tarifave vendore rezulton diferencë e pa argumentuar në vlerën prej **4,545,344 lekë** (12866486-8323142), për pasojë kjo llogari nuk pasqyrohet e administron të gjitha detyrimet debitore të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore për subjektet privat dhe subjekte familjar, në këto kushte pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, nuk pasqyrojnë vërtetësi në gjendjen e detyrimeve debitorë me analizë të subjekteve për mospagim të nivelit taksave e tarifave vendore të njësisë publike bashkia Bulqizë, në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3, ku citohet se;

Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 3.3; Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4), klasa 4 përfaqëson në përgjithësi ngjarjet apo fenomenet që kanë ndodhur dhe duhet të trajtohen kontabilisht, sipas parimit të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Në përgjithësi, detyrimet vlerësohen e regjistrohen në kontabilitet dhe pasqyrohen në pasqyrat financiare të vlerësuar me vlerën e tyre të plotë të maturimit.

-Gjendja llog.(4342) **“Operacione me shtetin (të drejtat)”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerën 34,925,246 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 me vlerë 36,800,395 lekë me diferencë më tepër vlera prej **1,875,149 lekë**,

vlerë e njëjtë me ndryshimet në shtesa e paksime (10034141-8158992). Me analizë të hollësishme gjendja e llogarisë për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 paraqitet nga:

1-detyrime pasqyruar llog.(42) “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 14,174,172 lekë.

2-detyrime pasqyruar llog.(435) “Sigurime shoqërore” në vlerën 5,213,677 lekë.

3-detyrime pasqyruar llog.(436) “Sigurime shëndetësore” vlerë 288,108 lekë.

4-detyrime pasqyruar në llog.(431) “Detyrime ndaj shtetit tatime e taksa” në vlerë 726,292 lekë.

5-detyrime pasqyruar në llog.(401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to” vlerë 16,398,146 lekë.

Në total këto 5 llogari të analizuar hollësisht të pasqyruara në pasiv të bilancit për këtë periudhë raportuese ushtrimore janë me vlerë **36,800,395 lekë** e njëjtë me vlerën në llogaria *ökundër partiö* e pasqyruar në aktiv të bilancit Llog.(4342) *öTë tjera operatione me shtetin (të drejtat)*ö po me shumën prej **36,800,395 lekë**.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 me analizë vlera prej **36,800,395 lekë** përbëhet dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2019	Shtesa	Pakësimi	Gjendje 31.12.2020
1	Paga Personeli llogaria (42)	13,292,279	881,893	0	14,174,172
2	Sigurimet Shoqërore llogaria (435)	13,255,330	0	8,041,653	5,213,677
3	Sigurime Shëndetësore llogaria (436)	244,449	43,659	0	288,108
4	Tatim page tatim ne burim llogaria (431)	843,631		117,339	726,292
5	Furnitorë llogaria.(401-408)	7,289,557	9,108,589		16,398,146
	TOTALI	34,925,246	10,034,141	8,158,992	36,800,395

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare.

Në përfundim nga analiza konstatohet se; ndërmjet vlerës pasqyruar në llog.(4342) *öOperatione me shtetin, të drejtaö* dhe vlerës pasqyruar në 5 (*pesë*) llogaritë e pasivit nuk rezulton diferencë, pra është e njëjtë në shumën prej **36,800,395 lekë**.

4.Nën/rubrika “Të tjera aktive afatshkurtra”:

-Gjendja Llog.(486) “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerë 24,888,975 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 28,307,781 lekë me diferencë më tepër **3,418,806 lekë** e cila përfaqëson shtesë për detyrime të prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve nga njësia publike bashkia Bulqizë, ku më analitike paraqiten sa më poshtë:

N r	Emërtimi	Vlera më 31.12.2020
1	Detyrime për mallra.	0
2	Detyrime për shërbime.	492,251
3	Detyrime për vendimet gjyqësore.	0
4	Detyrime për investimet.	27,815,530
5	Detyrime për tatime të tjera.	0
6	Detyrime të prapambetura të tjera.	0
	Totali	28,307,781

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare.

Vlera prej **28,308,781 lekë** e detyrimeve të prapambetura pa likuiduar e cila në pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën ushtrimore raportuese viti 2020, rakordon me vlerën e listës së detyrimeve të prapambetura të pa likuiduara për këtë periudhë e rakorduar me akt midis bashkisë dhe degës së thesarit Bulqizë në datën 13.01.2021.

II. Rubrika, “Aktivet afatgjata”.

1. Nën/rubrika, “Aktive afatgjata jo materiale”:

-Gjendja llog.(202) “Studime dhe kërkime” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 49,476,281 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 15,347,091 lekë me diferencë më pak shuma **34,129,190 lekë** e cila përfaqëson vlerën e amortizimit i llogaritur për viti ushtrimor 2020 me vlerë 14,062,328 lekë e llogaritur në masë (5%), ndërsa diferenca prej 20,066,862 lekë (34129190-14062328) është vlera e 7 objekteve të transferuara nga ish/Komunat për të cilat vlera e studim projektimit është e përfshirë shtesë në vlerën e objekti përkthës.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) për vitin 2020 rezulton se, norma e amortizimit është përlogaritur në vlerën 14,062,328 lekë në masën 5% e pasqyruar në (formati nr.7/b) *ogjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*o.

b) për këtë periudhë raportuese ushtrimore në llogarit respektive është pasqyruar vlera neto pas amortizimit (vlera e mbetur pas amortizimit 15,347,091 lekë, si dhe amortizimi 14,062,328 lekë deri në vitin 2020).

c) vlera prej 29,145,487 lekë me kosto historike i përket 31 projekteve e studimi për investimet që janë kryer në objekte të cilat ka përfunduar zbatimin i punimeve e janë marr në dorëzim nga Bashkia, pra kjo vlerë duhet të ishte e sistemuar në llogarinë përkatëse të investimit që është përfunduar, si pjesë e koston totale të objekteve. Për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë vërtetësin e gjendjes së aktiveve, veprim në mospërputhje me UKM nr.02, datë 08.05.2003 *oPër klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimito* i ndryshuar, gërma ocö, nën gërma obö, të evidentuara në (Aneksi nr.6, pika 2/I) bashkëlidhur, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *oPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjstive të Qeverisjes së Përgjithshmeo*, aneksi (1), Klasa (2), pika (2.1), pika (36), paragrafi (4), citohet se;

Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik",

Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Pika 2.1, "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2".

Pika 36; paragrafi (4)-Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

-Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;

-Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softe e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;

-Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe

-Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet metodë lineare me normë amortizimi 15%.

Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata materiale (mbi të cilat aplikohet përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi) duhet të jetë e barabartë me:

-Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje periudhës ushtrimore;

-Shtesën e koston së blerjes dhe koston së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; si dhe

-Zbritjen e vlerës kontabël neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore.

-UKM nr.02, datë 08.05.2003 *oPër klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimito*, i ndryshuar, gërma (c), nën/gërma (b), ku citohet se;

Gërma "c", Të ndryshme. Në strukturën e investimeve dhe të ndërtimeve themelore, përveç punimeve të ndërtim-montimit përfshihen edhe:

Nën/gërma "b", studime e projekte, duke filluar nga studimi i domosdoshmërisë dhe leverdishmërisë së ndërtimit të veprës, deri në mbikëqyrjen e kolaudimin përfundimtar te saj.

-Gjendja llog.(203) **"Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeo** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerë neto 0 (Zero) lekë, vlerë e pa ndryshuar në datën 31.12.2020 e cila përfaqëson veprimet e amortizimit të akumuluar e publikuar në vlerën e mbetur 0(Zero) në pasqyrat financiare.

2.Nënrubrika, "Aktive Afatgjata Materiale" (AAM);

-Gjendja llog.(210) **"Toka, Troje, Terrene"** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 7,600,116 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 8,036,366 lekë me diferencë më tepër shuma 436,250 lekë e cila përfaqëson shtesën si pasojë e transferimit të aseteve nga Ndërmarrja e Pastrim Gjellbërim në bashki e 8 objekteve me emërtim *osipërfaqe e gjellbërtö* në sasi prej 207.3m2.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;

a) Në këtë llogari nuk është e pasqyruar edhe vlera e trojeve të cilat kanë kaluar si asete në pronësi të Bashkisë Bulqizë me VKM nr.946, datë 02.09.2009 *oPër miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të*

Bashkisë Bulqizë, qarku Dibërë; i ndryshuar me VKM nr.540, datë 27.07.2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.946, datë 02.09.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë, qarku Dibërë; VKM nr.5, datë 04.01.2013 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkia Bulqizë, qarku Dibërë; VKM nr.809, datë 06.10.2010 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Zerqan, qarku Dibërë; VKM nr.480, datë 30.05.2013 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës FushëBulqizë, të qarkut të Dibërë; VKM nr.903, datë 21.12.2011 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Trebisht, qarku Dibërë; VKM nr.160, datë 27.02.2013 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ostren, qarku Dibërë; VKM nr.523, datë 30.06.2010 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Martanesh, qarku Dibërë; VKM nr.483, datë 30.05.2013 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Shupenzë, qarku Dibërë; pasqyrohen jo të plota në kontabilitete për mungesë të vlerës së objektit, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Kap.(II), pika (11), aneksi(1), pika (2), Klasa (2); pika (30), citohet se;

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë.

Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik",

Pika 2. Klasa 2. "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Pika 30: "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemim diferenca të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet".

b) Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore evidentuar në (**Aneksi nr.7, pika 2/I**) bashkëlidhur, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Kap.(IV), pikat (74; 96), ku citohet se;

Kap.IV; Pika 74. "Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."

Pika 96. "Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit."

-Gjendja llog.(211) "**Pyje, kullota, plantacione**" në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 16,201,819 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 16,494,469 lekë me diferencë më tepër shuma 292,650 lekë e cila përfaqëson shtesën si pasojë e transferimit të aseteve nga Nd.Pastrim Gjellbërimit në bashki e 9 objekte me emërtim (*blina dekorativ, pisha park varreza, gështenjë etj*). Në këtë llogari nuk është e pasqyruar me emërtime për objektet e inventarit për pyje, kullota e palantacione të transferuara nga shërbimi pyjor në bashkia Bulqizë.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;

a) Në këtë llogari nuk është e pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Bulqizë me VKM nr.433, datë 08.06.2016 òPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të

Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkiveö, pika 9, shtojca nr.7 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Bulqizë, me nr.1(një) deri 2236 (dymijë e dyqind e tridhjet e gjashtë) dhe VKM nr.684, datë 02.09.2020 *ËPër disa shtesa e ndryshime në VKM nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkiveö, pika 1, gërma (a) me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Bulqizë e ndryshuar shtojca nr.7 nga nr.1(një) deri nr.2262 (dymijë e dyqind e gjashtëdhjet e dy), përfshirë edhe godina e DSHP e pasqyruar në llog.(212). Sipas këtij vendimi dhe vendimit të ndryshuar rezulton se, bashkia Bulqizë ka në pronësi gjithsej **43,125 ha**, nga të cilët 32,752 ha pyje; 4,325 ha kullota, 6,049 ha sipërfaqe inproduktive (shkëmbore), veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kap.(II), Pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2).**

b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi Pyjeve e Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, ndërsa llog.(211) *ËPyje, kullota, plantacioneö nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, veprime në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kap.(II), Pika (11), aneksi (1), Pika (2), Klasa (2), ku citohet se;**

Kapitulli (II), Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika (11). Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin I bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Aneksi (1), "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik",

Pika (2); Klasa (2), "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

-UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, Kap.(IV), pikat (74; 96), ku citohet se;*

Kapitulli (IV);

Pika (74). "Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."

Pika (96). "Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen monitorimi realizimit të procesit."

-Pyje, Kullota, Plantacione me vlerat perkatëse gjendje me 31.12. 2020 .

Nr	Emertimi i projektit	Vlera
1	Pyje, Kullota, Plantacione Sherbimi pyjor	11.051.185
2	Pyje, Kullota, Plantacione Njesia Ad. Fushë.Bulqize	5.150.634
3	Pyje, Kullota, Plantacione Ndermarrja Sherbimit Utilitare	292.650
		16.494.469

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare.

-Gjendja llog.(212) "Ndërtesa e konstruksione" në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 1,034,878,278 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 949,798,585 lekë me diferencë më pakë vlera 85,079,693 lekë e cila përfaqëson shtesë në investime të kryera gjatë vitit në objekte me vlerën 51,173,701 lekë, pakësime të tjera me vlerën 117,406,484 lekë si pasojë e transferimit të asetit objekti me emërtim *ËNdërtes Ujësjetllës Martaneshö* nga ish/Nd.Ujësjetllësi Martanesh pronë e bashkisë në Ndërmarrja Ujësjetllës sha Bulqizë, pakësi për normën e amortizimit vjetor me vlerën 30,294,042 lekë, ndërsa vlera përje 15,059,082 lekë përlllogaritje të gabuar në normën e amortizimit vjetor, për këtë pasojë edhe norma e amortizimit nuk rezulton e përlllogaritur me 5%, me detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës.

Për vitin 2020 është përdorur norma e amortizimit 5%

Nr	Vlera në çelje (Kosto historike)	Shtesa gjatë vitit 2020	Pakësime të tjera	Amortizim vjetor i	Pakësim amortizimi	Vlera neto më 31.12.2020
1	1,236,225,120	51,173,701	117,406,484	30,294,042	11,447,132	949,798,585

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare

Për këtë llogar bazuar në listën e aktiveve afat gjata materiale të paraqitura në mënyrë analitike me gjendje të evidentuara në (**Aneksi nr.8, pika 2/I**) bashkëlidhur.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

a) Në këtë llogari nuk është pasqyruar e saktë vlera për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime për gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimit shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objektit, vlera mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet e mirëmbajtje e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare AAGJM^{së}. Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 980,307,610 lekë për 139 objekte, veprim në mospërputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeō*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).

b) Për periudhën viti 2020 ka zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 15,059,082 lekë e cila vjen për shkak të përlllogaritjes gabim të normës së amortizimit me pasëoj edhe me ndryshim të vlerës së amortizimit detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeō*, pika (36).

c) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ōPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareō*, neni (15), pikat (1; 2); UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikō*, Kap.(IV), pikat (74;96) e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 *ōPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshmeō*, pika (36), paragraf (4), ku citohet se;

Pika (36); Paragrafi (4); Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

-Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;

-Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;

-Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe

-Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodë lineare normë amortizimi 15%.

Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata materiale (mbi të cilat aplikohet përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi) duhet të jetë e barabartë me:

-Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore;

-Shtesën e koston së blerjes dhe koston së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; si dhe

-Zbritjen e vlerës kontabël neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore.

-UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeō*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2) *ōAktivet afat gjataō*, përbërja e trajtimi kontabël, germa (b), ku citohet se;

Kap.(II). Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Aneksi 1. "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik",

Pika 2; Klasa 2. "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

germa (b): Vlerësimi i mëpasshëm lidhet me faktin që aktivet gjatë jetës së përdorimit pësojnë ndryshime dhe për këtë qëllim duhet të rivlerësohen. Përmirësimet, **riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve kanë një kosto të mëpasshme që i shtohet koston fillestare të AAGJM^{së}**. Kryerja e riparimeve teknike kapitale, me ose pa zëvendësim të pjesëve të këtij aktivi, është kusht i funksionimit të një elementi të AAGJM^{së}. Kostoja e riparimit njihet në vlerë kontabël të elementeve të AAGJM-së, nëse plotëson kriteret për njohje.

-Ligji nr.25, datë 10.05.2018 *ōPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareō*, neni (15), citohet se;

Neni (15). Inventari aktiveve dhe detyrimeve;

1-Njësitë ekonomike, subjekti këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

2.Organi drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivitetit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare.

-Gjendja llog.(213) “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 1,962,571,847 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 2,437,349,254 lekë me diferencë në shtesë vlera 474,777,407 lekë e cila përfaqëson investime të kryera për gjatë vitit 2020 në rrugë, rrjete e vepra ujore në 15 objekte me vlerë 330,027,978 lekë, shtesën e transferimit nga ish/Nd.Pastrim Gjelbërimi pa pagesë për 33 objekte me vlerë 76,506,745 lekë, paksime për vlerën e amortizimit gjatë periudhës 221,887,459 lekë, si dhe përllogaritje e gabuar e normës së amortizimit vjetor me vlerë 99,245,173lekë, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës.

Për vitin 2020 është përdorur norma e amortizimit 5%

	<i>Vlera në çelje (Kosto historike)</i>	<i>Shtesa gjatë vitit 2020</i>	<i>Vlera neto para amortizimit</i>	<i>Amortizim vjetor i</i>	<i>Pakësim amortizimi</i>	<i>Vlera neto më 31.12.2020</i>
	2,300,381,480	406,534,723	1,962,571,847	153,644,775	221,887,459	2,437,349,254

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare

Për këtë llogar bazuar në listën e aktiveve afat gjata materiale të paraqitura në mënyrë analitike me gjendje të evidentuara në **(Aneksi nr.9, pika 2/I)** bashkëlidhur.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

a) Në përllogaritjen e amortizimit vjetor të aktive afatgjata për periudhën raportuese ushtrimore 2020 në vlerë 153,644,775 lekë rezulton se, norma mesatare vjetore është përllogaritur me 5%, duke respektuar normën e amortizimit, në përputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeō*, pika (36).

b) Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM^{së}. Investimeve shtesë në total deri në 31.12.2020 janë në vlerë 406,534,723 lekë për 24 raste objekte, veprim në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeō*, Kap.(II), pika (11), Aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).

c) Për periudhën viti 2020 ka zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 99,245,173 lekë e cila vjen për shkak të përllogaritjes gabim të normës së amortizimit me pasëoj edhe me ndryshim të vlerës së amortizimit detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeō*, pika (36).

d) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM^{ve} me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ōPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareō*, neni (15), pikat (1;2); UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikō*, Kap.(IV), pika (74; 96); UMF nr. 08, datë 09.03.2018 *ōPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshmeō*, pika (36), ku citohet se;

Pika 36. Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjisllacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

-Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;

-Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë

grupimi me normën 25%;

- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodë lineare normë amortizimi 15%

Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata materiale (mbi të cilat aplikohet përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi) duhet të jetë e barabartë me:

- Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje periudhës ushtrimore;
- Shtesën e kostos së blerjes dhe kostos së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; si dhe
- Zbritjen e vlerës kontabël neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore.

-UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, ðAktivet afat gjataö, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b), ku citohet se;*

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Aneksi 1. “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”,

Pika 2.Klasa 2. “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

germa ‘b’: Vlerësimi i mëpasshëm lidhet me faktin që aktivet gjatë jetës së përdorimit pësojnë ndryshime dhe për këtë qëllim duhet të rivlerësohen. Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve kanë një kosto të mëpasshme që i shtohet kostos fillestare të AAGJM^{së}. Kryerja e riparimeve teknike kapitale, me ose pa zëvendësim të pjesëve të këtij aktivi, është kusht i funksionimit të një elementi të AAGJM^{së}. Kostoja e riparimit njihet në vlerën kontabël të elementeve të AAGJM^{së}, nëse plotëson kriteret për njohje.

-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 *“Për kontabilitetin e pasqyrat financiareö, neni 15, citohet se;*

Neni 15. Inventari i aktiveve dhe detyrimeve 1. Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. 2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivitetit e detyrimeve në pasqyrat financiare.

-Gjendja llog.(214) **“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 3,187,312 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 10,077,835 lekë me diferencë më tepër për 6,890,523 lekë e cilat përfaqëson shtesë gjatë periudhës për objektet e transferuara në bashki nga Nd.pastrim gjelbërimit me konsolidim të pasqyrave financiare në vlerë 9,286,843 lekë, si dhe paksime të tjera për objektet e transferuara nga njësia publike bashkia Bulqizë në Sha Ujësjellës Bulqizë vlera 2,671,500 lekë me vlerën e amortizimit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 prej 3,780,983 lekë.

Për vitin 2020 është përdorur norma e amortizimit 5%

Nr	Vlera në çelje (Kosto historike)	Shtesa gjatë vitit 2020	Pakësime të tjera	Vlera para amortizimit	Amortizimi akumuluar	Vlera neto më 31.12.2020
1	3,187,312	9,286,843	2,671,500	48,602,818	38,524,983	10,077,835

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;

-Referuar në procesin e inventarizimit fizik të (AAM) dhe pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, rezulton se llog.(214) është paraqitur me vlerë 48,602,818 lekë me kosto historike në të cilën është e përfshirë edhe vlera prej **18,200,596 lekë** për disa artikuj *“pajisje kompjuterikeö* të cilët duhet të administrohen në llog.(218/k) *“Inventar ekonomik”*, si dhe vlera prej **1,422,368 lekë** për disa artikuj *“bateri kompjuteri e televizor”* të cila duhet të administrohen në llog.(327) *“Inventar i imët”*, të pasqyruara të tilla dhe në procesin e inventarizimit fizik të (AAM), me pasojë kontabilizim gabim në administrim llog.(214)*“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla puneö* për të cilat është përlllogaritur gabim edhe amortizim vjetor në masë 5% me vlerë 910,030 lekë. Për këtë llogari amortizimi duhet përlllogaritur në masën 25% për vlerën **3,640,119 lekë** vlerë e cila

duhet të shtohet në llog.(218) *ōInventar ekonomik*”, për të njëjtën vlerë me analizë cdo artikull të evidentuara në (**Aneksi nr.10, pika 2/1**), veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshmeō*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), klasa (2).

-Gjendja llog.(215) “Mjete transporti” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 36,939,523 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 43,266,038 lekë me diferencë shtesë për 6,326,515 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe paksimet nga amortizimi për periudhën raportuese.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

-Në llog.(215) *ōMjete transportiō* të pasqyrave të pozicionit financiar viti 2020 e paraqitur në vlerën 82,402,135 lekë me kosto historike, në të cilën është pasqyruar edhe vlera për 11 (*njëmbëdhjetë*) mjete transporti në gjendje teknike jahtë përdorimit të dëmtuara të pasqyrurara me vlerë historike **11,955,191 lekë**, të cilat është kryer kontabilizim i gabuar në llog.(215)*ōMjete Transportiō* dhe përlllogaritur amortizimi vjetor në vlerën 10,373,968 lekë në masë 5%, ndërsa amortizimi i akumuluar është në vlerë 39,136,097 lekë. Për këto 11 (*njëmbëdhjetë*) mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, ndërsa janë të dëmtuara vlera e tyre duhej të ishte e regjistruar dhe kontabilizuar në llog.(24) *ōAktive afatgjata të dëmtuaraō* me analizë cdo mjet sipas tabelës sa më poshtë, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshmeō*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2/1), germa (e); pika 36, citohet se;

Germa “e”. Për daljet nga kalimi në aktive afatgjata të dëmtuara, funksionimi i vlerës historike dhe amortizimit është: -Kreditohet llogaria 215 (analizat shtatëshifrore përkatëse);

-Debitohet llogaria 24, "Aktive afatgjata të dëmtuara".

Pika 36. Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

-Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur.

Mjetet e transportit të dëmtuara gjendje në periudha viti 2020.

Nr	Emërtimi	Nj/m	Sasia	Përshkrimi	Vlera
21	Kamion Mercedes Benz targa AA 628 AV	Copë	1	Jashtë përdorimi	3.120.000
22	Zetor me goma	Copë	1	Jashtë përdorimi	583.101
23	Rimorkio	Copë	1	Jashtë përdorimi	170.000
24	Eskavator	Copë	1	Jashtë përdorimi	2.998.000
25	Mikrobuz Varrimesh "FORD"	Copë	1	Jashtë përdorimi	1.630.000
26	Kamion "MT -6 Ceke" (BZ 0224 A)	Copë	1	Jashtë përdorimi	98.890
27	Kamion "IFA" DDR 4 ton	Copë	1	Jashtë përdorimi	270.000
28	Mikrobuz "BEDFORD"	Copë	1	Jashtë përdorimi	96.000
29	Kamion Benz Vetshkarkues 5 ton	Copë	1	Jashtë përdorimi	1.429.200
30	Kamion "MT-4 LIAZ" CEKE 7 ton	Copë	1	Jashtë përdorimi	270.400
31	Makinë Mitsubishi,	Copë	1	Jashtë përdorimi	1.290.000
	Totali				11,955,191

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Mjetet e transportit me kosto historike llog.(215) “Mjete transporti” viti 2020.

Nr	Emërtimi	nj/m	Sasia	Vlera
1	Land Rover Frilander targa AA 195 KT	Copë	1	1.092.000
2	Land Rover targa AA 806 RG	Copë	1	1.194.000
3	Toyota Land Cruiser targa AB 367 BJ	Copë	1	3.987.600
4	Mitsubishi targa AA 044 PZ	Copë	1	1.398.000
5	Zjarrfikëse Scania targa POL 0895	Copë	1	620.595
6	Mitsubishi targa AA 535 DP	Copë	1	1.194.000
7	Kamion Mercedes Benz targa AA 179 HP	Copë	1	2.024.400
8	Kamion Mercedes Benz targa AA 651 PE	Copë	1	3.396.000
9	Rimorkiator RTV DE Angelis, targa ADR 958	Copë	1	2.076.000
10	Land Rover , targa AA 250 IO	Copë	1	2.073.750
11	Mercedes Benz , targa BZ 1160 A	Copë	1	998.200
12	Fadrome tip JCB , targa ADMT 15 G	Copë	1	4.320.000
13	Eskavator me zinxhir VOLVO model EC 220D targa BB ESK	Copë	1	16.347.131

14	Mercedes Benz, Borepastruese+ kova e thika+ targa DI 3154 A	Copë	1	18.108.875
15	Kamion "MAN	Copë	1	2.976.000
16	Makine " BOT" spërkatës + karroceri, targa TR 8609R	Copë	1	1.249.577
17	Ford , targa DR 5375 E	Copë	1	712.416
18	Makine Vinç me kosh , targa AA 138 VP	Copë	1	3.360.000
19	Makinë me karroceri Mitsubishi, targa AA 672 OG	Copë	1	1.920.000
20	Mercedes Benz targa AA 382 NT	Copë	1	1.398.000
21	Kamion Mercedes Benz targa AA 628 AV	Copë	1	3.120.000
22	Zetor me goma	Copë	1	583.101
23	Rimorkio	Copë	1	170.000
24	Eskavator	Copë	1	2.998.000
25	Mikrobuz Varrimesh "FORD"	Copë	1	1.630.000
26	Kamion "MT -6 Ceke" (BZ 0224 A)	Copë	1	98.890
27	Kamion "IFA" DDR 4 ton	Copë	1	270.000
28	Mikrobuz "BEDFORD"	Copë	1	96.000
29	Kamion Benz Vetsharkues 5 ton	Copë	1	1.429.200
30	Kamion "MT-4 LIAZ" CEKE 7 ton	Copë	1	270.400
31	Makinë Mitsubishi,	Copë	1	1.290.000
	Totali			82,402,135

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare.

Për vitin 2020 është përdorur norma e amortizimit 5%

	Vlera në celje (Kosto historike)	Shtesa gjatë vitit 2020	Pakësime të tjera gjatë vitit	Vlera para amortizimit	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto më 31.12.2020
	65,701,652	18,902,5670	2,202,084	82,402,135	39,136,097	43,266,038

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare

-Gjendja llog.(218) "Inventar ekonomik" në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 43,060,427lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 46,175,435 lekë me diferencë më tepër shuma prej 3,115,008 lekë e cila përfaqëson shtesë në vlerë 5,888,330 lekë shpenzime kryer gjatë viti 2020 lista analitike e administruar nga Drejtoria e financës dhe pakësime të tjera në vlerë 358,594 lekë transferim nga njësi publike bashkia Bulqizë në ShaðUjësjeles Bulqizë, si dhe amortizimi vjetor për vlerën 2,432,658 lekë në masën 5%.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

-Gjendja e kësaj llogarie në datë 31.12.2020 pasqyrohet e përllogaritur nga Bashkia sa më poshtë.

	Vlera në celje 01.01.2020	Shtesa gjatë vitit 2020	Pakësime të tjera	Vlera para amortizimit	Amortizimi vjetor	Amortizimi akumuluar	Vlera neto 31.12.2020
	68,529,841	5,888,330	358,594	74,059,577	2,432,658	27,884,142	46,175,435

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare

3.Nën/rubrika, aktive afatgjata financiare, ku bënë pjesë referenca e llog.(26) ðPjesëmarrje në kapitalin e vetë, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerë 58,552,000 lekë, vlerë e pa ndryshuar gjendje në datën 31.12.2020 e cila përfaqëson vlerën e aksioneve të bashkisë në Ujësjeles Sha Bulqizë e mbartur nga viti 2015, për rrjedhojë dhe gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet e pa ndryshuar.

4.Nënrubrika, Investime.

-Gjendja llog.(230) "Aktive afatgjata jo materialeö, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 0 (Zero) lekë e pa ndryshuar edhe në datën 31.12.2020 në vlerë 0 (Zero) lekë, pra nuk ka objekte AAJM në proces.

-Gjendja llog.(231) "Për aktive afatgjata materiale" në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet në datën 31.12.2019 me vlerën 0(Zero) lekë e pa ndryshuar edhe në datën 31.12.2020 e pasqyruar me vlerën 0 (Zero) lekë, në këto kushte rezulton se, njësi publike Bashkia Bulqizë për këtë periudhë nuk ka objekte AAM në proces.

Nga analiza mbi këtë llogari rezulton se:

-Njësi publike Bashkia Bulqizë për peridhën raportuese ushtrimore viti 2020 rezulton me shpenzime për investime në 5 (pesë) objekte ndërtimore me vlerë **252,235,627 lekë** objekte të pa përfunduara brenda vitit ushtrimor dhe në proces financimi deri në përfundim sa të kalojnë në aktive te llogaritë e Klasa (2) ðAktive afat gjata materialeö. Për këtë dejtoria e financës nuk ka analizuar, dokumentuar e justifikuar në mënyrë analitike këtë llogari të cilën e ka paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar me vlerën 0 (Zero), ndërkohë që për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 këto 5 (pesë) objekte janë në proces ndërtimi e financimi, ndërsa vlera e tyre

është e përfshirë në vlerën e objektit në rikonstrukcion, duke e kaluar në llogaritë Klasa (2) *ō* **Aktive afat gjata materiale** si objekte të përfunduara, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, veprim në mospërputhje me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 *ō* **Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme**, Kap.(II), pikat (6;11), aneks (1), pika(2), Klasa (2), nën/pika 2.1, paragrafi; *ō* **Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi(20) *ō* Aktive afatgjata materiale** dhe pika (18), citohet se;

Kap.(II). Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika (6). Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues,

Pika (11). Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Aneksi (1), "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik";

Pika (2). Klasa (2), "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Nënpika (2.1). Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2;

Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata jomateriale".

Pika 18. Llogaritë përkatëse në klasën (2) funksionojnë si më poshtë vijon:

a) Për realizimin dhe njohjen e investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

-Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23); dhe

-Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (Klasa 4).

Objekte të pa përfunduara gjendje në vitin 2020 të pa administruara në llog.(231).

Nr	Emërtimi	nj/m	Sasia	Vlera
1	Rikonstrukcion blloku lagje e re Bulqizë	Copë	1	12.221.298
2	Rikonstrukcion total i rrjetit të furnizimit me ujë të qytetit Bulqizë	Copë	1	151,144,632
3	Rehabilitim i kanalit Tucep	Copë	1	27,000,000
4	Rrjeti shpërndarë i ujësjellësi fshatrave të Gjoricës	Copë	1	46,685,706
5	Sistemi asfaltim unaza e sipërme lagje e vjetër dhe lagje minatori	Copë	1	15,184,000
	Totali			252,235,627

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare.

B.Pasivet (Detyrimet).

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1.Nën/rubrika, llogari të pagueshme;

-Gjendja llog.(401-408) **"Furnitorë dhe llogari të lidhura me to"**; llog.(42) *ō* **Personeli e llogari të lidhura me to**; llog.(431) *ō* **Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa**; llog.(435) *ō* **Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore**; llog.(436) *ō* **Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore**; llog.(467) *ō* **Kreditorë të ndryshëm** janë të barabarta me gjendjen e llog.(4342) *ō* **Operacione me shtetin (të drejta)** e pasqyruar në vlerën 36,800,395 lekë për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 e analizuar përbëhet dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

N R	EMERTIMI	Gjendje 01.01.2020	Shtesa	Pakësimi	Gjendje 31.12.2020
1	Paga Personeli llog.(42)	13,292,279	881,893	0	14,174,172
2	Tatim page tatim ne burim llog.(431)	843,631	0	117,339	726,292
3	Sigurimet Shoqërore llog.(435)	13,255,330	0	8,041,653	5,213,677
4	Sigurime Shëndetësore llog.(436)	244,449	43,659	0	288,108
5	Furnitorë llog.(401-408)	7,289,557	9,108,589	0	16,398,146
6	Kreditorë të ndryshëm llog.(467)	24,888,975	3,418,806	0	28,307,781
	TOTALI	59,814,221	13,452,947	8,158,992	65,108,176

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare

Nga analiza e llogarive rezulton se; ndërmjet vlerës pasqyruar në llog.(4342) **"Operacione me shtetin (të drejta)"** dhe vlerës e pasqyruar në 6(gjashtë) llogari në pasiv për periudha raportuese ushtrimore viti 2020 nuk ka diferencë, pra është e njëjta vlerë e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja llog.(401-408) **"Furnitorë e llogari të lidhura me to"** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerë 7,289,557 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerën 16,398,146 lekë me diferencë më tepër vlera prej 9,108,589 lekë e cila përfaqëson detyrime shtesë të Bashkisë ndaj të tretëve për vitin 2020.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

Vlera **16,398,146 lekë** e pasqyruar gjendje në datë 31.12.2020 është e justifikuar me dokumente analitike me të dhëna të evidentuara sa më poshtë;

Pasqyra e detyrimeve për 9 subjekte gjendje më 31.12.2020.

Nr	Emërtimi furnitorit	Gjendja e detyrimeve në llog.(401-408) në 31.12.2020
1	BBulqizë (shpërblim këshilltar dhe kryetar fshati)	452,834
2	USha Bulqizë	424,008
3	OSHE	5,134,241
4	RSh	1,327,237
5	AB Person fizik	827,007
6	RO shpk blerje karburanti	1,336,119
7	Bashkia Bulqizë (blerje gazete)	4,380
8	AF AG(sisrtemim asfaltim brllojku poshte)	6,559,106
9	SHa PB(Shërbimi postar)	333,214
	TOTAL	16,398,146

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Për periudhën viti 2020.

-Gjendja llog.(42) **“Detyrime ndaj personelit** në datë 31.12.2020 pasqyrohet me vlerë **14,174,172 lekë** e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2020 të kuadruara me degën e thesarit Bulqizë dhe të likujduara në muajin janar 2021.

-Gjendja llog.(431) **“Detyrime ndaj shtetit tatim taksa** në datë 31.12.2020 pasqyrohet me vlerën **726,292 lekë** e cila paraqet detyrimet për tatim mbi të ardhurat e punonjësve për muajin dhjetor 2020 të kuadruara me degën e thesarit Bulqizë dhe të likujduara në janar 2021.

-Gjendja llog.(435) **“Sigurime shoqërore** në datë 31.12.2020 pasqyrohet me vlerën **5,213,677 lekë** e cila paraqet detyrimet për kontributin sigurime shoqërore të punonjësve për muajin dhjetor 2020 të kuadruara me degën e thesarit Bulqizë dhe të likujduara në janar 2021.

-Gjendja llog.(436) **“Sigurime shëndetësore** në datë 31.12.2020 pasqyrohet me vlerën **288,108 lekë** e cila paraqet detyrimet për kontributin sigurime shëndetësore të punonjësve për muajin dhjetor 2020 të kuadruara me degën e thesarit Bulqizë dhe të likujduara në janar 2021.

Këto vlera të llogarive (42; 431; 435; 436) të krahasuara me listpagesat e muajit dhjetor 2020 dhe evidencën e shpënzimeve të muajit janar 2021, janë të barabarta ndërsa përmbledhësja e listëpagesave rakordon me evidencën e shpenzimeve.

-Gjendja llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 28,773,921 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 35,510,372 lekë me diferencë më tepër shuma prej **6,736,451 lekë** e cila përfaqëson diferencën gjatë periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, ndërmjet ngurtësimit si detyrime të Bashkisë ndaj operatorëve ekonomik për 5% garanci në punimet e objekte në vlerën 22,333,569 lekë për 10 OE, si dhe likuidimeve të kryera në vlerën prej 15,597,118 lekë për 6 OE. Bashkia me degën e thesarit Bulqizë në datë 13.01.2021 ka mbajtur aktrakordim:

a) për 5% ngurtësime progresive në vlerën 35,510,372 lekë deri më 31.12.2020.

b) për 5% e likuidimeve progresive në vlerën 15,597,118 lekë deri më 31.12.2020.

Ndërmjet vlerës së ngurtësimeve prej 35,510,372 lekë dhe likuidimeve në vlerë 15,597,118 lekë, rezulton diferencë në vlerën 6,736,451 lekë e cila përfaqëson gjëndjen shtesë të llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje** në datën 31.12.2020 për detyrime të krijuara për gjatë vitit ushtrimor 2020, të pasqyruara më hollësisht në **(Anekset nr.11; 12; 13, pika nr.2/1)**, bashkëlidhur raportit.

Si përfundim konstatohet se: Në llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje** gjendje më datë 31.12.2020 paraqitet në vlerë 35,510,372 lekë e cila përfaqëson detyrime të bashkisë Bulqizë ndaj operatorëve ekonomik për garanci në punime objekte të përfunduara e në ndërtim ndër vite.

- garancia e trashëguar nga periudhat para ardhëse vlera 28,773,921 lekë.

-diferenca e krijuar ndërmjet likuidimeve e garancisë periudhën viti 2020 është 6,736,451 lekë .

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në pasqyrat e pozicionit financiar kjo llogari paraqitet në vlerën 35,510,372 lekë e cila rakordon me gjëndjen e pasqyruar e analizur në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe

operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimin në aktrakordime dhe në evidencat analitike për të gjithë OE për detyrimin që bashkia Bulqizë në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces të evidentuara në (**Aneksi nr.13, pika nr.2/1**), ndërsa nuk është bërë zhbllokimi vlerës së tyre sepse fondet gjenden të ngurtësuar në degën e thesarit Bulqizë, megjithëse është përmbushur afati garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës të evidentuara në (**Aneksat nr.11;12, pika nr.2/1**).

Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Financës, nuk janë marrë masa për bërë zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk është bërë njoftim subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit të duhur me qëllim likuidimin e vlerës së ngurtësuar, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse, veprime në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap.(III), pikat (30; 50), citohet se;

pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimi diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari viti kontabël që mbyllet”,

Pika 50. “Tepricat e llogarisë 520“Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet”,

-UKM nr.03, datë 15.02.2011 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kap.II, pika 10, ku citohet se;

Kap.(II); Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

-Në pasiv të bilancit pasqyrohet;

-Llog.(467) **“Kreditorë të ndryshëm”** gjendje në datë 31.12.2020 paraqitet me vlerë 28,307,781 lekë e cila përputhet me vlerën që pasqyrohet në llog.(486) **“Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2020 me vlerën 28,307,781 lekë e cila përfaqëson vlerat e faturave të pa likuiduara ndaj të tretëve.

Nga auditimi rezulton se; Detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve për faturat e pa likuiduara për investime, mall e shërbime të trajtuara në pikën e audituar në treguesit e buxhetit të bashkisë në datë 31.12.2020 paraqiten me vlerën 28,307,781 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar detyrimet e pa likuiduara gjendje deri në datë 31.10.2020 paraqiten të pasqyruara në llog.(467) **“Kreditorë të ndryshëm”** me të njëjtën vlerë për 28,833,238 lekë dhe në llog.(401-408) **“Furnitorë e llogari të lidhura me to”** me vlerë 16,398,146 lekë janë detyrime të krijuara për likuidim në periudhën 60 (ditë) deri në përfundim të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020.

Detyrimet e prapambetura për faturat e pa likuiduara ndaj të tretëve në vlerë 28,307,781lekë me analizë sipas natyrës detyrimit paraqiten të dhëna më poshtë:

Nr.	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2020
1	Detyrim për investimet	27,815,530
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	0
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	492,251
Total		28,307,781

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

-Llog.(4341) **“Operacione me shtetin (detyrime)”** në fund të periudhës raportuese ushtrimor viti 2020 paraqitet në vlerë 122,745,108 lekë e cila përfaqëson detyrimet debitore që i përkasin buxhetit të shtetit. Këto detyrime në aktivi bilancit paraqiten në llog.(468) **“Debitorë të ndryshëm”** e cila është në vlerë 122,745,108 lekë e trajtuar në aktiv të pasqyrave të pozicionit financiar, si dhe në llog.(423 429) **“Personeli, paradhënie, deficite,gjabaövlera 0(zero) lekë.**

-Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë. Bashkia Bulqizë në cilësinë njësi publike për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 në pasqyrat financiare ka të konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore të gjitha aktivitetin e

<p>bashkisë me pamje të strukturuar të informacionit kontabël për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare. Për këtë periudhë raportuese ushtrimore viti 2020, nuk disponon asnjë njësi publike me pozicion financiar të pavarur, veprim në përputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 <i>ËPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit</i>; neni 9, pika 4, germa (d), neni 12, pika 2, germa (b) të UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 <i>ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore njësitë Qeverisjes së Përgjithshme</i>, Kap.(II), pika (98; 99; 100; 101), germa (b), pika 118.</p>	
Kriteri:	<p>-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 <i>ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>, i ndryshuar. -Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 <i>ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare</i>, -Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 <i>ËPër arkivatë, Rregullore</i> <i>ËPër punën e dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore</i>. -VKM nr.783, datë 22.11.2006 <i>ËPër përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël</i>; -VKM nr.177, datë 08.03.2017 <i>ËPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page e caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë e punonjësve administrativë të Njësive Vetëqeverisjes Vendore</i>. -VKM nr.433, datë 08.06.2016 <i>ËPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit e aktualisht në administrim të M.Mjedisit e ish/Komunave/Bashkive</i> -VKM nr.684, datë 02.09.2020 <i>ËPër disa shtesa e ndryshime në VKM nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkive</i>. -UKM nr.3, datë 15.02.2011 <i>ËPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit</i>” i ndryshuar. -UMF nr.08, datë 09.03.2018 <i>ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme</i>, -UMF nr. 30, datë 27.12.2011 <i>ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llog.(35); (468); (202-203); (210-213); (215); (218); (230-231); (466), nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësive vendore të Bashkisë Bulqizë.</p>
Shkaku:	<p>Mos zbatim i kërkesave ligjore.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandime:	<p>-Titullari Bashkisë (<i>Nëpunës autorizues</i>) dhe Drejtori Financës (<i>Nëpunës zbatues</i>) të marrin masa të menjëhershme për të sistemuar vlerat e administruar në pasqyrat e pozicionit financiar dhe pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për këto llogari; llog.(468); llog.(202); llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog.(213); llog.(214); llog.(215); llog.(218/k); llog.(231) dhe llog.(466) të cilat për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 nuk pasqyrojnë me saktësi e vërtetësi vlerën e pasurisë së asetit të njësive publike vendore Bashkia Bulqizë, me qëllim që këto llogari në fund të periudhës raportuese ushtrimor viti 2021 të paraqiten të sistemuara në vlera të sakta për gjendjen e tyre.</p>
Titulli i Gjetjes:	<p>-Mangësi e pasaktësi e plotësisë së shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare e fluksit të parasë, vlersimi ngjarjeve ekonomike kur janë të domosdoshme kryerja e inventarizimit fizik e aktiveve, saktësia në procesin e inventarizimit fizik, nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale inventariale dhe administrimi e kontabilizimi i saktë e aktiveve.</p>
Situata:	<p>-Nënpika (2.2). Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë pamje të përgjithshme të</p>

pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.

-Për mënyrën e plotësimit të pasqyrave financiare, për saktësinë e analizën e llogarive të pasqyruara e të paraqitura në aktiv dhe në pasiv të bilancit, për të verifikuar nëse janë kontabilizuar si detyrime të gjitha (faturat) e prera, si dhe plotësia e saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike, pasqyrohen në vlerësimin e arsyeshëm të bazuar në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme. Për auditimin e vlerësimit të raportimit financiar është marrë në shqyrtim dokumentacioni i analizuar sa më poshtë:

-Dokumentet e inventarizimeve fizike për periudhën viti 2020.

-Listë pagesat me zgjedhje për periudhën viti 2020.

-Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën viti 2020.

-Akrakordimi me degën e thesarit Bulqizë për periudhën vitin 2020.

Nga shqyrtimi dokumentacionit të sipërcituar në lidhje plotësinë dhe saktësinë në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike u krye auditim i disa testimeve të ngjarjeve ekonomike që u vlerësuan si të domosdoshme për të dhënë pamje të përgjithshme e paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë dhe të opinionit për pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020.

Testet e kryera janë si në vijim:

a-Mbi administrimin e ndihmave ushqimore në Bashkinë Bulqizë, të furnizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH).

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Bulqizë ka përfituar ndihma ushqimore dhe pajisje inventari, për shkak të periudhës pandemisë COVID⁻¹⁹, si edhe për dëmtimet natyrore të krijuara për gjatë vitit 2020 të miratuara me VKB. U auditua procesi që ka ndjekur bashkia për administrimin e ndihmave materiale e ushqimore të përfituara nga DPRMSH Tiranë, ku për çdo rast furnizimi është kryer dokumentimi, ndërsa të gjithë artikujt të furnizuar janë administruar në magazinë me fletëhyrje të rregullt, bashkëlidhur së cilës është fletëdalja e furnitorit (DPRMSH). Secila fletëdalje është e shoqëruar me fletëhyrje përkatëse e bashkisë Bulqizë, të cilat rast pas rasti gjendja pasqyrohet sa më poshtë;

1-Fletëdalja nr.324, datë 21.08.2020 me fletëhyrje nr.29, datë 21.08.2020.

2-Fletëdaljanr.324, datë 21.08.2020, me fletëhyrje nr.29/1, datë 21.08.2020.

3-Fletëdalje nr.222/233, datë 24.09.2020, me fletëhyrje nr.36, datë 24.09.2020;

4-Fletëdaljenr.332/333/334/18, datë 09.10.2020, fletëhyrjenr.38, datë 09.10.2020;

5-Fletëdalje nr.12/13, datë 09.10.2020, me fletëhyrjen nr.39, datë 09.10.2020;

6-Fletëdalje nr.104/105/106, datë 23.10.2020, fletëhyrjenr.43, datë 23.10.2020;

7-Fletëdalja nr.110, datë 23.10.2020, me fletëhyrje nr.44, datë 23.10.2020;

8-Fletëdalja nr.294, datë 08.12.2020, me fletëhyrje nr.56, datë 08.12.2020;

9-Fletëdalja nr.295, datë 08.12.2020, me fletëhyrje nr.56/1, datë 08.12.2020;

Drejtoria e financës ka kontabilizuar të gjitha veprimet në ditarin e magazinës dhe ka debituar llogarinë përkatëse materiale.

Në përfundim të testimit konstatohet se:

Nga bashkia Bulqizë për periudhën objekt auditimi viti 2020 në të gjitha rastet e furnizimeve të bëra nga (DPRMSH), janë dokumentuar me fletëhyrje të rregullt dhe për çdo rast furnizimi është konfirmuar marrja në dorëzim e gjithë furnizimit gjatë vitit brenda afatit 20 ditë të muajit pasardhës, veprim në përputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kap.(III) òRegjistri aktiveve e dokumentimi lëvizjes së tyre, Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuaraò, pika 56, ku citohet se;

Pika 56. Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësia publike pritëse e aktivitetit i përcjell aktkonfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës. Aktkonfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse.

b-Transaksione financiare për paga, tatim mbi pagë, kontribut sigurime shoqëror shëndetësore.

U auditua procedura në lidhje me përlllogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa u përzgjedh periudha 4/mujore brenda vitit 2020 për strukturën (aparati bashkisë) ku rezultoi se; referuar në listë pagesat e vitit 2020 për muajt

(Mars; Qershor; Gusht; Nëntor) të pasqyruara edhe në përmbledhësen e listë pagesave të çdo muaji në lidhje me përlogaritje e detyrimeve për tatimin mbi pagë, detyrimi për sigurime shoqërore e shëndetësore, si dhe urdhër shpenzimet për likuidimin e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe organeve tatimore, përlogaritja e detyrimeve e pagesat sa më poshtë:

Pagat sipas listë pagesave për muajin Mars 2020

Nr	Prog	Emërtimi	Paga Neto	Tatimi	Sigurime shoqërore +suplementare	Sigurime shëndetësore
1	01110	APARATI	4,445,788	267,185	512,613	90,371
TOTALI			4,445,788	267,185	512,613	90,371

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin për muajin Mars 2020

Nr. USH	datë	Objekti i shpenzimit	Llog 421	Llog 431	Llog 435	Llog 436
176	07.04.2020	Pagat e muajit Mars 2020	4,430,408			
218	21.04.2020	Detyrim permbarimor Mars 2020	15,380			
173	06.04.2021	Tatim+sig. shoq. Shënd+suplem		267,185	512,613	90,371
TOTALI			4,445,788	267,185	512,613	90,371

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Pagat sipas listë pagesave për muajin Qershor 2020

Nr	Prog	Emërtimi	Paga Neto	Tatimi	Sigurime shoqërore +suplementare	Sigurime shëndetësore
1	01110	APARATI	4,297,754	240,451	493,916	87,025
TOTALI			4,297,754	240,451	493,916	87,025

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin për muajin Qershor 2020

Nr. USH	datë	Objekti i shpenzimit	Llog 421	Llog 431	Llog 435	Llog 436
379	02.07.2020	Pagat e muajit Qershor 2020	4,251,345			
426	16.07.2020	Detyrim permbarimor Qershor 2020	29,730			
409	10.07.2020	Detyrime telefoni Qershor 2020	16,679			
376	02.07.2020	Tatim+sig. shoq. Shënd+suplem		240,451	493,916	87,025
TOTALI			4,297,754	240,451	493,916	87,025

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Pagat sipas listë pagesave për muajin Gusht 2020

Nr	Prog	Emërtimi	Paga Neto	Tatimi	Sigurime shoqërore +suplementare	Sigurime shëndetësore
1	01110	APARATI	4,089,853	238,424	471,457	83,007
TOTALI			4,089,853	238,424	471,457	83,007

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin për muajin Gusht 2020

Nr.USH	datë	Objekti i shpenzimit	Llog 421	Llog 431	Llog 435	Llog 436
508	03.09.2020	Pagat muajit Gusht 2020	4,045,041			
87	12.02.2021	Detyrim permbarimor Gusht	21,030			
644	23.10.2020	Detyrim permbarimor Gusht	8,412			
542	11.09.2020	Detyrime telefoni Gusht	15,370			
505	03.09.2020	Tatim+sig. shoq. Shënd+suplem		238,424	471,457	83,007
TOTALI			4,089,853	238,424	471,457	83,007

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Pagat sipas listë pagesave për muajin Nëntor 2020

Nr	Prog	Emërtimi	Paga Neto	Tatimi	Sigurime shoqërore +suplementare	Sigurime shëndetësore
1	01110	APARATI	4,247,371	254,914	490,089	86,338
TOTALI			4,247,371	254,914	490,089	86,338

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin për muajin Nëntor 2020

Nr. USH	datë	Objekti i shpenzimit	Llog 421	Llog 431	Llog 435	Llog 436
745	03.12.2020	Pagat e muajit Nëntor 2020	4,197,059			
87	12.02.2021	Detyrim permbarimor Nëntor	21,030			
797	15.12.2020	Detyrim permbarimor Nëntor	8,412			
817	23.12.2020	Detyrime telefoni Nëntor 2020	20,870			
772	11.12.2020	Tatim+sig. shoq. Shënd+suplem		254,914	490,089	86,338
TOTALI			4,247,371	254,914	490,089	86,338

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

Në përfundim të testimit konstatohet se:

Procedurat dhe transaksioni financiar në lidhje me pagat, tatimi mbi pagë, kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore për muaji dhjetor viti 2020, për të cilat likuidimi bëhet në muajin janar viti 2021, janë sipas listë pagesave të muajit dhjetor 2020 detyrimet për paga të personelit (*aparati bashkisë*) janë në vlerën 4,826,432 lekë, për kontributi sigurime shoqërore e suplementare në vlerën 554,529 lekë, për sigurime shëndetësore në vlerën 97,870lekë dhe për tatimin mbi të ardhurat në vlerën 278,201 lekë, vlera të cilat janë të likuiduara në muaji janar të vitit 2021, të pasqyruara me urdhër shpenzimet përkatëse dhe në vlerat e pasqyruar për secilin detyrim sa më poshtë;

Pagat sipas listë pagesave për muajin Dhjetor 2020

Nr.	EMËRTIMI	Dhjetor 2020
1	Paga Personeli (421)	4,826,432
2	Tatim page tatim ne burim (431)	278,201
3	Sigurimet Shoqerore (435)	554,529
4	Sigurimet Shendetësore (436)	97,870
TOTALI		5,757,032

Burimi: Drejtoria Financës Bashkia Bulqizë

c-Testim për rregullshmërinë e aplikimit të pagave dhe shtesave mbi pagë.

Për auditimin në lidhje me rregullshmërinë e pagave e shtesave u përzgjedhën pagesat që njësia publike bashkia Bulqizë ka kryer në muaji dhjetor 2020 për 15 persona në aparati bashkisë të evidentuara në (***Aneksi nr.14, pika 2/2***), bashkëlidhur;

Nga procesi auditimit në lidhje me rregullshmërinë për pagat e shtesat mbi pagë për 15 persona në aparatin e bashkisë në muajin dhjetor viti 2020 të përlogarituara më sipër nuk u konstatuan diferenca. Për vitin 2020 pagat e shtesat janë kryer, në përputhje me VKM nr.177, datë 08.03.2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.165, datë 2.03.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, dhe VKB nr.63, datë 24.12.2019 për miratimin e buxhetit dhe pagës së punonjësve të bashkisë Bulqizë, njësive dhe institucioneve në varësi për vitin 2020”*.

d-Mbi evidentimin e konsumit të karburantit.

Për vitin 2020 me urdhër të Titullarit nr.63, datë 12.02.2020 *“Për menaxhimin e aktiveve të bashkisë (mjetet e transportit)”* është ngarkuar Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative të administrojë lëvizjen dhe dokumentimin e mjeteve të transporti të bashkisë, për të cilën kjo drejtori përpara daljes së urdhërit me procesverbal datë 20.01.2020 ka miratuar dhe përlogaritur normativat e konsumit (*kronometrimit*) për 20 mjete transporti e agregate në qarkullim dhe në gjendje teknike pune për vitin 2020, ndërsa për 11 mjete transporti është pasqyruar se, janë gjendje jashtë përdorimit. Nëpërmjet urdhërit të titullarit të bashkisë është miratuar plani i harxhimit dhe shpërndarja për çdo muaj vetëm me urdhër të lëshuar nga zv.Kryetare e bashkisë me sistemin elektronik të shpërndarjes për sasinë e daljes së karburantit të secilit mjet, ndërsa çdo muaj është përgatitur përmbledhësja e udhëtimit të secilit mjet transporti i nënshkruar nga drejtori shërbimeve dhe drejtuesi i mjetit. Në përmbledhësen e udhëtimit janë shënuar destinacioni i lëvizjes dhe km e përshkuara dhe është bërë përlogaritja e konsumit të karburantit sipas normativave të miratuara në fillim të vitit nga komisioni i miratuar nga titullari i Bashkisë.

e-Transaksionet financiare të kryera me veprime nëpërmjet arkës.

Nga auditimi i dokumentacionit për veprimet e kryera nëpërmjet arkës rezultoi se: me arkë janë kryer transaksione financiare, vetëm për arkëtimin e të ardhurave detyrime të lindura nga taksa e tokës bujqësore; taksat e tarifave familjare e biznesi, si dhe kuota ushqimore për fëmijët e kopshte e cerdhet, nëpërmjet mandat/arkëtimet të plotësuar me gjithë ekstremitetet, si dhe sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga drejtoria e taksave e tarifave vendore, apo listëprezenca mujore e dërguar nga Drejtoria e Arsimit e kulturës në bashki. Nga arka nuk rezultojnë jetë kryer asnjë transaksion për pagës me cash. Për vitin 2020 mandat/arkëtimet e prerë fillojnë (*nr.1, datë 06.01.2020 me vlerë 200 lekë dhe mbyllet nr.1479, datë 31.12.2020 me vlerë 320 lekë*). Në librin dhe ditarin e arkës konstatohet se, të ardhurat nga arkëtimet e kryera janë në vlerë 1,256,622 lekë, të cilat në

fund të cdo muaji janë derdhur totalisht në bankë nëpërmjet (m/p nr.1, datë 22.01.2020 me vlerë 111,880 lekë dhe m/p nr.22, datë 31.12.2020 me vlerë 67,860 lekë) me përshkrimin derdhje në bankë, gjendja e arkës në fund të muaji dhe vitit është në mënyrë periodike me gjendje 0 (zero) lekë, gjithashtu është mbajtur ditar i arkës në formë klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Drejtoria e Financës ka kryer aktrakordime mujore e vjetore me degën e thesarit Bulqizë për të ardhurat, ndërsa përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë bazuar në vijueshmërinë kontabële në përputhje me VKM nr.783, datë 22.11.2006 *ËPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlë dhe UMF E nr.30, datë 27.12.2011 ËPër Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë* pikat 63, 64.

f-Saktësia e plotësimit të Urdhër shpenzimeve.

Për periudhën objekt auditimi në lidhje me U/shpenzimet u testuan dokumentet e transaksioneve të kryera nëpërmjet veprimeve me bankë në 3/mujori II 2020 me konkretisht muaji (Prill; Maj; Qershor nga nr.172, datë 03.04.2020 me vlerë 10,028,790 lekë deri nr.368, datë 25.06.2020 me vlerë 430,920 lekë). Hartimi u/shpenzimit është bërë mbi bazën e dokumentit mbështetës e justifikues, formati i së cilit është sipas UMF E duke aplikuar rregullisht sistemiin me firmë të dyfishtë, të nënshkruar nga NA dhe NZ. Plotësimi është bërë në të gjitha ekstremitetet në të cilin përcaktohen qartë objekti shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumenti justifikues. U/shpenzimet janë konfirmuar nga specialisti degës Thesarit Bulqizë dhe janë likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve. Për rastet e likuidimit të punimeve në ndërtim (*investimet*) u/shpenzimet e testuar kanë bashkangjitur dokumentat: urdhër prokurimi; formulari njoftim fituesi, kontrata midis palëve; situacioni punimeve të kryera; fatura e shitjes e operatorit përfitues; urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim; certifikata e përkohshme, ose përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve; aktkolaudimi përfundimtar. Për rastet e blerjeve u/shpenzimet kanë bashkangjitur dokumentet: urdhër prokurimi; njoftim fituesi e njoftim për lidhje kontrate; fotokopje e kontratës midis palëve; fatura e shitjes e operatorit përfitues, urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim; procesverbali marrjes në dorëzim dhe fletë hyrja e magazinës. Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara, kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë të regjistruara. Shumat dhe të dhënat e tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme. Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël në përputhje me ndarje buxhetore në dispozicion.

g-Inventarizimi fizik i llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale, Jo Materiale (AAMJM), sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shtesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur në periudha ushtrimore raportuese 2020.

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* o i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015; ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare* o, pika (1), neni (7) *ËInventari aktiveve e detyrimeve* o; UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë*, Kreu (IV) *ËSistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve* o pika (81) dhe UMF nr. 28, datë 15.12.2011 *ËMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike* o, në njësinë publike vendore bashkia Bulqizë u audituan procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë asete të njësisë publike bashkia Bulqizë të administruara në llogaritë e pasqyrave financiare të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020 sa më poshtë;

I-ËAktive afat shkurtëra:

2-ËGjendje inventar qarkulluesë, ku përfshihen;

-llog.(31) "Materiale", me vlerën 11,614,210 lekë,

-llog.(32) "Inventari imët", me vlerën 24,628,289 lekë.

II-ËAktive afat gjata:

1-ËAktive afatgjata jo materiale, ku përfshihen;

-llog.(202) "Studime e projekte", me vlerën 15,347,091 lekë,

2-ËAktive afatgjata materiale, ku përfshihen;

- llog.(210) "Toka, troje e terrene", me vlerën 8,036,366 lekë,
- llog.(211) "Pyje, plantacione", me vlerën 16,494,469 lekë,
- llog.(212) "Ndërtimi, konstruksione", me vlerën 949,798,585 lekë,
- llog.(213) "Rrugë, rrjete e vepra ujore", me vlerën 2,437,349,254 lekë,
- llog.(214) "Instalime teknike, makineri e pajisje", me vlerën 10,077,835 lekë,
- llog.(215) "Mjete Transporti", me vlerën 43,266,038 lekë,
- llog.(218) "Inventar ekonomik", me vlerën 46,175,435 lekë.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion i administruar në dosjen e inventarizimit fizik të njësisë publike bashkia Bulqizë për periudhën raportuese ushtrimore objekt auditimi viti (2020) u konstatua se; Për realizimin e procesit të inventarizimit fizik për vitin 2020 me objekt; *ogjendje inventar qarkulluesö; ðAktive afatgjata jo materialeö e ðAktive afatgjata materialeö*, si pasuri, asete dhe vlera materiale në përdorim të bashkisë Bulqizë, nga Titullari bashkisë janë nxjerr urdhëra të brendshëm për të kryer procesin e inventarizimit fizik, sipas njësive që do të inventarizohen sa më poshtë;

a-Urdhërin nr.5000, datë 28.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve për Bashkia Bulqizë" i përbërë nga; ESh; RA dhe EB.

b-Urdhërin nr.5000/1, datë 27.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve të NJA Martanesh" i përbërë nga; ES; RA; EB; AH dhe Drejtori përkatës i shkollës

c-Urdhërin nr.5000/2, datë 27.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve të NJA FushBulqizë" i përbërë nga; ESh HI; AL; ShC dhe drejtori përkatës i shkollës.

d-Urdhërin nr.5000/3, datë 27.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve të NJA Zerqan" i përbërë nga; ESh; HI; AL; ShT dhe drejtori përkatës i shkollës.

e-Urdhërin nr.5000/4, datë 27.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve të NJA Shupenza" i përbërë nga; ESh; LA; OL; HP dhe drejtori përkatës i shkollës.

f-Urdhërin nr.5000/5, datë 27.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve të NJA Gjorica" i përbërë nga; ESh; LA; OL; N C dhe drejtori përkatës i shkollës.

g-Urdhërin nr.5000/6, datë 27.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve të NJA Trebisht" i përbërë nga; Esh,MJi; AGj; EO e drejtori përkatës i shkollës.

gj-Urdhërin nr.5000/7, datë 27.10.2020 "Për krijimin e komisionit për inventarizim të plotë të aseteve të NJA Ostren" i përbërë nga; ESh MJ; AGj; AT dhe drejtori përkatës i shkollës

Në këto urdhëra titullari ka miratuar ngritjen e komisioneve për kryerjen e procesit të inventarizimit fizik në objektet; (Bashkia Bulqizë dhe NJA Martanesh; FushBulqizë; Zerqan; Shupenz; Gjoric; Trebisht dhe Ostren) me komisione të ndara për bashkia dhe NJA me përbërje; gjithësej 17 anëtarë me pjesë përbërëse edhe drejtori i secilës shkollë përkatëse që do të inventarizohet.

Procesi i inventarizimit fizik dhe dokumentimi i tij do fillojë në datë 28.11.2020 dhe do të përfundojë në datën 30.11.2020. (ose për 3 ditë kalendarike).

Në dosjen e inventarizimit fizik me dokumentacionin e procesit të inventarizimit të dorëzuar në Drejtorinë e Finacës rezultoi se; komisionet për të pasqyruar procesin e inventarizimit kanë paraqitur fletë inventarë për e inventarizuar në llog.(31) "Materiale"; llog.(32) "Inventari imët"; llog.(214) "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe llog.(218) "Inventar ekonomik", në të cilat vetëm janë plotësuar fletë inventarët me gjendjen kontabile dhe fizike sipas llogarive inventariale, ndërsa në përfundim u konstatuan disa mangësi e shkelje në zbatimin e dispozitave ligjore me ndikim në evidentimin e gjendjes reale të aktiveve në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese viti 2020 të cilat më hollësishtë paraqiten sa më poshtë;

I-Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, në asnjë rast anëtarët e komisionit të inventarizimit nuk kanë përpiluar deklaratë për konflikt interesi me punonjës in me përgjegjësi materiale, ose që ka në përdorim aktive, apo në raste të vëcanta kur anëtar komisioni për inventarizim është i përfshirë edhe drejtuesi i njësisë që inventarizohet njëkohësisht edhe përgjegjës material, në mospërputhje me ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 *ðPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeö dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ðPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 82, ku citohet se: ð. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi..

2-Komisioni inventarizimit në fillim të procesit për asnjë objekt të inventarizuar nuk ka në

dispozicion listën e aktiveve që do inventarizohet e hartuar nga nënpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara nga regjistrat kontabël për secilën llogari kontabile të njësisë publike vendore bashkia Bulqizë, në mospërputhje me pika 81, UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3-Komisioni inventarizimit në asnjë rast në fillim të procesit, nuk ka hartuar aktrakordim për të përcaktuar e fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes e fletëdaljes së fundit e kontabilizuar në objekti inventarizuar, në mospërputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika (83) ku citohet se: “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja e dyllosja e magazinës. Hapja e mbyllja bëhet në prani komisionit përgjegjësi material”.

4-Komisioni inventarizimit në përfundim të procesit sipas objekteve që ka inventarizuar, nuk ka përgatitur për Titullarin e njësisë publike vendore (*nëpunës autorizues*), raport përmbledhës informues lidhur me rezultatet e inventarizimit, me gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve, pasurisë, aseteve e vlerave inventarë në përdorim nga personat përgjegjës të aktiveve afatgjata materiale, jo materiale dhe qarkulluese, në mospërputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kap (IV), pika (85), gërma (c), njëkohësishtë detyrime të parashikuara edhe nga pikat (9; 10; 12) të udhërit nr.656, datë 13.11.2020.

5-Komisioni inventarizimit në ato objekte ku ka kryer proces inventarizimi në; (*bashki dhe NJ Administrative përfshirë arsimit parashkollor, parauniversitar*), megjithëse në disa fletë inventarë ka pasqyruar me shënime në lidhje me gjendjen cilësore të artikujve si; (*jashtë përdorimi, jashtë funksioni, ose dëmtuar*), në përfundim të procesit u konstatua se;

a-në anjë rast komisioni nuk ka bërë asnjë vlerësim mbi gjendjen cilësore me evidentim për cdo artikull të inventarizuar, njëkohësishtë nuk ka përpiluar raport për ato aktive që duhen vlerësuar me evidentim (*jashtë përdorimi*) me qëllim për tu nxjerrë jashtë përdorimi duke ndjekur procedurat për grumbullimin e tyre në ambjente të vecanta që këta artikuj të mos riqarkullojnë në periudhën raportuese pas ardhëse si gjendje inventar fizik, vlerësim i cili do të shërbejë si bazë për asgjësim të tyre, në mospërputhje me pikat nr.85, gërma (a); 86; 95, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimi aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

b-në shumë raste në fletë inventarë fizik vecanërishtë në objektet (*Bashkia; Policia bashkiake; Kopshti “Elena Kola”; Qendra kulturore; Shkolla “Xhevdet Doda”; Rrugët rurale; Shkolla “Shefqet Tanci”, etj*) rezultoi se, ato fletë e inventarit janë të pa nënshkruara prej anëtarëve të komisionit, vecanërishtë edhe nga punonjësi me përgjegjësi materiale, ndërsa në fletëinventarë e Shkolla “Shefqet Tanci” nuk ka asnjë nënshkrim, në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ōPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ō, pika (1), neni (7) *ōInventari aktiveve e detyrimeve*ō; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *ōPër menaxhimin financiar e kontrollin*ō i ndryshuar me ligji nr.110/2015, datë 15.10.2015; UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ō, Kreu (IV) *ōSistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve*ō, pika 85 *ōPërgjegjësitë e komisionit të inventarizimit fizik*ō; pika 86, ku citohet se:*ōPersonat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit*ō.

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e shkeljet e konstatuara gjatë procesit të inventarizimit fizik në llogarit e Aktiveve Afatgjata Materiale, Jo Materiale sipas klasifikimit dhe mbajtjes së kartelave të trajtuara me analizë të hollësishme me mungesë në zbatimin e përgjegjësive të detyrës ngarkohen me përgjegjësi;

1-ESH në cilësinë ish/Kryetare komisioni inventarizimit në Bashkia

2-RA, me detyrë specialist njësia e integritit e projekte të hualja

3-EB, me detyrë specialiste në DTTV

4-AH, me detyrë administrator NJA Martanesh

5-HI; me detyrë specialist i financës

6-AL; specilaist në arsimit rinia dhe sporti

7-ShC; me detyrë administrator NJA F-Bulqizë deri 13.11.2020

- 8-ShT, me detyrë administrator NJA Zerqan
- 9-LA; me detyrë specialiste në sektori i turizmit
- 10-OL; me detyrë specialist në DTTV
- 11-HP, me detyrë administrator NJA Shupenzë
- 12-NC, me detyrë administrator NJA Gjoricë
- 13-MJ; me detyrë specilaiste e GIS
- 14-AGj me detyrë specilaist i financës
- 15-EO, me detyrë administrator NJA Trebisht
- 16-AT, me detyrë administrator NJA Ostren

-Baza ligjore.

- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollin*, i ndryshuar;
- Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*;
- Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 *ËPër arkivatë dhe zbatimin rregullores ËPër punën e dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore*;
- VKM nr.783, datë 22.11.2006 *ËPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlë*;
- VKM nr.433, datë 08.06.2016 *ËPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkive transferuar në pronësi bashki Bulqizë*;
- VKM nr.684, datë 02.09.2020 *ËPër disa shtesa e ndryshime në VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkive*;
- VKM nr.946, datë 02.09.2009 *ËPër miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Bulqizë, qarku Dibërë*;
- VKM nr.540, datë 27.07.2026 *ËPër disa ndryshime e shtesa në VKM nr.946, datë 02.09.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë, qarku Dibërë*;
- VKM nr.5, datë 04.01.2013 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkia Bulqizë, qarku Dibërë*;
- VKM nr.809, datë 06.10.2010 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Zerqan, qarku Dibërë*;
- VKM nr.480, datë 30.05.2013 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës FushëBulqizë, qarku Dibërë*;
- VKM nr.903, datë 21.12.2011 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Trebisht, qarku Dibërë*;
- VKM nr.160, datë 27.02.2013 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ostren, qarku Dibërë*;
- VKM nr.523, datë 30.06.2010 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Martanesh, qarku Dibërë*;
- VKM nr.483, datë 30.05.2013 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Shupenzë, qarku Dibërë*;
- VKM nr.177, datë 08.03.2017 *ËPër disa ndryshime e shtesa në VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*.
- VKB nr.41, datë 24.10.2019 *ËPër miratimin e pagave dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të administratës së Bashkisë Bulqizë, Ndërmarrjeve dhe Njesive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Bulqizë për vitin 2020*’.
- UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë sektorit publik”, Kap.(III) “Regjistri aktiveve e dokumentimi lëvizjes së tyre, Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara*.
- UMFE nr.28, datë 18.12.2014 *ËPër procedura mbylljes së llogarive vjetore buxhetit viti 2014*”;
- UKM nr.03, datë 15.02.2011 *ËPër mbikëqyrje e kolaudimin e punimeve të ndërtimitë ndryshuar*;
- UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*;
- VKB nr.63, datë 24.12.2019 *ËPër miratimin e buxhetit dhe pagës së punonjësve të bashkisë Bulqizë, njësive dhe institucioneve në varësi për vitin 2020*.

Konkluzione të përgjithshme mbi analizën e llogarive të pasqyrave të pozicionit financiar për periudhën raportuese viti 2020.

Në Bashkinë Bulqizë nga Drejtoria e Financës janë përgatitur pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020 dhe janë dorëzuar në degën e Thesarit Bulqizë brenda afatit ligjor.

Nga analiza e referencave të llogarive të pasqyrave të pozicionit financiar kryesisht në rubrikat e aktiveve afat shkurtra, të aktiveve afatgjata e pasive afatshkurtra u konstatuan disa mangësi e parregullsi më hollësisht të evidentohen sa më poshtë:

I-Në rubrika, aktive afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata jo materiale rezulton se;

1-Në llog.(202) “Studime dhe kërkime”.

-Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Vlera prej **29,145,487 lekë** me kosto historike që i përket 31 projekteve për investimet që janë kryer në objekte të cilat ka përfunduar zbatimin i punimeve dhe janë marrë në dorëzim nga bashkia Bulqizë, kjo vlerë duhet të ishte e sistemuar në llogarinë përkatëse të investimit që është përfunduar, si pjesë e kostos totale të objekteve. Për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë vërtetësin e gjendjes së aktiveve, të evidentuara në **(Aneksi nr.6, pika 2/I)** bashkëlidhur, veprim në mospërputhje me UKM nr.02, datë 08.05.2003 *“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, pika 6, nën-pika 6, si edhe UMF nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, aneksi (1), Klasa (2), pika (2.1), pika (36), paragrafi (4).

II-Në rubrikën, aktive afat shkurtra, Nën/rubrika, llogari të arkëtueshme rezultoi se;

2-Në llog.(468) “Debitorë të ndryshëm”.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Bazuar mbi të dhëna e gjendjes debitorë që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ka raportuar me evidencë për vitin 2020, se shtesa debitorë është me vlerën 12,866,486 lekë, ndërsa bazuar në gjendjen debitorë e raportuar në pasqyrat financiare (*bilanci*) shtesa është me vlerën 8,323,142 lekë, diferencë e pa argumentuar në vlerën prej **4,545,344 lekë** (12866486-8323142), për pasojë kjo llogari nuk pasqyron e administron të gjitha detyrimet debitorë të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore për subjektet privat dhe subjekte familjar, në këto kushte pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, nuk pasqyrojnë vërtetësinë në gjendjen e detyrimeve debitorë me analizë të subjekteve për mospagim të nivelit taksave e tarifave vendore të njësisë publike bashkia Bulqizë, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive Qeverisjes së Përgjithshme”*, aneksi (1), pika (3.3).

III-Në rubrikën, aktive afat gjata. Nën/rubrika, aktive afat gjata materiale rezultoi se;

3-Në llog.(210) “Toka, Troje, Terrene”.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në këtë llogari nuk është pasqyruar edhe vlera e trojeve të cilat kanë kaluar si asete në pronësi të Bashkisë Bulqizë me VKM nr.946, datë 02.09.2009 *“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë, qarku Dibërë; i ndryshuar me VKM nr.540, datë 27.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.946, datë 02.09.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë, qarku Dibërë; VKM nr.5, datë 04.01.2013 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkia Bulqizë, qarku Dibërë; VKM nr.809, datë 06.10.2010 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Zërzan, qarku Dibërë; VKM nr.480, datë 30.05.2013 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës FushëBulqizë, të qarkut të Dibërë; VKM nr.903, datë 21.12.2011 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Trebisht, qarku Dibërë; VKM nr.160, datë 27.02.2013 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ostren, qarku Dibërë; VKM nr.523, datë 30.06.2010 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që*

transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Martanesh, qarku Dibërë; VKM nr.483, datë 30.05.2013 *ËPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Shupenzë, qarku Dibërë*; pasqyrohen jo të plota në kontabilitet për mungesë të vlerës së objektit, pasqyruar në (**Aneksi nr.7, pika 2/1**) bashkëlidhur, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë Qeverisjes Përgjithshmeö, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2); pika (30).*

b) Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, Kap. IV, pikat 74; 96, 4-Në llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione”.*

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në këtë llogari nuk është e pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Bulqizë me VKM nr.433, datë 08.06.2016 *ËPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkiveö, pika 9, shtojca nr.7 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Bulqizë, me nr.1(një) deri 2236 (dymijë e dyqind e tridhjet e gjashtë) dhe VKM nr.684, datë 02.09.2020 *ËPër disa shtesa e ndryshime në VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/ Bashkiveö, pika 1, germa (a) me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Bulqizë e ndryshuar shtojca nr.7 nga nr.1(një) deri nr.2262 (dymijë e dyqind e gjashtëdhjet e dy), përfshirë edhe godina e DSHP e pasqyruar në llog.(212). Sipas këtij vendimi dhe vendimit të ndryshuar rezulton se, bashkia Bulqizë ka në pronësi gjithsej **43,125 ha**, nga të cilët 32,752 ha pyje; 4,325 ha kullota, 6,049 ha sipërfaqe inproduktive (shkëmbore), veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kap.II, Pika 11, aneksi 1,pika 2, Klasa 2.***

b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi Pyjeve e Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, ndërsa llog.(211) *ËPyje, kullota, plantacioneö* nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, veprime në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kap.II, Pika 11, aneksi 1, Pika 2, Klasa 2,*

5-Në llog.(212) “Ndërtime e konstruksione”.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në këtë llogari nuk është pasqyruar e saktë vlera për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime për gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimit shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objektit, vlera mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet e mirëmbajtje e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare AAGJM^{së}. Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 980,307,610 lekë për 139 objekte të evidentuar sipas (**Aneksi nr.8, pika 2/1**) bashkëlidhur raportit, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).*

b) Për periudhën viti 2020 ka zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 15,059,082 lekë e cila vjen për shkak të përlllogaritjes gabim të normës së amortizimit me pasëoj edhe me ndryshim të vlerës së amortizimit detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, pika (36).*

c) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö, neni (15), pikat (1; 2); UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e**

aktiveve në njësitë e sektorit publikö, Kap.(IV), pikat (74;96); UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *öPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeö*, pika (36), paragraf (4).

6-Në llog.(213) “**Rrugë, rrjete vepra ujore**”.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në përllogaritjen e amortizimit vjetor të aktive afatgjata për periudhën raportuese ushtrimore 2020 në vlerë 153,644,775 lekë rezulton se, norma mesatare vjetore është përllogaritur me 5%, duke respektuar normën e amortizimit, në përputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *öPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö*, pika 36.

b) Në këtë llogari nuk është pasqyruar e saktë vlera për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM^{së}. Investimeve shtesë në total deri në 31.12.2020 janë në vlerë 406,534,723 lekë për 24 raste objekte, veprim në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *öPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö*, Kap.(II), pika (11), Aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).

c) Për periudhën viti 2020 ka zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 99,245,173 lekë e cila vjen për shkak të përllogaritjes gabim të normës së amortizimit me pasëoj edhe me ndryshim të vlerës së amortizimit, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 *öPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö*, pika (36).

d) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM^{ve} me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, të evidentuara në (**Aneksi nr.9, pika 2/I**), veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 *öPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö*, neni 15, pikat 1 dhe 2; UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *öPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö*, Kap.(IV), pika 74 dhe 96; UMF nr.08, datë 09.03.2018 *öPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeö*, pika (36).

6-Në llog.(214) “**Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune**”.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Referuar në procesin e inventarizimit fizik të (AAM) dhe pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, rezulton se llog.(214) është paraqitur me vlerë 48,602,818 lekë me kosto historike në të cilën është e përfshirë edhe vlera prej 18,200,596 lekë për disa artikuj *öpajisje kompjuterikeö* të cilët duhet të administrohen në llog.(218/k) *öInventar ekonomik*”, si dhe vlera prej **1,422,368 lekë** për disa artikuj “*bateri kompjuteri e televizor*” të cila duhet të administrohen në llog.(327) *öInventar i imët*”, të pasqyruara të tilla dhe në procesin e inventarizimit fizik të (AAM), me pasojë kontabilizim gabim në administrim llog.(214)*öInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla puneö* për të cilat është përllogaritur gabim edhe amortizim vjetor në masë 5% me vlerë 910,030 lekë. Për këtë llogari amortizimi duhet përllogaritur në masën 25% për vlerën 3,640,119 lekë vlerë e cila duhet të shtohet në llog.(218) *öInventar ekonomik*”, për të njëjtën vlerë me analizë cdo artikull të evidentuara në (**Aneksi nr.10, pika 2/I**) bashkëlidhur, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *öPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshmeö*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), klasa (2).

7-Në llog.(215) “**Mjete transporti**”.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në llog.(215) *öMjete transportiö* të pasqyrave të pozicionit financiar viti 2020 e paraqitur në vlerën 82,402,135 lekë me kosto historike është e përfshirë edhe vlera për 11 (*njëmbëdhjetë*) mjete transporti në gjendje teknike jahtë përdorimit të dëmtuara të pasqyrurara me vlerë historike **11,955,191 lekë**, për të cilat është kryer kontabilizim i gabuar në llog.(215) *öMjete Transportiö* dhe përllogaritur amortizim vjetor në vlerën 10,373,968 lekë në masë 5%, ndërsa amortizimi i

akumuluar është në vlerë 39,136,097 lekë. Për këto 11 (njëmbëdhjetë) mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, por të dëmtuara vlera e tyre duhej të ishte e regjistruar dhe kontabilizuar në llog.(24) ÷Aktive afatgjata të dëmtuara÷ me analizë cdo mjet sipas tabelës përkatëse, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshme÷, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2/1), germa (e); pika 36).

IV-Në rubrikën, aktive afat gjata, nën/rubrika, (Investime) rezultoi se;

9-Në llog.(231) **“Për aktive afatgjata materiale”**.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Njësia publike Bashkia Bulqizë për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 rezulton me shpenzime për investime në 5 (pesë) objekte ndërtimore me vlerë **252,235,627 lekë** objekte të pa përfunduara brenda vitit ushtrimor dhe në proces financimi deri në përfundim sa të kalojnë në aktive te llogaritë e Klasa (2) ÷Aktive afat gjata materiale÷. Për këtë dejetoria e financës nuk ka analizuar, dokumentuar e justifikuar në mënyrë analitike këtë llogari të cilën e ka paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar me vlerën 0 (Zero), ndërkohë që për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 këto 5 (pesë) objekte janë në proces ndërtimi e financimi, ndërsa vlera e tyre është e përfshirë në vlerën e objektit në rikonstruksion, duke e kaluar në llogaritë Klasa (2) ÷Aktive afat gjata materiale÷ si objekte të përfunduara, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, veprim në mospërputhje me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme÷, Kap.(II), pikat (6; 11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2), nën/pika (2.1.) paragrafi; ÷Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) ÷Aktive afatgjata materiale÷ dhe pika (18).

V-Në rubrikën, pasivet afat shkurtra, nënrubrika, llogari të pagueshme, rezultoi se;

10-Në llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”**.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në pasqyrat e pozicionit financiar kjo llogari paraqitet në vlerë 35,510,372 lekë e cila rakordon me gjendjen e pasqyruar e analizur në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimin në aktrakordime dhe në evidencat analitike për të gjithë OE detyrimin që bashkia Bulqizë në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces të evidentuara në (Anekset nr.11; 12;13, pika 2/1), ndërsa nuk është bërë zhblllokimi i vlerës së garancisë, sepse fondet gjenden të ngurtësuar në degën e thesarit Bulqizë, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

-Nga Drejtoria e Urbanistikës e Financës, nuk janë marrë masa për bërë zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk është bërë njoftim subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit të duhur me qëllim likuidimin e vlerës së ngurtësuar, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrës, në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(III), pika (30;50).

Për veprime e mos veprime në lidhje me mangësitë në vlerësimin e raportimit financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën raportuese viti 2020 për paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë publike Bashkia Bulqizë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi trajtuar hollësishtë ngarkohen me përgjegjësi:

-LA, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë nënpunës Autorizues

-RB, me detyrë Drejtor i Financës, në cilësinë nënpunës Zbatues.

-ShO, me detyrë Specialiste financës.

Kriteri:	-VKM nr.177, datë 08.03.2017 ÷Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore÷. -UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,
-----------------	---

	<p>Kreu (IV) <i>Systemi kontrollit periodik aktive</i>, pika 74 <i>Inventarizimi aktive</i>, Kap.(III) <i>Regjistri aktiveve e dokumentimi lëvizjes së tyre, Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara</i>.</p> <p>-UMF nr.28, datë 18.12.2014 <i>Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014</i>”,</p> <p>-VKB nr.54 datë 27.03.2020 <i>Për miratimin e pagës së punonjësve të bashkisë Bulqizë, njësive dhe institucioneve në varësi për vitin 2020</i>”.</p> <p>-VKB nr.63, datë 24.12.2019 <i>Për miratimin e buxhetit dhe pagës së punonjësve të bashkisë Bulqizë, njësive dhe institucioneve në varësi për vitin 2020</i>ö.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>-Mos pasqyrim i saktë i vlerave në llog.(215) <i>Mjete transporti</i> me kontabilizim të gabuar, mos pasqyrim i saktë i vlerave të inventarizimit fizik në llog.(214) <i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>ö, vlera për tu administruar në llog.(218/K) <i>Inventar ekonomik</i> dhe llog.(327) <i>Inventar i imët</i>ö, si dhe mos administrim në llog.(231) <i>Për aktive afatgjata materiale</i>ö, të objekteve të pa përfunduara brenda vitit ushtrimor dhe në proces financimi deri në përfundim sa të kalojnë në aktive të llogaritë e Klasa (2) <i>Aktive afat gjata materiale</i>ö, si dhe përlllogaritje e gabura e normës së amortizimit për llog.(212) <i>Ndërtesa e konstruksione</i>ö dhe llog.(213) <i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>ö.</p>
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesavë ligjore.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	<p>Bashkia Bulqizë, Drejtoria e Financës të marr masa të menjëhershme përkatësisht:</p> <p>1-Për sistemimin e llog.(214) <i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>ö, si pasojë e admistrimit në këtë llogari të vlerave cilat duhet të administrohen në llog.(218/K) <i>Inventar ekonomik (pajisje kompjuterike)</i>ö si dhe në llog.(327) <i>Inventar i imët</i>ö të rezultuar nga pasqyrimi i saktë i vlerave të inventarizimit fizik.</p> <p>2-Për sistemimin e veprimeve me analizë për cdo mjet transporti (AAGJM) me inventarizim fizik dhe zbatimin e procedurave për të evidentuar 11 (<i>njëmbëdhjetë</i>) mjetet e transportit të dëmtuar jo në gjendje teknike, duke kredituar llog.(215) <i>Mjete Transporti</i>ö e debituar llog.(24) <i>Aktive afat gjata të dëmtuara</i>ö në vlerë 11,955,191 lekë.</p>

Pika nr.3-Të ndryshme të dala për gjatë auditimit.

Titulli gjetjes:	-Nga auditimi në lidhje me publikimin në mediat (<i>online</i>) të shkrimit të cilësuar investime të kryera bashkia Bulqizë, në shtrimin me dy vija betoni të rrugës në lagjen <i>oZogu</i> ö në fshati Dragua të NJA Fushë-Bulqizë..
Situata;	<p>Në procesin e auditimit në lidhje me publikimin në mediat (<i>online</i>) shkrime të cilësuar si investime të kryera bashkia Bulqizë, në shtrimin me dy vija betoni të rrugës në lagjen <i>oZogu</i>ö në fshati Dragua të NJA Fushë-Bulqizë. Për këtë qëllim nga audituesi KLSH^{së} V.R. (<i>Përgjegjës grupi</i>) u konsiderua e nevojshme që ditën e premtë datë 19.11.2021 deri në orën 16⁰⁰ në ambientet e bashkisë Bulqizë të zhvillohej një takim ballafaqimi në prezenc të përfaqësuesve të subjektit të auditimit në Bashkia dhe NJA Fushë Bulqizë të përfaqësuar nga;</p> <p>1-z.LA me detyrë Kryetar i Bashkisë.</p> <p>2-z.SA me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Fushë Bulqizë.</p> <p>3-z.RB me detyrë Drejtor i Financës,</p> <p>4-z.EI me detyrë Drejtor i Urbanistikës,</p> <p>5-z.MGjme detyrë përgjegjës INUV</p> <p>6-z.ShA me detyrë, Drejtor Ndërmarrja e Shërbimeve Utilitare.</p> <p>7-z.RK me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Prokurimit.</p> <p>8-znj.GJ me detyrë Drejtore e Burimeve njerëzore, në cilësinë mbajtje e protokollit.</p> <p>Në këtë takim nga audituesi V.R. u kërkuar vendosja në dispozicion e të gjithë dokumentacionit që disponohej nga Njësia Administrative Fushë Bulqizë dhe Bashkia Bulqizë, në lidhje me zbatimin e punimeve që janë kryer në objekt për shtrimin me dy vija betoni të rrugës në lagjen <i>oZogu</i>ö në fshatin Dragu. Nga ana e bashkisë Bulqizë dhe Njesisë Administrative Fushë Bulqizë u vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i administruar i pasqyruar hollësishtë sa më poshtë:</p>

1-Kërkesa nr.278 prot, datë 18.10.2021 e qytetarit invalid **z.S.B.** drejtuar Njësisë Administrative Fushë-Bulqizë për nevojën e rregullimit të rrugës së fshatit Dragua.

2-Kontrata ÷Sponsorizimiö nr.295 prot, datë 28.10.2021 e lidhur ndërmjet NJA Fushë-Bulqizë (përfituesi) me subjektin “S.” shpk (sponsorizuesi).

3-Urdhëri i Titullarit të bashkisë nr.5292, datë 29.10.2021 ÷Për miratimin e kërkesës së qytetarit për rehabilitimin me beton të rrugës në lagje (Zogu) në fshati Draguö i nënshkruar nga znj.**E.LI** (nënpunësi i autorizuar).

4-Preventivi për punimet që do të kryhen me 3 (tre) zëra punimi i hartuar nga ing.**K.Z.** me vlerë fondi limit prej 86,903 lekë pa tvsh dhe 104,283 lekë me tvsh.

5-Analiza teknike për cmimet e 3 zërave punime të preventivuar.

6-Preventivi zbërthimit të bazës marteriale për 3 artikuj (cimento 20 kv; zgarë betoni copë 12 dhe granil 20 m3);

7-Skicat teknike me profile gjatësor të rrugës dhe skica me profil prerje tërthore e punimeve.

8-Raporti teknik për sistemin me beton të rrugës së fshatit Dragua në NJA Fush Bulqizë.

9-Procesverbali datë 05.11.2021 për marrjen në dorëzim dhe ruajtje e 3 artikujve të furnizuar me (cimento 20 kv; zgarë betoni copë 12 dhe granil 20 m3) të përdorur në zbatimin e punimeve në objekt bashkëlidhur fletë dalja nr.1, datë 05.11.2021 për 3 artikujt (document shoqërues malli).

10-Akti marrjes në dorëzim të punimeve në datë 05.11.2021 për punimet në rrugë i shoqërua me situacion punimeve në objekt për të njëjtët zëra punimi.

11-Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve nga Autoriteti Kontraktor për vitet (2020 dhe 2021).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Administratori NJA Fushë Bulqizë **z.S.A.** për të plotësuar kërkesën e një qytetari invalid në fshatin Dragu për shtrimin me beton një pjesë të rrugës në lagjen (Zogu) ka lidhur kontratë (sponsorizimi) nr.295, datë 28.10.2021 me objekt; ÷Furnizim me bazë materiale për shtrimin e rrugës me beton në lagjen (Zogu) fshati Draguö me vlerë 42,400 lekë për 3 artikuj materiale ndërtimi. Kërkesa dhe kontrata janë miratuar nga Titullari bashkisë me urdhër nr.5292, datë 29.10.2021 ÷Për miratimin e kërkesës së qytetarit për rehabilitimin me beton të rrugës në lagjen (Zogu) në fshatin Draguö i nënshkruar nga nënpunësi i autorizuar znj.**E.LI**.

Nga auditmit në lidhje me procedurat e realizuara në këtë objekt i cilësuar në publikime si investim i bashkisë u konstatuan mangësi në procedurat e ndjekura për punimet sa më poshtë;

1-Kontrata në neni 6 ÷Baza ligjoreö, si referim ligjor ka ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 ÷Për sponsorizimetö i ndryshuar, ndërsa është pikërisht ky ligj i cili me nenin (3) nuk lejon subjekte sponsorizues ata që përfitojnë financime buxhetore, ndërkohë referuar në regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit të realizuara nga AK Bashkia Bulqizë për vitet 2020 e 2021 (sponsorizuesi) “S.” shpk rezultoi i shpallur fitues për 2020 me 2 kontrata punë publike me vlerën 9,020,847 lekë dhe për 2021 me 2 kontrata punë publike me vlerën 26,533,715 lekë. Në këto kushte subjekti (sponsorizues) është përfitues me financime buxhetore, ndërsa nuk duhejt të ishte pranuar si sponsorizues, veprime në mospërputhje me ligji nr.7892, datë 21.12.1994 ÷Për Sponsorizimetö i ndryshuar me ligjet nr.8282, datë 21.01.1998; nr.9040, datë 27.03.2003; nr.9807, datë 20.09.2007, neni (3) ÷Sponsorizues në kuptim të këtij ligji janë vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, vendas, të huaj a me kapital të përbashkët. Subjektet buxhetore, ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizuesö.

2-Për investimin e preventivuar me vlerë 104,283 lekë me tvsh rezultoi se, referuar në treguesit e miratuar të buxhetit vjetor, apo në treguesit e programit buxhetor afatmesëm (PBA 2019-2021) e në vijim për njësinë publike bashkia Bulqizë ky objekt rehabilitim rruge nuk është parashikuar për tu kryer si investim prioritar. Njëkohësisht në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 ky objekt i cilësuar (rrugë fshati) nuk është i administruar në llog.(213) ÷Rrugë, rrjete, vepra ujoreö apo dhe në inventarin e (AAM), për pasojë investimi i realizuar nuk mund të pasqyroj vlerën e (AAGJ) i cili ka pësuar ndryshim në vlerë me investimin e kryer shtesë, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të

pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kap.(II), pika (11), Aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).

3-Megjithëse punimet në objekt kanë përfunduar, ashtu si edhe është publikuar në mediat (*online*) në përfundim nga NJA Fushë-Bulqizë është paraqitur situacion për punimet e kryera në fakt me analizë teknike me për fuqi puntore 6 (*gjashhtë*) individë nga komuniteti i fshatit Dragu, ndërkohë punimet në objek janë marr në dorëzim në datë 05.11.2021 nga (**S.A; M.K; I.R**) të cilët duhet të dorëzojnë aktin e marrjes në dorëzim në sektorin e kontabilitetit me qëllim për të ndryshuar vlerën e (AAGJ) në llog.(213) *öRrugë, rrjete, vepra ujoreö* si investim i kryer shtesë, veprim në mospërputhje me ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 *öPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitö* i ndryshuar, Kreu (III,) neni (7), neni(12); UKM nr.3 datë 15.02.2001*öPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö*, Kreu (II), pika (3). *Për veprime e mos veprime të konstatuara në procedurën për rehabilitim me shtrimin të rrugës në lagje “Zogu” fshati Dragu në NJA Fushë Bulqizë ngarkohen me përgjegjësi:*

1-z.LA me detyrë, Kryetar i Bashkisë.

2-z.SA me detyrë, Administrator Njësia Administrative Fushë Bulqizë.

Kriteri:	-UMF nr.08, datë 09.03.2018; UKM nr.3 datë 15.02.2001.
Ndikimi/Efekt:	Përdorimi medias <i>öonlineö</i> për publikim investime, jo nga buxheti bashkisë.
Shkaku:	Mos zbatim i kriterëve ligjore për publikim.
Rëndësia:	E ulët

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit u konstatua mos realizim në treguesit e buxhetit, veçanërisht për sa i përket të ardhurave vendore, mos realizim i cili ka krijuar detyrime të pa likuiduara të prapambetura ndaj të tretëve, duke paraqitur një risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, sepse ky buxhet i vitit ushtrimor do të përdoret jo për të financuar nevojat reale, por për të likuiduar detyrime të prapambetura për investimet, mallrat e shërbimet, apo dëmshpërblim nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku detyrimeve gjendje progresive në datë 31.12.2020 pasqyrohen në *vlerën 28,307,781 lekë* e përbër nga;

-Detyrime për investime *vlera 27,815,530 lekë (shlyerje në viti 2020, vlera 26,615,667 lekë);*

-Detyrime për mallra e shërbime *vlera 492,251 lekë (shlyerje në viti 2020 vlera 0 lekë);*

-Detyrime për vendime gjyqësore *vlera 0 lekë (shlyerje në vitin 2020 vlera 8,608,271 lekë);*

shlyerje të cilat kanë zvogëluar fondet në dispozicion në investime dhe shpenzime të tjera për periudhën raportuese viti 2020 në interes të komunitetit bashkia Bulqizë, të pasqyruara në (**Anekset nr.1;2;3, pika nr.1/4**) bashkëlidhur me raportin, veprime në mospërputhje me neni (50)*öAngazhimet buxhetoreö*, neni(52) *öKryerja e shpenzimeveö*, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 *öPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö* i ndryshuar, neni (56), ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017“*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, pika (62) UMF nr.2, datë 06.02.2012 *öPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitö*; UMF nr.5, datë 27.12.2014 *öPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaö*, UMF nr.2, datë 10.01.2018 *öPër buxhetin e vitit 2018ö*, pikat (82-91) *öDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreö*; neni 70, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *öPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö* i ndryshuar. (*Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 13-21, të Raportit të Auditimit*).

1-1-Rekomandimi: Titullari bashkisë Bulqizë për detyrimet e pa likuiduara të faturave gjendje progresive në datë 30.12.2020 me vlerë prej **28,307,781 lekë** të analizojë situatën të ndërpresë krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe të nxjerr përgjegjësi e të marrë masa për të mos patur angazhime të reja buxhetore pa fonde në dispozicion për të cilën kërkohet që;

a) Për daljen nga situata e vështirë financiare të përgatis plan dhe ta dërgoj për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Bashkisë brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Ky plani i

miratuar ti dërgohet edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim që të japë rekomandime konkrete për rregullimin e situatës financiare, ndërsa njësisë qeverisjes vendore Bashkia Bulqizë të mos marrë asnjë angazhim tjetër buxhetor pa pasur fonde në dispozicion.

b) Për rastet e vendimeve gjyqësore megjithëse janë likuiduar me fonde të periudhës raportuese viti 2020, të analizojë situatën, të nxjerr arsye e përgjegjësi për humbjen e tyre dhe efektin negativ që kanë dhënë këto vendime në buxhetin e njësisë vendore. Sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjyqimit, nëpërmjet edhe rekursit. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat shkurtra. nënrubrika, llogari të arkëtueshme, gjendja e llog.(468) **“Debitorë të ndryshëm**”, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore raportuese më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerën 114,421,966 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerë 122,745,108 lekë me diferencë më tepër detyrime debitorë ndaj bashkisë në shumën prej **8,323,142 lekë** e cila përfaqëson detyrimet shtesë të pa likuiduar nga subjektet ekonomik dhe familjare për mos pagesë të nivelit të taksave e tarifa vendore deri në datë 31.12.2020. Detyrimet debitorë ndaj Bashkisë Bulqizë janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të pa arkëtuara deri në datë 31.12.2020.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se;

Detyrimet debitore në shumën 122,745,108 lekë përbëhen nga;

-Debitorë rekomanduar nga KLSH është vlera	44,312,562 lekë.
-Debitorë subjekte të biznesit është vlera	22,842,147 lekë.
-Debitorë ente shtetërorë për (ish komunat) është vlera	5,692,642 lekë.
-Debitor penalitete të vendosur nga APP është vlera	2,450,000 lekë.
-Debitorë ente shtetërorë për taksa e tarifave është vlera	1,042,606 lekë.
-Debitorë për taksa tarifa (Kompani AMC) është vlera	703,031 lekë.
-Debitorë nga kopshte e çerdhe (taksa e tarifa) është vlera	343,330 lekë.

-Bazuar mbi raportimin me evidencë nga Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore shtesa për vitin 2020 është me vlerën 12,866,486 lekë, ndërsa e raportuar në pasqyrat financiare (*bilanci*) shtesa debitore është vlera 8,323,142 lekë, pra ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat e pozicionit financiar e gjendjes debitore e pasqyruar me evidenc nga DTTV rezulton diferencë e pa argumentuar vlera prej **4,545,344 lekë** (12866486-8323142), për pasojë kjo llogari nuk pasqyron e administron të gjitha detyrimet debitorë të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore për subjektet privat e subjekte familjar, në këto kushte edhe pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 nuk pasqyrojnë vërtetësi në gjendjen e detyrimeve debitore me analizë të subjekteve për mospagim të nivelit taksave e tarifave vendore të njësisë publike bashkia Bulqizë, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Taksave e Tarifa Vendore, të marrin masa të menjëhershme që bazuar në listën e debitorëve e raportuar në fund të vitit 2020 dhe të bëjnë sistemimin e të kërkojnë likuidimin e vlerës debitore për taksa e tarifave nga subjektet e biznesit dhe subjektet familjarë e detyrimet e tjera.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

3.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata. nënrubrika, aktive afat gjata jo materiale, gjendja e llog.(202) **“Studime dhe kërkime”**, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 49,476,281 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 15,347,091 lekë me diferencë më pak shuma **34,129,190 lekë** e cila përfaqëson vlerën e amortizimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2020 me vlerë

14,062,328 lekë llogaritur me (5%), ndërsa diferenca prej 20,066,862 lekë (34129190-14062328) është vlera për 7 objekte të transferuar nga ish/Komunat për të cilat vlera e studim projektimit është e përfshirë shtesë në vlerën e objekti përkatës.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-vlera prej 29,145,487 lekë me kosto historike i përket 31 projekteve e studimi për investimet që janë kryer në objekte të cilat ka përfunduar zbatimi i punimeve e janë marr në dorëzim nga Bashkia, pra kjo vlerë duhet të ishte e sistemuar në llogarinë përkatëse të investimit që është përfunduar, si pjesë e koston totale të objekteve. Për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë vërtetësinë e gjendjes së aktiveve, të evidentuara në (Aneksi nr.6, pika nr.2/I) bashkëlidhur me raportin, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjstive të Qeverisjes së Përgjithshme*, aneksi (1), Klasa (2), pika (2.1), pika (36), paragrafi (4), si dhe me UKM nr.02, datë 08.05.2003 *ËPër klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit* i ndryshuar, germa (c), nën germa (b). (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Financës të marrin masa të menjëhershme për sistemimin e llog.(202) *ËStudime dhe kërkime*, të paraqesë në këtë llogari vetëm vlerat e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari të pakësohet për vlerën 29,145,487 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

4.Gjetje nga auditimi:Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(210) *“Toka, Troje, Terrene”*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 7,600,116 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 8,036,366 lekë me diferencë më tepër shuma 436,250 lekë e cila përfaqëson shtesë si pasojë e transferimit të aseteve nga Nd.Pastrim Gjellbërim në bashki për 8 objekte me emërtim *Ësipërfaqe e gjellbërit* në sasi prej 207.3m².

Nga analiza e llogarisë konstatohet se;

a) Në këtë llogari nuk është përfshirë e pasqyruar edhe vlera e trojeve të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Bulqizë, përkatësisht me VKM nr.946, datë 02.09.2009 *ËPër miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë, qarku Dibërë*, nuk pasqyrohet e plotë në kontabilitet për mungesë të vlerës së truallit nën objekte, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjstive të Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2); pika (30).

b) Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore evidentuar në (Aneksi nr.7, pika nr.2/I) bashkëlidhur me raportin, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, Kap.(IV), pikat (74; 96). (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa për të pasqyruar në llog,(210) *ËToka, Troje, Terrene”* edhe vlerën e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llog.(212) *ËNdërtime e konstruksione* të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi si asete publike të Bashkisë Bulqizë, njëkohësisht me komision të kryhet procesi i inventarizimit fizik dhe vlerësimi i trojeve nën objekte.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

5.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata. Nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(211) *“Pyje, kullota, plantacione”*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 16,201,819 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 16,494,469 lekë me diferencë më tepër

shuma 292,650 lekë e cila përfaqëson shtesë si pasojë e transferimit të aseteve në bashki nga Nd.Pastrim Gjellbërimit për 9 objekte me emërtim (*blina dekorativ, pisha park varreza, gështenjë etj*).

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në këtë llogari nuk është e pasqyruar vlera si edhe emërtimi për objektet inventar për pyje, kullota e plantacione të cilat u transferuan nga shërbimi pyjor në pronësi të Bashkisë Bulqizë bazuar në VKM nr.433, datë 08.06.2016 *ËPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkive*, pika (9), shtojca nr.7 me listë inventar të pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Bulqizë, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap.(II), Pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2).

b) Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i pyjeve dhe kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, ndërsa llog.(212) nuk paraqet vlerë të saktë të pasurisë, veprime në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, Kap.(IV), pikat (74; 96), (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrin masa për të kryer procesin e inventarizimit fizik dhe vlerësimin pronave dhe të bëhet pasqyrimi i saktë në dokumentet kontabël për vlerën e aseteve pyje, kullota e plantacione asete në pronësi të Bashkisë Bulqizë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

6.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata. nën rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(212) *“Ndërtime e konstruksione”*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 1,034,878,278 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 949,798,585 lekë me diferencë më pakë vlera 85,079,693 lekë e cila përfaqëson shtesë në investime të kryera gjatë vitit në objekte me vlerën 51,173,701 lekë, pakësim të tjera me vlerë 117,406,484 lekë si pasojë e transferimit të asetit objekti me emërtim *ËNdërtesë Ujësjiellës Martanesh* nga ish/Nd.Ujësjiellës Martanesh pronë e bashkisë në Nd.Ujësjiellës sha Bulqizë, pakësim për normën e amortizimit vjetor me vlerë 30,294,042 lekë, ndërsa vlera prej 15,059,082 lekë është përlllogaritje e gabuar në normën e amortizimit vjetor, për pasojë edhe norma e amortizimit nuk rezulton e përlllogaritur me 5%, me detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

a) Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e saktë e çdo aktiviteti afat gjatë i cili ka pësuar ndryshime për gjatë periudhës mëpasshme me investime shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objektit, mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet e mirëmbajtje e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen kostos fillestare AAGJM^{së}. Investimet shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 980,307,610 lekë për 139 objekte të evidentuara në (*Aneksi nr.8, pika nr.2/1*) bashkëlidhur raportit, veprim në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).

b) Për periudhën viti 2020 ka zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 15,059,082 lekë e cila vjen për shkak të përlllogaritjes gabim të normës së amortizimit me pasojë edhe me ndryshim të vlerës së amortizimit detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësi Qeverisjes së Përgjithshme*, pika (36).

c) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*, neni (15), pikat (1;2); UMF nr.30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, Kap.(IV), pikat (74; 96) dhe UMF nr. 08, datë 09.03.2018 *ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme*, pika (36), paragraf (4). (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për këtë llogari, duke shtuar në vlerën fillestare edhe vlerën e shpenzimeve të cilat përbëjnë investim të ri për objektet (në rikonstruksione, etj). Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM) dhe në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

7.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(213) **“Rrugë, rrjete vepra ujore”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerë 1,962,571,847 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 2,437,349,254 lekë me diferencë në shtesë vlera 474,777,407 lekë e cila përfaqëson investime të kryera gjatë vitit 2020 në rrugë, rrjete e vepra ujore në 15 objekte me vlerën 330,027,978 lekë dhe transferim nga ish/Nd.Pastrim Gjellbërimit pa pagesë për 33 objekte me vlerë 76,506,745 lekë, ndërsa pakësim për amortizimin e periudhës me vlerë prej 221,887,459 lekë, si dhe përlllogaritje e gabuar e normës së amortizimit vjetor me vlerë 99,245,173lekë, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit ushtrimor pasardhës, të evidentuara në (Aneksi nr.9, pika 2/1) bashkëlidhur raportit.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

a) Vlera e amortizimit vjetor e aktive afatgjata në pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën raportuese ushtrimore 2020 është llogaritur në shumën 153,644,775 lekë me normë mesatare vjetore 5%, ndërsa në faktë rezulton se, norma e amortizimit vjetor është përlllogaritur gabim me vlerën 99,245,173lekë me pasojë nuk është respektuar norma e amortizimit tashmë me 5%, veprim në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*, pika (36).

b) Në këtë llogari nuk është e pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës mëpasshme me investimet shtesë, vlera e rikonstruksionit të objektit dhe mbikëqyrje e kolaudimi objektit, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM^{së}. Investimet shtesë në total deri në 31.12.2020 janë në vlerë 406,534,723 lekë për 24 raste objekte, veprim në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap.(II), pika (11), Aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).

c) Për periudhën viti 2020 ka zvogëlim të kësaj llogarie me një vlerë prej 99,245,173 lekë e cila vjen për shkak të përlllogaritjes gabim të normës së amortizimit me pasojë edhe me ndryshim të vlerës së amortizimit detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësi Qeverisjes së Përgjithshme*, pika (36).

d) Nuk është kryer inventarizimi e vlerësimi AAGJM^{ve} me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*, neni (15), pikat (1;2); UMFE nr.30, datë 27.12.2011

ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Kap.(IV), pika (74; 96); UMF nr. 08, datë 09.03.2018 ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme, pika (36). (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për këtë llogari, duke shtuar në vlerën e tij fillestare vlerën e shpenzimeve të cilat përbëjnë investim të ri për secilin objekt. Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM) dhe në përfundim të punës komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

8.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(214) **“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 3,187,312 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerën 10,077,835 lekë me diferencë tepër për 6,890,523 lekë e cilat përfaqëson shtesë gjatë periudhës për objektet e transferuara në bashki nga Nd.pastrim gjelbërim me konsolidim të pasqyrave financiare vlera 9,286,843 lekë dhe pakësime të tjera për objektet e transferuara nga bashkia Bulqizë në Ujësje të Sha Bulqizë vlera 2,671,500 lekë dhe vlera e amortizimit për viti 2020 shuma 3,780,983 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Referuar në procesin e inventarizimit fizik të (AAM) dhe pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 rezultojnë se, llog.(214) është paraqitur me vlerë 48,602,818 lekë me kosto historike në të cilën është e përfshirë vlera **18,200,596 lekë** për artikuj *Ëpajisje kompjuterike* e cila duhet të administrohet në llog.(218/K) *ËInventar ekonomik*” dhe vlera **1,422,368 lekë** për artikuj *“bateri kompjuteri e televizor”* e cila duhet të administrohet në llog.(327) *ËInventar i imët*” me pasojë kontabilizim i gabuar në llog.(214) *ËInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune* e për të cilat dhe amortizim vjetor me vlerë 910,030 lekë në masë 5% është përlllogaritur gabim, sepse amortizimi për këtë llogari duhet llogaritur me vlerë 3,640,119 lekë në masën 25% e cila duhet të shtohet në llog.(218) *ËInventar ekonomik*” me të njëjtën vlerë evidentuar në (Aneksi nr.10, pika 2/1) bashkëlidhur raportit, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshme, Kap.(II), pika(11), aneksi (1), pika (2), klasa (2). (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa të menjëhershme për sistemimin e llog.(214) *ËInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*, si pasojë e administrimit në këtë llogari edhe të vlerave të cilat duhet të administrohen në llog.(218/K) *ËInventar ekonomik (pajisje kompjuterike)*, si edhe në llog.(327) *ËInventar i imët* të rezultuar nga pasqyrimi saktë i vlerave të inventarizimit fizik, me qëllim pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material dhe sistemimin e veprimeve me pasojë kontabilizimin e gabuar në llog.(214) *ËInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

9.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(215) **“Mjete transporti”**, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 36,939,523 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 43,266,038 lekë me diferencë shtesë për 6,326,515 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe paksimet nga amortizimi për periudhën raportuese.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Në llog.(215) *ëmjete transporti* të pasqyrave të pozicionit financiar viti 2020 e paraqitur në vlerën 82,402,135 lekë me kosto historike është pasqyruar edhe vlera për 11(*njëmbëdhjetë*) mjete transporti në gjendje teknike jashtë përdorimit të dëmtuara vlera historike e të cilave është për 11,955,191 lekë, për të cilat është kryer kontabilizimi gabuar në llog.(215) *ëmjete Transporti*, pasi këto mjete transporti të dëmtuara dhe jo në gjendje pune vlera e tyre duhej të ishte regjistruar dhe kontabilizuar në llog.(24) *ōAktive afatgjata të dëmtuara* me analizë çdo mjet, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2/1), germa (e); pika (36). (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa të menjëhershme për sistemimin e veprimeve me analizë për cdo mjet transporti (AAGJM) me inventarizim fizik dhe zbatimin e procedurave për të evidentuar 11 (*njëmbëdhjetë*) mjetet e transportit të dëmtuar jo në gjendje teknike, duke kredituar llog.(215) *ëmjete Transporti* dhe debituar llog.(24) *ōAktive afat gjata të dëmtuara* në vlerën 11,955,191 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

10.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, investime, gjendja në llog.(231) *“Për aktive afatgjata materiale”*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet në datën 31.12.2019 me vlerën 0 (Zero) lekë e pa ndryshuar edhe në datën 31.12.2020 e pasqyruar me vlerën 0 (Zero) lekë, në këto kushte rezulton se, njësia publike Bashkia Bulqizë për këtë periudhë nuk ka objekte AAM në proces.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Njësia publike Bashkia Bulqizë për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 rezulton me shpenzime për investime në 5 (*pesë*) objekte ndërtimore me vlerën prej **252,235,627 lekë** të cilat janë të pa përfunduara brenda vitit ushtrimor dhe në proces financimi deri në përfundim përderi sa të kalojnë në aktive te llogaritë e Klasa (2) *ōAktive afat gjata materiale*. Për këtë Drejtoria e Financës nuk ka analizuar, dokumentuar dhe justifikuar në mënyrë analitike këtë llogari të cilën e ka paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar me vlerën 0 (Zero), ndërkohë që për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 këto 5 (*pesë*) objekte janë në proces ndërtimi e financimi, ndërsa vlera e tyre është përfshirë në vlerën e objektit në rikonstrukcion, duke e kaluar në llogaritë Klasa (2) *ōAktive afat gjata materiale* si objekte të përfunduara, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, veprim në mospërputhje me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap.(II), pikat (6;11), aneksi (1), pika(2), Klasa (2), nën/pika (2.1) paragrafi; *“Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) òAktive afatgjata materiale*, pika (18). (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa për të evidentuar dhe dokumentuar në mënyrë analitike, vlerën e investimeve të cilat janë në proces ndërtimi e financimi, ndërsa nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor të pasqyrohen në llog.(231) *ōPër aktive afatgjata materiale* me vlerë **252,235,627 lekë**.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

11.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, pasivet afat shkurtra, nën/rubrika, llogari të pagueshme, gjendja në llog.(466) *“Kreditorë për mjete në ruajtje”*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 28,773,921 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 35,510,372 lekë me diferencë më tepër shuma prej **6,736,451 lekë** e cila përfaqëson detyrime të bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Në pozicionin financiar kjo llogari paraqitet në vlerë 35,510,372 lekë e cila rakordon me gjendjen e pasqyruar në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimin në akt akordime dhe evidencat analitike për të gjithë OE për detyrimin që ka bashkia Bulqizë në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces të evidentuara në (*Aneksi nr.13, pika nr.2/1*), bashkëlidhur raportit, ndërsa nuk është bërë zhblllokimi vlerës, sepse fondet gjenden të ngurtësuar në degën e thesarit Bulqizë, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës të evidentuara në (*Aneksat nr.11;12, pika nr.2/1*), bashkëlidhur raportit.

Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Financës, nuk janë marrë masa për bërë zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk është bërë njoftim subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit të duhur me qëllim likuidimin e vlerës së ngurtësuar, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse, veprime në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap.(III), pikat (30;50). (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 43-70, të Raportit të Auditimit*).

11.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Urbanistikës, të marrin masa për sistemimin e llog.(466) *“Kreditorë për mjete në ruajtje”*, duke evidentuar e dokumentuar në mënyrë analitike diferencën e rezultuar në vlerë 6,736,451 lekë e pa analizuar në mënyrë analitike. Të analizojë qysh në origjinën e krijimit të tyre cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim. Njëkohësisht të marrin masa për të bërë likuidimin e vlerës së mësipërme, duke analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 u konstatua se, mos realizim i të ardhurave nga zbatimi nivelit për taksat e tarifave vendore të miratuara me VKB, në paketën fiskale ka krijuar detyrime të pa likuiduara debitorë shtesë për vitin 2020 me progresive vlera totale prej 12,866,486 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore bashkia Bulqizë, detyrime nga subjekte ekonomik dhe familjare për mos likuidim të nivelit të taksave e tarifave, etj si dhe të taksës së tokës. Mos arkëtimi i detyrimeve për nivelin e taksave e tarifave vendore, përveç se është mos përmbushje e detyrës funksionale nga punonjësit e Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore, njëkohësisht krijon mungesë financiare në treguesit në buxhet me pasojë ulje e nivelit të investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësitë vendore ka parashikuar në shërbim të komunitetit, të evidentuara në (*anekset nr.17; 18; 19, pika nr.1/6*) bashkëlidhur raportit. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”* i ndryshuar; nenet (4; 26; 32; 34) të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, nenet (70; 91) Kreu (XI) *“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore”* të ligjit nr.9920 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar; ligjin nr.10926, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar; neni (12) i UMF nr.24, datë 02.09.2008 dhe UMF nr.01, datë 17.01.2019 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”*. (*Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 13-21, të Raportit të Auditimit*).

1.1-Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara debitorë shtesë për vitin 2020, nga mos pagesë e nivelit të taksave e tarifave

vendore të parashikuara në paketa fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi, si dhe subjekte familjar me vlerë prej **12,866,486 lekë** dhe mos programim, mos përllogaritje dhe mos realizim i detyrimeve të lindura nga niveli për taksën e tokës, apo debitor të tjerë ndaj njësisë publike vendore Bashkia Bulqizë.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 u konstatua se, në territorin e bashkisë Bulqizë, ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi veprimtari tregtim të karburantit për përdorim nga konsumatorët fundorë gjithësej 18 (*tetëmbëdhjetë*) operator ekonomik, ndërkohë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë pajisur me (*licencë/autorizim*) me afat për 5 vite kalendarike, apo me rinovim pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit të mëparshëm, si dhe mos likuidimin e nivelit të tarifës përkatëse menjëherë për 5 vite kalendarik, për pasojë vlera totale prej **12,900,000 lekë**, konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e bashkisë Bulqizë të evidentuara në (**aneksi nr.20, pika nr.1/6**) bashkëlidhur raportit, në mospërputhje me neni 35, i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”* i ndryshuar; Kap.(II); Kap.(III), pika 4: Kap (II), pika (1), germa (b); pika (15) e VKM nr. 970, datë 02.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë”* i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 *“Për ndryshimin e VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto e nën produkteve të sajë.”* (Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1/6, faqe 21-42, të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën, të marrin masa të menjëhershme për të pajisur, apo për të rinovuar (*licencë/autorizimin*) me afat 5 (*pesë*) vite kalendarik, për operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi me veprimtari në stacione tregtim karburanti dhe gaz i lëngshëm për përdorim nga konsumatorë fundorë në territori bashkisë Bulqizë, për ata OE që nuk janë të pajisur me (*licencë/autorizim*), apo nuk e administrojnë autorizimin bazë, si dhe rinovim të autorizimit për ata OE që ju përfundon afati në periudhën raportuese, për të kërkuar pagesën e nivelit të tarifës përkatëse e parashikuar në paketën fiskale të vitit 2020, për pasojë shuma e përllogaritur prej **12,900,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë.**

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga procesi i auditimit mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 u konstatua se, në territorin e bashkisë Bulqizë janë lidhur gjithësej 12 kontrata për punë publike me bashkinë me 7 OE të cilët përpara fillimit të punimeve nuk kanë aplikuar në QKB për hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshëm nga selia, sipas vendndodhjes të objektit të kontratës, (*NIPT sekondar*), ndërkohë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka përllogaritur e aplikuar nivelin e tarifës për pastrimin, ndriçimin e gjelbërimit me këta operatorët ekonomik për pasojë edhe nuk janë ngarkuar me detyrimet për këto nivele të tarifave të miratuara me paketën fiskale në vlerën **945,000 lekë** e konsideruar e ardhur e munguar për Buxheti Bashkisë Bulqizë, të evidentuara në (**aneksi nr.22, pika nr.1/6**) bashkëlidhur, veprime në mospërputhje me Kreu (VII), neni 35; pika (1/1), neni 43, të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar; UMF nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar dhe VKB nr.49, datë 06.12.2019 *“Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore (paketa fiskale) vit 2020”*. (Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1/6, faqe 21-42, të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave, të analizojnë situatën, të marrin masa të menjëhershme dhe të kërkojë pagesën e nivelit të tarifës së pastrimit, ndriçimit e gjelbërimit nga 7 OE me seli brenda, apo jashtë teritorit të bashkisë

Bulqizë, të cilët ushtrojnë aktivitet me adresë sekondare e pa aplikuar në QKB për kontratat e lidhura punë publike nga fondet për investime, për pasojë shuma e përlllogaritur prej **945,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë.**

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 u konstatua se; në territorin e bashkisë Bulqizë dhe Njësitë Administrative ushtrojnë aktivitet tregtar me status *ōaktivō* në fushën minerare të pajisur me leje minerare nga (MEI) gjithsej 123OE të cilët kanë marr në përdorim nga fondi pyjor/kullosor e përcaktuar në lejen minerare sipërfaqen totale prej **$S=108.51 \text{ Km}^2$** e konvertuar në sipërfaqe prej **$S=10851 \text{ Ha}$** , ndërsa rezulton se;

a) Bashkia Bulqizë për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor e marrë në përdorim nga subjekte privat ka lidhur vetëm 12 kontrata qiraje për sipërfaqen prej **40.975 ha** dhe ka arkëtuar shumën prej **187,729 lekë** me nivel tarife në referim të VKM nr.106, datë 22.12.2010, këto kontrata janë mbikëqyrur e administruar nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, ndërkohë në regjistrin e lejeve minerare të AKBN sipërfaqja e përcaktuar në leje për këta 12OE është **543.22Ha**, pra me diferencë sipërfaqe e pa kontraktuar prej **502.245ha** (**543.22-40.975**), me pasojë nuk është përlllogaritur niveli tarifës për sipërfaqen e pa kontraktuar me vlerën prej **40,903,980 lekë**, ndërsa vlera prej **40,716,251 lekë** (**40903980-187,729**), *konsiderohet e ardhur e munguara e pa programuar për buxhetin e bashkisë Bulqizë*, si diferencë ndermjet vlerës së nivelit të pa përlllogaritur e vlerës së artëktuar të evidentuara në **(anekset nr.24;25;26, pika nr.1/6)** bashkëlidhur raportit.

b) Bashkia Bulqizë me 12 subjekte privat të cilët kanë në përdorim sipërfaqje nga fondi pyjor/kullosor ka lidhur kontrata qiraje për sipërfaqen **573 ha** sipërfaqje e përcaktuar në lejen minerare, ndërkohë në teritorin e bashkisë Bulqizë kryejnë aktivitet tregëtar në fushën minerare gjithësej 123 OE të cilët kanë në përdorim sipërfaqen totale prej 10278 ha, në këto kushtë bashkia Bulqizë për këta 111(**123-12**) OE, nuk ka asnjë informacion, administrim dhe asnjë dokument në lidhje me aktivitetin në fushën minerare, në lidhje me sipërfaqen e marrë në përdorim prej tyre, për pasojë nuk ka programuar të ardhura vendore në paketën fiskale viti 2020, nuk ka lidhur kontrata qiraje megjithëse kryejnë aktivitet në teritorin e bashkisë. Në këto kushte ***shuma e përlllogaritur prej 801,684,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë*** (**10,278ha x78,000 lekë/ha/vit**), si pasojë e mos administrimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor dhe mos lidhjes kontrata qiraje me nivelin e tarifës minimale, veprime në mospërputhje me pika (2); lidhja nr.2, pika 6/1; pika 9/4, të VKM nr.391, datë 21.06.2006 *ōPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveō* i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 *ōPër Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”*. (*Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1/6, faqe 21-42, të Raportit të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi:

a) Titullari Bashkisë Bulqizë, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar likuidimin nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve të pajisur me leje minerare brenda territorit të bashkisë Bulqizë, për detyrimin e qirasë në kontratat e lidhura për sipërfaqen në përdorim nga fondi pyjor/kullosor prej **573 ha** me pasojë ***të ardhura të munguar të pa programuara për buxhetin e bashkisë Bulqizë në vlerën prej 40,716,251 lekë.*** (**40903980-187,729**).

b) Njëkohësisht Titullari Bashkisë Bulqizë, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të verifikuar në terren dhe për të administruar të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor e cila sipas të dhënave në regjistrin e AKBN^{së} është në përdorim nga 123 OE sipërfaqja totale prej **10,278ha** si dhe mos lidhja e kontratave të qirasë për këtë sipërfaqe në përdorim për aktivitet tregtar në fushën minerare, me pasojë të ***ardhura të***

munguar të pa programuara për buxhetin e bashkisë Bulqizë në vlerën prej 801,684,000 lekë. (10851ha -573ha).

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacioni vendosur në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 u konstatua se, në territorin e bashkisë Bulqizë dhe Njësitë Administrative janë lidhur gjithsej 12 kontrata qiraje me operatorë ekonomik për ndërtim të HEC^{-ve}, kontrata të administruar nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, ku referuar në kushtet e kontratave vlera e qirasë për çdo vit kalendarik nga data e lidhjes së kontratës e përcaktuar në raportin teknik të vlerësimit pjesë përbërëse integrale e kontratës, bashkia Bulqizë duhej të kishte realizuar të ardhura në vlerën prej 48,318,416 lekë. Ndërsa referuar mbi treguesit e realizimit të të ardhurave të administruara nga Drejtoria e Taksave e Tarifave dhe Drejtoria e Financës të rakorduar edhe me degën e thesarit Bulqizë rezultoi se, të ardhurat e realizuar deri në datë 31.12.2020 nga operatorët ekonomik kontraktues janë në vlerën prej 17,954,083 lekë, ose në masë 37% me mosrealizim vlera 30,935,494 lekë (48,318,416.- 17,954,083). Në këto kushte si pasojë e mos arkëtimit të plotë nga operatorët ekonomik të detyrimit për çdo vit kalendarit të nivelit të tarifës së qirasë për secilën kontratë për periudhën deri në datën 31.12.2020 rezulton diferencë e pa arkëtuar shuma prej 30,935,494 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë, si pasojë e mos përlllogaritjes, mos aplikimit të saktë dhe mos arkëtimit të nivelit të tarifës e parashikuar në raportin teknik të vlerësimit si pjesë integrale dhe përbërëse e kontratës, të evidentuara në **(aneksi nr.27, pika nr.1/6)** bashkëlidhur raportit, veprime në mospërputhje me VKM nr.391, datë 21.06.2006 *“Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”* i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 *“Për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave, pika (2), lidhja (11;12). (Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1/6, faqe 21-42, të Raportit të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Titullari Bashkisë Bulqizë, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlllogaritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysHEME për dhënë në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullor me kontratë të lidhur për ndërtimin e HCE^{-ve} në territorin e bashkisë Bulqizë, për të cilin ka rezultuar diferencë në vlerësim për ***vlerën 30,935,494 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë.***

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 u konstatua se, në territorin e bashkisë Bulqizë nga 35 subjekte familjar, janë kryer ndërtime pa leje (*in formale*) të legalizuara nga Drejtoria ALUIZN^{it}, ndërsa nga Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk kanë kërkuar likuidimin e detyrimit për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 14 subjekte në vlerën 302,654 lekë, të evidentuara në **(aneksin nr.28, pika nr.1/6)** bashkëlidhur raportit, veprime në mospërputhje me neni 23 të ligji nr.9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”* i ndryshuar me ligjin nr.9786, datë 19.07.2007; ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008; ligjin nr.10099, datë 19.3.2009; ligjin nr.10169, datë 22.10.2009; ligjin nr.10219, datë 04.02.2010; ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013; ligjin nr.50/2014 dhe ligjin nr.62/2015; Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 02.02.2009; me pika 2, neni 27, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar; ligji nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”* i ndryshuar; ligji nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar; VKM nr.860, datë 10.12.2014 *“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje e vlerave të zbatueshme për legalizim”* i ndryshuar. (Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1/6, faqe 21-42, të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi:Titullari Bashkisë Bulqizë, Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore, të analizojë situatën dhe të marrin masa të menjehershme për të analizuar dhe kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (*pa leje*) të kryera nga subjekte ekonomik dhe subjekte familjare në territori bashkisë Bulqizë e parashikuar në paketa fiskale me pasojë shuma prej **302,654 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Bulqizë.**

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Mbështetur në neni 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, geramat (b;c;ç) dhe nenin 58*ËLlojet e masave disiplinore*, të ligjit nr.152/2013 *ËPër nëpunësin civil*, në VKM nr.115, datë 05.03.2014 *ËPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil* dhe shkronja (k) neni (64), të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015*ËPër vetëqeverisjen vendore*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Bulqizë** që t*ë* kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH^{së}, për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2020 dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **8 (tetë) punonjës**, si më poshtë:

1-RH me detyrë Drejtor i Taksave e Tarifa Vendore e në vazhdim.

2-BH me detyrë, Inspektor regjistrimit dhe vlerësimit të subjekteve.

3-EB me detyrë, Inspektore regjistrimit e vlerësimit të subjekteve.

4-FP me detyrë, Inspektor i Terrenit për taksa e tarifa vendore.

5-EI me detyrë Drejtor i Planifikimit e Zhvillimit të Territorit.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, në lidhje me mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *ËPër sistemin e taksave vendore*, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, Kreu (XI) *ËMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni (23) dhe pikës (2) të nenit (27) të VKM nr.860, datë 10.12.2014, etj, për mos marrjen si duhet të masave për arkëtimin e detyrimit debitor në vlerën prej 12,866,486 lekë gjendje në datë 31.12.2020. Për mos marrjen e masave për arkëtimin e tarifës të licencave të karburanteve për 11 OE që ushtrojnë aktivitet tregtar në pika fundore stacione karburani në teritori bashkisë Bulqizë,Nj.Administrative me vlerë 12,900,000 lekë, mos përllogaritje të saktë të nivelit të tarifës për dhënie me kontratë qiraje nga fondi pyjor/kullor për ndërtim të HEC^{ve} me vlerë 30,935,494 lekë, në mos lidhje të kontratave të qirasë me pasojë mospërllogaritje e nivelit të tarifës për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor për subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e mineraleve me vlerë 842,684,000 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Bulqizë. (*Më hollësisht trajtuar në pika nr.1 e 1/6, faqe 13-42 të Raportit të Auditimit*).

6-RA, me detyrë Specialist në Njësia e integritit e projekte të huaja.

7-HI; me detyrë Specialist në Sektori i finances.

8-AGj me detyrë Specialist në Sektori i finances.

Për mangësitë e shkeljet e konstatuara, në cilësinë anëtarë të komisionit të inventarizimit fizik të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale në objektet e inventarizuar respektivisht në; (*Bashkia dhe NjA F-Bulqizë; Zerqan; Martanesh; Shupenzë; Gjoricë; Trebisht; Ostren*). për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, neni (15), pika (1; 2), të UMF nr. 30, datë 27.12.2011*ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, Kap.(IV) *ËSistemi i kontrollit periodik të aktiveve*, pika(74) *ËInventarizimi aktiveve*, lidhur me anomalitë e konstatuara në pasqyrat e pozicionit financiar.(*Më hollësisht trajtuar në pika nr.2, faqe 43-70 të Raporti të Auditimit*).

C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në neni 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja (e) dhe (ç) të nenit (11), Kreu (IV) dhe neni (37) të ligjit nr.7961, datë 12.07.1996 òKodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH^{-së} për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2020, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **20(njëzet) punonjës**, si më poshtë:

1-EH me detyrë, Inspektor Terren për taksa e tarifa, deri 10.03.2020.

2-RD, me detyrë Drejtor Drejtorja e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave.

3-AM, me detyrë Punonjës administrimit, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

4-BC, me detyrë Punonjës administrimi, qeverisjes, mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

5-AH, me detyrë Punonjës administrimi, qeverisje, mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

6-RS, me detyrë Punonjës administrimi, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

7-AM, me detyrë Punonjës administrimit, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

8-BI, me detyrë Punonjës administrimi, qeverisjes, mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

9-BB, me detyrë Punonjës administrimit, qeverisje, mbrojtje fondi pyjor/kullos.

10-RD, me detyrë Punonjës administrimit, qeverisjes e mbrojtjes fondi pyjor/kullos.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, në lidhje me mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Kreu (XI) òMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni (23) dhe pikës (2) të nenit (27) të VKM nr.860, datë 10.12.2014, etj, për mos marrjen si duhet të masave për arkëtimin e detyrimit debitor në vlerën prej 12,866,486 lekë gjendje në datë 31.12.2020. Për mos marrjen e masave për arkëtimin e tarifës të licencave të karburanteve për 11 OE që ushtrojnë aktivitet tregtar në pika fundore stacione karburani në teritori bashkisë Bulqizë, Nj. Administrative me vlerë 12,900,000 lekë, mos përlllogaritje të saktë të nivelit të tarifës për dhënie me kontratë qiraje nga fondi pyjor/kullosor për ndërtim të HEC^{-ve} me vlerë 30,935,494 lekë, në mos lidhje të kontratave të qirasë me pasojë mospërlllogaritje e nivelit të tarifës për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor për subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e mineraleve me vlerë totale prej 842,364,251 lekë (801684000+40716251), duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Bulqizë. (Më hollësisht trajtuar në pika nr.1 e 1/6, faqe 13-42 të Raportit të Auditimit).

11-AH, me detyrë Administrator NJA Martanesh.

12-AL; me detyrë Specilaist në Sektori Arsimit, Rinis dhe Sporti

13-ShC; me detyrë Administrator NJA F-Bulqizë deri 13.11.2020.

14-ShT, me detyrë Administrator NJA Zerqan.

15-LA; me detyrë Specialiste në Sektori i turizmit.

16-HP, me detyrë Administrator NJA Shupenzë.

17-NC, me detyrë Administrator NJA Gjoricë.

18-MJ; me detyrë Specilaiste e GIS.

19-EO, me detyrë Administrator NJA Trebisht.

20-AT, me detyrë Administrator NJA Ostren.

Për mangësitë e shkeljet e konstatuara, në cilësinë anëtarë të komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve afat gjata materiale dhe jo material në objektet e inventarizuar respektivisht në; (Bashkia dhe NjA F-Bulqizë; Zerqan; Martanesh; Shupenzë; Gjoricë; Trebisht; Ostren). për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni (15), pika (1; 2), të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Kap.(IV) òSistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika(74) òInventarizimi aktiveve, lidhur me anomalitë e konstatuara në pasqyrat e pozicionit financiar.(Më hollësisht trajtuar në pika nr.2, faqe 43-70 të Raportit të Auditimit).

***Shënim:** Megjithëse mangësitë dhe shkeljet e konstatuara ekzistojnë dhe nuk janë të natyrës administrative të cilët nuk mund të ezaurohen si të tilla, për punonjësit: *znj.ESh* me detyrë ish/Specialiste e financës në cilësinë Kryetare e komisionit të inventarizimit fizik në Bashkia Bulqizë, si dhe *z.OL* me detyrë në cilësinë ish/Inspektor i Inspektor i Terrenit në Taksat e Tarifat Vendore, nuk mund të rekomandojmë masa disiplinore, pasi këta persona janë të larguar nga puna.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT